



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 30 MAJ 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE MAJA 30. MAJA 2013. GODINE**

**MAJ - MAJ
2013**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produktet e ndërtimit,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit treguesit gjeografikë,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për odat e profesionistëve shëndetësorë,
6. Shqyrtimi i raportit vjetor mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2011,
7. Ratifikimi i vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e universiteteve publike në Gjakovë, në Gjiilan dhe në Mitrovicë, si institucione publike të arsimit të lartë,
8. Miratimi i Statutit të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren,
9. Miratimi i Statutit të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë,
10. Miratimi i buxhetit të Komisionit Hetimor Parlamentar.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Drugo razmatranje Nacrta zakona o produktima izgradnje,
4. Drugo razmatranje Nacrta zakona o geografskim pokazateljima,
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona o komorama zdravstvenih profesionalaca,
6. Razmatranje Godišnjeg izveštaja o stanju u Civilnoj službi Republike Kosova za 2011. godinu,
7. Ratifikacija Odluka Vlade Republike Kosova o osnivanju Javnih univerziteta u Đakovici, Gnjilane i Mitrovici, kao institucije visokog obrazovanja;
8. Usvajanje Statuta Univerziteta “Ukshin Hoti” u Prizrenu,
9. Usvajanje Statuta Univerziteta “Haxhi Zeka” u Peći,
10. Usvajanje budžeta za Skupštinsku anketnu komisiju.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta. Diskutimet në emër të grupeve parlamentare deri në 5 minuta, në emër të deputetit 3 minuta.

Është mirë të tregoni se në çfarë cilësie flisni, në emër të grupit apo në emër personal. Fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Fjalën e kam në emrin tim.

I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Krasniqi,

Të nderuar ministra,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Kohëve të fundit po përballemi me një dukuri, e cila ka fillimin që pas përfundimit të luftës dhe e cila po vazhdon edhe sot, e me gjasë vazhdimin e ka edhe në të ardhmen, që është arrestimi i ish-komandantëve dhe ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me akuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Nëse më parë këto arrestime ishin të pakta, kohëve të fundit janë shndërruar në dukuri, e cila i godet ata që luftuan dhe u sakrifikuan për lirinë e Kosovës, për familjet e tyre, ata që e përkrahën luftën e armatosur edhe vetë luftën çlirimtare, për të cilën nëpërmjet kriminalizimit të udhëheqësve të saj, arrestimit dhe gjyqimit të padrejtë dhe të pambështetur në fakte, po bëjnë përpjekje ta barazojnë luftën pushtuese, që e bëri Serbia në Kosovë, me luftën e drejtë që e bënë shqiptarët dhe qytetarët e tjerë të Kosovës, që e donin lirinë, po e barazojnë dhunuesin me viktimën, duke barazuar gjithashtu krimin me vuajtjen.

Që nga fillimi, qëllimi ka qenë komprometimi dhe kriminalizimi i krahut të luftës, e nëpërmjet kësaj edhe vetë Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Të nderuar të pranishëm,

U deshën më shumë se 7 vjet që në dy procese para Tribunalit të Hagës, ish-komandanti i Zonës Operative të Dukagjinit, zoti Ramush Haradinaj, ta dëshmojë pafajësinë e tij, të bashkëluftëtarëve të tij, si dhe pastërtinë e luftës së Ushtrisë Çlirimtare.

Mos harroni se ata gjykoheshin për krime shumë të rënda, pa siguruar asnjë fakt. Rruga e Golgotës nëpër të cilën ka kaluar zoti Haradinaj deri në shfajësimin përfundimtar do të duhej të ishte mësim për ata që i organizuan këto arrestime dhe gjykime. Fatkeqësisht, ndodhi e kundërta!

Kalvari nëpër të cilin po kalon ish-komandanti zoti Fatmir Limaj është një padrejtësi, sikur që i është bërë edhe zotit Haradinaj. Mos duhet vallë që edhe zoti Limaj t'i kalojë 10 vjet burg për ta dëshmuar pafajësinë e tij?

Është duke vazhduar rigjykimi i Grupit të Llapit. Tash po përgatitet procesi kundër Grupit të Drenicës. Nesër, mbase kundër ndonjë grupi nga Anamorava, nga Zona e Pashtrikut, Zona e Nerodimes, apo zona tjera! Duket se po bëhet e qartë një tendencë - kriminalizimi i luftës në të gjitha zonat operative nëpërmjet arrestimit dhe gjykimit të grupeve nga këto rajone.

E qëllimi përfundimtar është që e tërë Kosova të shndërrohet në një zonë kriminale - kriminalizimi i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,
Gjatë luftës së fundit nga forcat serbe janë vrarë së paku 12 000 qytetarë të Kosovës, 97% prej të cilëve janë shqiptarë. Janë identifikuar 186 varreza masive dhe janë kryer 175 vrasje në masë. Janë ekzekutuar pjesërisht apo tërësisht 137 familje shqiptare nga foshnje 2-muajshe e deri te plaku 97-vjeçar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputeti Lutfi Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, kryetar!

Kryesi, ministra të nderuar,

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së sot të flas për aktin e fundit të Qeverisë. Po them aktin e fundit administrativ për shkak të vendimit të shpejtë, të pamatur, të paanalizuar dhe të pavlerësuar dhe duke i kaluar kompetencat ka vendosur që ta vazhdojë logjikën e themelimit të komunave të reja.

Këtë po e bazoj në atë që Qeveria do ta ketë parasysh si e drejtë e madhe që rishikimi funksional i pushtetit lokal ka qenë detyrë me mandat tre vjet pas shpalljes së pavarësisë.

Po përmendi 3 vjet, sepse u bënë 5 vjet e nuk ka ndodhur rishikimi funksional. Rishikimi funksional nënkupton të shihet gjendja e pushtetit lokal, në veçanti komunave që u themeluan në kuadër të reformës së pushtetit lokal, komunave sipas propozimit të Pakos së presidentit Ahtisari dhe propozimeve për themelimin e komunave të reja.

Duke e vlerësuar monitorimin e Qeverisë në komuna, qëllimin pse duhet të themelohen, çka qëndron prapa këtij qëllimi? A është motivi dhe qëllimi të jetë zhvillimor, a është qëllimi dhe motivi të vazhdojë decentralizimi i pushtetit, apo është qëllimi dhe motivi

kryesor politizimi i komunave? Ky akt është politik. Me akte politike kemi themeluar komuna përpara, kanë themeluar komuna përpara dhe po e vazhdojnë të njëjtën logjik ta themelojnë një komunë, dhe ajo siç thotë populli “ke një, u bënë dy”, prej një komune, brenda një jave, kjo ka ndodhur te ne.

Është precedent i rrezikshëm. Është precedent shumë i rrezikshëm nëse nuk është bërë rishikimi funksional, nuk është parë motivi zhvillimor, nuk është parë motivi apo e drejta mbi qëllimin e vendimmarrës në nivel më të ulët të pushtetit lokal, sepse kërkesat kanë vërshuar, nuk janë marrë vendet që janë studiuar. Vendet që janë studiuar, janë analizuar prej vitit 2007, janë klasike, vendbanime që kanë kalua në procesin teknik të vlerësimit.

Është Zhegra, është Komorani dhe është Kijeva, tri vendbanime që janë studiuar duke thënë që do të bëhen komuna, por janë bërë vlerësime teknike. Është bërë dosja për këto vendbanime, është bërë numri i banorëve, është bërë potenciali zhvillimor, janë bërë analiza. Ato dosje i ka ministri i Pushtetit Lokal, i cili kundër ligjit prapë, me akt të Qeverisë, e ka ndërruar selinë e komunës së Parteshit në Pasjan. Ka filluar tash ta ndërrojë. Edhe kjo precedent është i rrezikshëm, sepse selia e komunës së Artanës do të kalojë tash prej Bostonit në Kuvçë, apo në vendbanime tjera, sipas logjikës që po shkon dhe duke e zhvendosur, duke e bartur me vendime politike, me akte politike, po e sakatojmë dhe po e degjenerojmë pushtetin lokal, edhe ashtu në krizë institucionale, për shkak të vendimmarrjes së keqe, për shkak të borxheve publike dhe për shkak të shumë problemeve tjera që po i përcjell.

Grupi Parlamentar i LDK-së mendon që është tejkaluar autoriteti ligjor i Qeverisë, duke sjellë këso akte, këso vendime, edhe pse janë popullore.

Nuk dua t’i theksoj vendbanimet që janë prekur. Janë popullore, sepse i prekin njerëzit. Motivi kryesor që të ketë komunë në Kosovë nuk është vendimmarrja. Është hyrja në punë.

A ka Qeveria e Kosovës mundësi ta rrisë në kohën kur Komisioni Evropian ia ka kërkuar asaj reformën e Administratës Publike?

Reforma e tretë në kushtet afatgjata, afatshkurtra dhe afatmesme është reforma e Administratës Publike.

Motivi kryesor është të bëhet punësimi i njerëzve nëpërmjet themelimit të institucioneve, nuk ka mundësi të absorbohet kërkesa, sepse duhet ditur ata njerëz që do të ketë pas prerje të buxhetit të komunës amë dhe prerje të stafit të komunës amë në komunat e reja. Këtë duhet bërë të qartë në fillim, që të ulët kërkesa kryesore dhe pritjet që po shkaktohen atje për motive kryesisht elektorale.

Karakteristikat zhvillimore të vendbanimit, mundësia dhe potenciali zhvillimor i tyre dallojnë shumë, natyrisht nga pjesët e Kosovës.

Por, mënyra se si ka ardhur deri te këto akte vërtet tregon qartë që është bërë pa kurrfarë analize, është bërë pa kurrfarë vlerësimi dhe po e theksoj edhe një herë: dy herë e kam pyet kryeministrin kur do ta bësh rishikimin funksional. Ka thënë brenda vitit. Tri herë e kam thirrur zëvendëskryeministrin Petroviq, që e mbulon pushtetin lokal, ka premtuar që do ta bëjë. Ia kam kërkuar raportin e monitorimit të gjendjes së komunave, e ka dhënë me statistika, por që me shifra nuk tregon asgjë.

Atëherë, krejt në fund, unë thërras, sa nuk është vonë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Fjalën e ka, në emër të Grupit, deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: I nderuar zoti kryetar,
Zonja dhe zotërinj deputetë,

Në emër të drejtësisë, Ushtria Çlirimtare e Kosovës gjendet sërish në shënjestër të padrejtësisë. Prokuroria e EULEX-it ngriti aktakuzat e radhës kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Akuzat kundër të ashtuquajturit tashmë ‘Grupi i Drenicës’ nuk janë akuza thjesht kundër individëve, por një sulm i drejtpërdrejtë ndaj strukturës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ne i shohim këto akuza ndaj UÇK-së me shqetësim shumë të madh dhe nuk mund të mos reagojmë me indinjatë.

Jemi të shqetësuar, sepse këto akuza prekin diçka të çmuar që populli i Kosovës ka ndërtuar në përpjekjen e tij për liri, në luftën e tij. Akuzat dhe dyshimet se gjoja Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka bërë krime lufte, aq më tepër kur këto i drejtohen kreut dhe strukturës udhëheqëse të saj, nuk janë gjë tjetër, përveçse tendencë që këso epitimesh t’i mveshen luftës çlirimtare të Kosovës më shumë se cilido individ të mundshëm të përfshirë në aktakuzë.

Natyrisht se askush ndër ne nuk është kundër drejtësisë. Natyrisht se ne më shumë se kushdo tjetër kemi nevojë për drejtësi dhe këtë e kërkojmë me ngulm. E kërkojmë drejtësinë të vihet në vend për gjithë ato vuajtje që iu shkaktuan popullit të shumëvujtur të Kosovës. Kërkojmë drejtësi për gjithë ata të vrarë e të masakruar në luftën e Kosovës. Kërkojmë drejtësi për gjithë ata të zhdukur që nuk u gjetën kurrë. Kërkojmë drejtësi për gjithë ato dëbime e dhunime që pësuan qytetarët e këtij vendi, për gjithë ato shkatërime e djegie shtëpish. Kërkojmë drejtësi për gjithë ato plaçkitje që iu bënë popullit dhe pasurisë së Kosovës nga pushtuesit.

Pra, më shumë se kushdo tjetër, ne jemi ata që kemi nevojë dhe kërkojmë drejtësi. Madje, këtë drejtësi e kërkojmë me këmbëngulje. Por, kurrësi nuk mund ta pranojmë që kur bëhet fjalë për drejtësinë, të na ofrohet thjesht diçka tjetër në vend dhe në emër të saj, ashtu siç kurrë nuk do të pranojmë që të na afrohet diçka tjetër në vend të lirisë dhe demokracisë në këtë vend.

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Lëvizja “Vetëvendosje” në vazhdimësi e ka kundërshtuar dhe kontestuar EULEX-in si një mision jodemokratik, i cili nuk i jep llogari as popullsisë, dhe as institucioneve të Republikës së Kosovës. EULEX-i, thjesht po e shfrytëzon infrastrukturën e një shteti, të cilin njëkohësisht nuk e njeh. Kundërshtimi ynë ndaj EULEX-it është parimor, e kurrësi sporadik. I bazuar, e jo emocional. I qëndrueshëm, e jo momental.

Qeveria e Kosovës do të duhej të ishte në mbrojtje të vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, para se të bënte deklarata demagogjike vetëm për konsumim të opinionit. Do të duhej ta mbronte luftën e UÇK-së, gjë që nuk e bëri kurrë.

Lufta e Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës ishte luftë e drejtë. Qeveria e Kosovës nuk po e mbron këtë luftë as si histori e lavdishme, as si koncept politik e vizion kombëtar, dhe as pjesëtarët e saj. Përkundrazi, ajo po luan me fatin e kësaj lufte dhe luftëtarëve të saj në favor dhe në kohën e negociatave të padrejta me Serbinë.

Lufta e UÇK-së ishte e drejtë dhe e tillë do të mbetet gjithmonë. Në ndërkohë, ne besojmë fuqishëm në pafajësinë e të akuzuarve dhe presim të shpallen të tillë edhe nga gjykatat e këtij vendi.

Më shumë se kushdo tjetër, janë pikërisht luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që luftuan për drejtësi. Por, këtë drejtësi ata kurrë nuk e gjetën kurë as te UNMIK-u, e as te EULEX-i nuk po e gjejnë dot. Dy gjëra tashmë janë evidente: EULEX-i nuk ofron drejtësi dhe Qeveria nuk ofron mbrojtje për luftën e UÇK-së.

E, njëkohësisht, nuk do duhet të prisnim drejtësi për çlirimtarët aty ku nuk ka drejtësi dhe nuk mund të presim mbrojtje për çlirimtarët aty ku nuk ka vullnet për një gjë të tillë.

EULEX-i dhe Qeveria e Kosovës nuk ofrojnë as drejtësi, e as mbrojtje për UÇK-në.

Prandaj, Kosova do të jetë më mirë kur të mbetet pa të dyja, edhe pa EULEX-in, edhe pa këtë Qeveri.

Vetëm atëherë do të hapet mundësia për drejtësi reale dhe sundim të mirëfilltë të ligjit në Kosovë.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Kymete Bajraktari.

KYMETE BAJRAKTARI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Cila është situata e fëmijëve me nevoja të veçanta në Republikën e Kosovës? Çfarë po bëjmë ne si shoqëri dhe institucione tona për përmirësimin, aftësimin dhe avancimin e pozitës së tyre në shoqëri?

Çdo ditë e humbur e mostartimit të prioritetit për përkujdesje institucionale për këtë pjesë të shoqërisë është ditë e humbur e jetës dhe ardhmërisë së tyre.

Ligji i arsimit, e drejta për arsim, që arsimimi t'u mundësohet të gjithëve pa asnjë diskriminim, në këtë rast nuk zbatohet.

Fëmijëve me nevoja të veçanta u është mohuar arsimimi i mundshëm me arsyetimin se mungojnë mjetet financiare dhe personeli i trajnuar.

Sipas statistikave të marra nga MASHT-i për vitin 2012 dhe 2013 të arsimit parauniversitar, numri i nxënësve në shkollat speciale, klasa të bashkuara dhe të mbështetura, gjithsej është 1 221 nxënës.

Me kërkesën e MASHT-it, bërë institucioneve shkollore, numri i nxënësve me nevoja të veçanta në Republikën e Kosovës tani është 6 093, statistika të përfunduara më datë 13.3.2013.

Nëse i krahasojmë këto, atëherë vërejmë se ndryshimi i numrit të nxënësve me nevoja të veçanta është 4 872 brenda vitit 2013.

Vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta në shkolla e kanë bërë mësimdhënësit, e që sipas udhëzimit administrativ, numër 07/2012, datë 23.5.2012, vlerësimin e nevojave të veçanta e bën ekipi vlerësues, i cili përbëhet nga ekspertë të fushave të caktuara, që është i përshkruar në nenin 4.

Numri 6 093 i fëmijëve me nevoja të veçanta ka rezultuar, pasi vlerësimi është bërë nga mësimdhënësit, statistika këto në të cilat janë përfshirë edhe nxënësit, të cilët

mësimdhënësit i kanë vlerësuar me këto konstatime: Intelekti i dobët, s'mund të flasë dhe të dëgjojë, çalaman, dëmtime intelektuale, pengesa në të pamë, aftësi e kufizuar psikike, diabet, të meta në të folur, deformime të gojës dhe fytyrës, epilepsi, të operuar në kokë e të tjera. Ky është realiteti i dhimbshëm i përgjegjësisë dhe seriozitetit të institucioneve tona, në këtë rast i MASHT-it.

Që ta përmirësojmë, aftësojmë dhe avancojmë pozitën e personave me nevoja të veçanta, kërkojmë nga Qeveria dhe institucionet tona që ta intensifikojmë aktivitetin për evidentimin e personave me nevoja të veçanta, krijimin e statistikave të sakta dhe reale, të krijohen kushte për arsimim dhe edukim, duke përfshirë edhe arsimin parafillor dhe parashkollor dhe krijimin e infrastrukturës ligjore, ku do të përcaktohen të drejtat dhe beneficionet për përkujdesjen shëndetësore dhe institucionale. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Agim Kuleta e ka fjalën.

AGIM KULETA: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Zonja dhe zotërinj deputetë,

Në vjeshtën e vitit të kaluar, Kuvendi i Republikës së Kosovës e miratoi Rezolutën numër 04-R-07, e cila parashihte zëvendësimin e tri kodeve aktuale telefonike me kodin e Republikës së Shqipërisë.

Në funksion të realizimit të këtij qëllimi, kjo rezolutë parashihte fillimin e bisedimeve ndërmjet institucioneve të Republikës së Kosovës dhe atyre të Republikës së Shqipërisë. Këto bisedime ndodhën dhe në sajë të disponimit pozitiv që hasëm te Qeveria shqiptare, ato rezultuan me nënshkrimin e një memorandum bashkëpunimi në këtë fushë, i cili parashihte angazhimin e përbashkët për jetësimin e Rezolutës së Kuvendit të Kosovës. Për ta filluar këtë angazhim, si hap i nevojshëm, është paraparë formimi i grupeve punuese.

Me gjithë shprehjen e gatishmërisë së ministrit Beqaj, nëpërmjet një letre të dërguar në adresën time, formimi i këtyre grupeve nuk ka ndodhur ende.

Megjithëse, siç edhe shihet, janë bërë disa hapa në drejtim të duhur, konsideroj se procesi ka ecur shumë ngadalë dhe kjo zvarritje ka qenë krejtësisht e panevojshme dhe shumë lehtë e shmangshme.

Në ndërkohë, sipas paralajmërimeve nga palët, sot më 30 dhe nesër më 31 maj, ndërmjet delegacionit të Kosovës dhe atij të Serbisë do të vazhdojnë bisedimet teknike për çështjen e telekomunikacionit. Në kuadër të kësaj çështjeje do të bisedohet edhe për kodin telefonik për Kosovën.

Qëndrimi i Serbisë në këto bisedime është që Serbia të kërkojë një numër kod nga ITU, i cili do të konsiderohej kod i Serbisë, mirëpo do t'i jepej në shfrytëzim të përkohshëm Kosovës deri në zgjidhjen e statusit. Në këmbim të kësaj, ata kërkojnë nga institucionet e Kosovës licencën për telefoni mobile dhe fikse në tërë territorin e Kosovës.

Në anën tjetër, i pyetur nga një medium lidhur me mundësinë që Kosova ta marrë kodin e vet telefonik, dje shefi për komunikim me media i ITU-së deklaroi se ITU nuk posedon, as nuk ka rezervuar kurrfarë kod të lefëfonisë për Kosovën, për shkak se Kosova ende nuk është anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, e rrjedhimisht as e agjencive të saj të specializuara, siç është edhe ITU.

Ndërsa më herët, po i njëjti zyrtarë pati deklaruar se Kosova, meqë ende nuk është anëtare e ITU-së, mund ta përdorë cilindo kod të telefonisë. Ajo mund ta zgjedhë atë të Serbisë, Shqipërisë, apo të ndonjë vendi tjetër. Kjo është çështje e Kosovës dhe vendeve me të cilat akordohen për këtë çështje.

Duke i pasur parasysh këto fakte, bisedimet me Serbinë krejtësisht absurde. Për më tepër, ato janë me pasoja të shumta dhe shumë të rënda, politike e juridike.

Në momentin kur pranon të negociosh për një kod, e aq më tepër ta pranosh atë, për të cilin Serbia thotë se do ta marrë në emër të saj dhe do t'ia japë Kosovës në shfrytëzim deri në zgjidhjen e statusit, automatikisht e legjitimon tendencën e Serbisë që statusin e Kosovës ta trajtojë si të padefinuar.

Për më tepër, këtë mohim të statusit tënd po e bën duke i shkelur të gjitha rregullat ligjore që parashohin procedurat për dhënien e licencës operatorëve të telefonisë mobile e fikse për territorin e Kosovës; po e bën këtë duke shkelur...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Edhe 30 sekonda.

AGIM KULETA: Faleminderit!

Lëvizja për Bashkim konsideron se kjo është një lojë e rrezikshme politike e Qeverisë së Kosovës, e cila mund të vazhdojë ta lërë Kosovën me kod të Serbisë, që do të thoshte vazhdim i varësisë nga Serbia në këtë fushë dhe cenim i sigurisë shtetërore.

Prandaj, i bëjmë thirrje kësaj Qeverie që të heqë dorë nga këto bisedime dhe ta vazhdojë më me përkushtim punën në drejtim të pajisjes së Kosovës me kodin telefonik +355, gjë që jo vetëm nuk do të kishte efekte të dëmshme anësore, por do të sillte dobi në çdo aspekt të përmendur më lart. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!
Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,
Ju të pranishëm dhe qytetarë të Kosovës,
Diskutimi im në këtë pikë ka të bëjë me shqetësimin e bashkëvendësve të mi dhe shumë qytetarëve të Kosovës që lidhet me arrestimet në vazhdimësi, edhe këto të fundit që u bëhen luftëtarëve të lirisë.

Jam e bindur se të thuash dhe ta mbrosh të vërtetën për popullin tënd, para së gjithash është obligim, e assesi nuk duhet kuptuar ndryshe.

EULEX-si duhet ta njohë të vërtetën në këto raste. Më lejoni t'i përmend rastet për dy familje, ndër familjet embleme, ku bijtë e tyre janë arrestuar para pakë ditësh.

Sahit Jashari, luftëtar lirie nga Prekazi, në luftën e fundit e dha pjesën më të madhe të familjes së tij të ngushtë, babën, nënën Salë Jashari, tani më heroinë e kombit dhe familjarë të tjerë. Kjo humbje nuk ndodhi në asnjë shtet tjetër, në asnjë luftë ekspansioniste, por këto rënie ndodhën në trojet stërgjyshore, në Prekaz, duke u përballur me ushtri të rregullt e të armatosur deri në dhëmbë të një shteti pushtues dhe kriminal.

Shpëtoi nga kjo luftë Sahiti me plagë të mëdha në trup, i cili u arrestua tash nga misioni EULEX. Vallë, a do të duhej të vritej edhe ky që tash të mos burgosej?! I shtroj pyetje EULEX-it: Kush është arrestuar për vrasjen e familjes së Sahit Jasharit?

Rasti i dytë, vëllezërit Demaku, Zeqiri dhe Jahiri, në luftën e fundit dhanë shumë anëtarë të familjes, vëllanë, motrën, djalë dhe motrë 3-vjeçar, axhën, dy djemtë e axhës, dajën. Po ashtu, fati deshi që këta të shpëtojnë me shumë plagë në luftën e pabarabartë. Pyetje për EULEX: Kush është burgosur për vrasjen e anëtarëve të familjes Demaku? Apo, për të mos u burgosur, do të duhej të vriteshin edhe këta?

Duhet ta dijë misioni EULEX: Kjo familje nga kjo luftë ka fëmijë të gjymtuar dhe, për çudi askush, nga EULEX-i nuk ka filluar hetime kush e la Drenushën e mitur atëherë pa një krah. Ia kujtojmë EULEX-it që kjo vajzë pa një dorë jeton në Evropë, diku në Francën demokratike, dhe askush nuk është gjykuar kurrë për këtë rast. Shtroj pyetje: Çfarë faji kishin fëmijët e Drenicës dhe fëmijët tjerë të Kosovës?

Pyetjet e radhës që i shtroj EULEX-it tani e do t'i shtroj vazhdimisht sa të jetë si ndarës i drejtësisë në Kosovë: A ka dëgjuar për masakrën e grave, fëmijëve e nënave të familjes Deliu nga Abria? A ka dëgjuar për masakrën e Likoshanit? A ka dëgjuar për masakrën në Paklek të Ri? A ka dëgjuar për masakrën e Paklekut të Vjetër? A ka dëgjuar për masakrën e Vërbocit, masakrën e Çirezit, të Izbicës, të Rezallës e shumë masakra tjera, në të cilat kanë mbetur të vrarë e të masakruar me dhjetëra fëmijë, gra, pleq e plaka?...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Jo, keni mundur në emër të Grupit ta bëni një deklaratë të përbashkët. Fjalën e ka nënkryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Faleminderit, kryetar!

Pas marrëveshjes së dëmshme, e cila Serbisë ia dha autonominë politike të veriut të Kosovës, Qeveria e kryeministrit Thaçi vazhdoi me koncesione shtesë ndaj Beogradit edhe me planin e zbatimit.

Marrëveshja Serbisë ia garanton kontrollin mbi Asociacionin e Komunave Serbe të Veriut, legalizimin e strukturave të paligjshme, si dhe ndarjen e një pjese të Gjyqësorit enkas për veriun.

Por, plani i zbatimit kërkon që të gjithë punonjësve të strukturave kriminale të Beogradit t'u ofrohet amnisti, pavarësisht veprimeve të tyre të deritashme.

Kjo do të thotë se organizatorëve të spastrimit etnik të shqiptarëve nga veriu i Kosovës në shkurt të vitit 2000, po u ofrohet amnisti nga drejtësia.

Kjo do të thotë se dorasit e policit Enver Zymberi, i cili ra në mbrojtje të sovranitetit të Kosovës, kanë marrë garanci se nuk do të kapen dhe se do të jetojnë të lirë në Asociacionin e Komunave Serbe, ku do të qeverisin vetë.

Çfarë fitore është kjo? Kujt mund t'i duket fitore një marrëveshje e tillë? Kjo marrëveshje kapitulluese për sovranitetin e Kosovës mund t'i duket fitore vetëm atij që personalisht i ka punët pisk prej dosjeve të korrupsionit.

Këta politikanë, kur u duket një marrëveshje e tillë fitore historike, nuk e shohin realitetin me sytë e qytetarëve, por me zgjatjen e pushtetit të tyre personal edhe për disa muaj. Shikojeni se ku e ka sjellë Kosovën karshi Serbisë politika e Qeverisë sonë. Vjen mu në oborrin e Qeverisë zyrtari i shtetit serb, deklaron se Kosova është serbi dhe atij i duartrokasin.

Kjo politikë e nënshtimit dhe korrupsionit, në njërën anë ka ndikuar që të na mohohen vlerat e luftës çlirimtare, ushtarët e komandantët të përfundojnë burgjeve, kurse, në anën tjetër, kriminelëve serbë, që ia morën jetën Selver Haradinajt dhe shumë shqiptarëve tjerë, t'u ofrohet paprekshmëria nga drejtësia.

Po më duket se dikush në Kosovë, për ta siguruar jetëgjatësinë e pushtetit politik, pas shitjes së pasurisë së Kosovës, dhe koncesioneve të tmerrshme me Serbinë, ka filluar t'i shesë edhe shokët e vet. Tash jemi në fazën e shitjes së shokëve, sepse nuk ka mbetur gjë tjetër pa u shitur.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Ministra dhe kolegë deputetë,

E ngrita dhe do ta ngre një çështje rreth banimeve joformale, pasi më herët e pashë ministrin e Planifikimit Hapësinor, por tani si duket nuk është këtu, për arsye se janë mbi 100 vendbanime joformale, të cilat presin nga Ministria e Planifikimit Hapësinor që të rregullohen.

Unë para disa ditëve, ministrin e Planifikimit Hapësinor e pashë që e kishte rregulluar një çështje shumë humane, çështjen e disa arushave dhe i kishin ndarë diku 15 hektarë tokë dhe është mirë që, në radhë të parë, të zgjidhet problemi i njerëzve për vendbanime joformale, sidomos për pjesëtarët e komunitetit egjiptian, të cilët kohëve të fundit janë duke u ballafaquar me probleme të banimit për shkak të mosrregullimit të vendbanimeve joformale.

Unë e përgëzoj ministrin e Planifikimit Hapësinor për rregullimin e çështjeve edhe të arushave, por është shumë me rëndësi ta rregullojë çështjen e njerëzve, të cilët janë duke jetua në kushte jo të mira, jo normale dhe janë mbi 100 vendbanime. Do të thotë, duhet që këto vendbanime të rregullohen sa më shpejt dhe ekziston një strategji nga viti 2009, por ende nuk është bërë asnjë lëvizje. Do të them që qeveritë të mos përgatitin strategji, të cilat s'mund t'i implementojnë, ose të fillojnë t'i implementojnë.

Është problemi edhe i “Kristalit” në Pejë, është edhe në Gjakovë, edhe në Klinë, ku është një numër i konsiderueshëm i familjeve, të cilat nuk po mund ta rregullojnë çështjen e banimit, të ndërtimit dhe rindërtimit. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja e fundit për këtë pikë të rendit të ditës është Valbona Dibra.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në emrin tim personal shpreh indinjatën për situatën e krijuar pas veprimeve të pamatura të Misionit të Bashkimit Evropian në Kosovë, në vendin tonë.

Vendi ynë e ka një të kaluar, e cila është e pranishme në çdo hap në veprim tonin. Në çdo hap që bëjmë ne përballemi me vuajtjet e këtij populli, me dhimbjen dhe sakrificën e tij.

Tokës së Kosovës ende nuk i janë mbyllur plagët e një pushteti të egër e çnjerëzor, të planifikuar dhe të ushtruar nga shteti serb.

Këto plagë e argumentojnë lirinë tonë, lirinë që e fituam me gjak, lirinë të cilën e gëzojmë vetëm falë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Këta djem e vajza kapën armët për ta mbrojtur pragun e shtëpive të veta, për ta mbrojtur dinjitetin e çdo shqiptari. Lufta e tyre ishte e drejtë dhe çlirimtare.

Kjo ishte pikërisht arsyeja pse bota demokratike u radhit përkrah Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Për këtë falënderimi dhe mirënjohja e popullit të Kosovës ishte dhe është e paskajshme.

Lufta jonë e drejtë u vërtetua dhe u rikonfirmua me lirimin e zotit Limaj, të zotit Haradinaj dhe të shokëve të tij. Por, kjo nuk mjaftoi, sepse në Kosovë vazhduan arrestimet spektakulare të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Misionet e huaja në pamundësi për ta kryer si duhet punën e tyre dhe për ta arsyetuar veten para tatimpaguesve të vet filluan të ushtronin trysni mbi ata të cilët i ofruan bashkëpunim të plotë dhe i pritën pa asnjë pengesë.

Duke besuar në drejtësinë dhe vlerat e propaganduara të Evropës, ne pritëm përmirësim të veprimeve të misionit të EULEX-si për veprimet, por veprimet e tij shkuan duke marrë përmasa shqetësuese.

Për ilustrim të këtyre veprimeve ofenduese dhe të rrezikshme për gjendjen në vend, por edhe për të ardhmen e shtetit të Kosovës, mjafton ta përmendim rastin “Kiçina”, rastin “Kleçka”, “Grupin e Llapit”, “Grupin e Gjilanit”, “Grupin e Dukagjinit” dhe së fundi “Grupin e Drenicës”, celulën e parë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Faktet më të reja në rastin “Kleçka” e vërtetojnë më së mirë qëllimin e këtij personi, i cili me përgjegjësinë më të madhe po i provokon ndjenjat e të gjitha nënave, motrave, vëllezërve, bijave, e bijave të atyre që ranë për lirinë e vendit tonë.

Ai po e ofendon këtë popull, i cili jo që nuk po di se kush u arrestua për krimet që na i bënë, por ende nuk di se ku janë edhe 2 000 trupa të zhdukur gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Arrestimet e fundit e kanë dhënë mesazhin më të qartë që zoti Salustro nuk është personi adekuat në vendin tonë. Ai po u turpëruar e arrestoi Sahit Jasharin, për gjoja vrasjen e komandantit policor serb, por Salustro nuk mendoi t’i tregojë Sahit Jasharit pse nuk po e

ndjek vrasësin e 15 anëtarëve të familjes së tij. T'i tregoj atij pse nuk po i ndjek kryerësit e masakrës së Prekazit, të Likoshanit, të Çirezit,...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Ka kaluar koha, ishin edhe tre veta të paraqitur.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Bytyçi, pyetje për ministrin Agan. Ministri nuk është këtu. Në qoftë se dëshironi ta lexoni pyetje, mund ta bëni.

KYMETE BYTYÇI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë për hir të qytetarëve, do ta parashtroj pyetjen.

Trajtimi jo i mirë gjatë lindjeve ka sjellë si pasojë lëndime serioze, por nganjëherë edhe vdekjen e grave dhe të foshnjave në spitalet e Kosovës.

Palët e dëmtuara kanë paraqitur ankesa te organet përgjegjëse, në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe për këtë e pyes ministrin se çfarë përgjigje kanë dhënë lidhur me ankesat e theksuara dhe çfarë masash ndëshkuese kanë marrë ndaj personelit punonjës në repartet gjinekologjike, që është shpallur fajtor për mostrajtim adekuat të grave gjatë lindjeve dhe si rezultat i këtyre veprimeve ka pasur lëndime serioze, siç e ceka më lart, nganjëherë edhe me pasoja tragjike.

Shpresoj që dikush do t'ia përcjellë pyetjen ministrit Ferid Agani.

KRYESUESI: Besoj që ju ka dëgjuar dhe Administrata është e obliguar t'ia dërgojë pyetjen që e bëtë ju.

Pyetja e dytë është e nënkryetarit të Kuvendit, zoti Konjufca, për ministrin Fadil Ismajli. Ju lus për qetësi, të nderuar kolegë! Lus për qetësi Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike!

GLAUK KONJUFCA: Faleminderit!

Zotëri ministër i Zhvillimit Ekonomik, Fadil Ismajli,

“Olafi”, që është Zyra e Bashkimit Evropian kundër mashtrimit kishte gjetur se kontratat ndërmjet KEK-ut dhe një firme të ndërlidhur me një prej zyrtarëve të lartë të saj, që jeni ju, ishin dhënë pa konkurrencë të drejtë. Këtë pa konkurrencë të drejtë, po e citoj prej raportit dhe prej hetimeve, dhe e akuzonte këtë zyrtar, që jeni ju, për konflikt të interesit.

Firma në fjalë kishte fituar një tender prej 8 milionë eurosh prej KOST-it, që është Autoriteti Publik Përgjegjës për Transmisionin e Rrymës. Pyetja ime është: Zoti ministër, cila është lidhja juaj, apo cila ka qenë lidhja juaj me kompaninë “Komtel”, e cila e mori këtë tender dhe për çfarë tenderësh bëhej fjalë në rezultatet e gjetura si shkelje nga Zyra e Bashkimit Evropian?

KRYESUESI: Zoti ministër Ismajli, e keni fjalën.

MINISTRI FADIL ISMAJLI: Faleminderit kryesues për fjalën!

Përsëritës deputetët e Republikës së Kosovës,

Kabinetin qeveritar,

Dhe njëherësh e falënderoj zotin Konjufca për pyetjen e shtruar dhe për mundësinë që po më jepet të përgjigjem, në rend të parë para qytetarëve të Kosovës dhe para juve, deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës.

Nuk jam përgjigjur veç e veç nëpër shtypin ditor, dhe kjo vërtetë për mua është një kënaqësi që më jepet rasti në këtë mënyrë të ju drejtohem të gjithë juve, por edhe qytetarëve, me një përgjigje, e cila e përmban të vërtetën.

Dëshiroj të jem shumë i qartë që në fillim para jush.

Të gjitha deklaratimet dhe thashethemet nëpër medie që lidhen me pyetjen e parashtruar janë të pabaza dhe nuk qëndrojnë. Ky nuk është vlerësim imi, por është edhe i “Olafit” në të dy rastet që i ka hedhur poshtë këto akuza. Përndryshe, nuk do të isha këtu sot, sepse këto çështje datojnë shumë gjatë. Pra, nuk ka pasur shkelje. Përkundrazi.

Deri pak para ditësh isha kryeshef ekzekutiv i KOST-it, që është shndërruar në një kompani publike dhe shtetërore më të suksesshme në vend, por edhe në rajon.

Për punën time disavjeçare ka shumë auditime që pohojnë se nuk ka pasur parregullsi. Ky është vlerësim i auditorëve të brendshëm, të jashtëm, të auditorëve vendorë dhe ndërkombëtarë, e po ashtu nga Auditori Gjeneral, që w konkludojnë të njëjtën vlerësim pozitiv në gjithë veprimtarinë e ndërmarrjes ku unë jam pothuajse 8 vjet, që nga vitit 2005.

Sa i përket çështjes se cilat janë lidhjet e mia me kompaninë “Komtel”, unë mund të ju them se pronarin e tanishëm të kësaj kompanie e njoh gjatë, qysh para lufte, sepse jemi edhe kolegë në kuptimin e të njëjtit profesion, por edhe miq të mirë. Nuk do ta mbajë të fshehur, as nuk e kam mbajtur asnjëherë.

Ndërsa pas luftës, si shumë të tjerë, secili e ka zgjedhur rrugën e vet, por që nuk e mohoj se kemi punuar para luftës.

Ka me mijëra biznese që formojnë partneritete dhe ndahen, por kjo nuk do të thotë që nuk duhet të mbeten miq dhe shokë.

Unë personalisht jam kthyer aty prej nga na nxorën me dhunë në vitin 1990, domethënë në Elektroekonominë e Kosovës, KEK-un e tanishëm, dhe me entuziazëm iu përkushtova punës për rindërtimin e sektorit të energjisë, për çka edhe ndihem krenar para të gjithëve. Gjithashtu, më vjen mirë, pse jo, që “Komtel”, me punë e profesionalizëm, ka arritur të demonstrojë ekspertizë të shkëlqyeshme në kuadër të veprimtarisë së vet dhe është mirë kur kompanitë tona vendore mund të tregojnë profesionalizëm të lartë edhe të konkurrojnë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti deputet?

GLAUK KONJUFCA: Unë e kam këtu raportin origjinal të “Olafit” dhe këtu në fund te ‘Findings’, që domethënë gjetjet prej hetimit, në pikën 17 dhe në pikën 18, thonë se janë zbuluar parregullsi në prokurim sa i përket çështjes së implementimit të sistemit të kompjuterizimit, në të cilin përfshihet edhe tenderi për të cilin dyshohet, dhe dyshohet se ju, meqenëse keni qenë më herët edhe i përfshirë në këtë firmë, e cila pastaj kur keni dalë

në KEK e ka fituar tenderin 8 milionë euro, ky është një dyshim i bazuar për konflikt të interesi.

Por, pyetja ime është: Si mund të ju besojë populli që do ta bëni zhvillimin ekonomik, kur ju në raportet e Bashkimit Evropian figuroni si një person i cili është i dyshuar për konflikt interesi dhe a besoni se në një shtet të Bashkimi Evropian, një njeri, emri i të cilit përmendet për hetime të tilla, do të mund të bëhej ministër?...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën. Dy minuta i keni.

MINISTRI FADIL ISMAJLI: Tani, në kohët e fundit, mediet dhe jointitucionet po e bëjnë rolin, edhe të akuzuesit, edhe të prokurorit, edhe të tjera.

Në gjithë botën, agjenda të ndryshme sulmojnë njerëz të ndryshëm. Unë mund të ju them edhe qytetarëve, edhe juve, flini shumë rahat, jam shumë konfident për veprimet e mia në botë, e ndiej veten shumë profesionist edhe për pozitën, të cilën aktualisht e mbaj.

Dhe, nëse më lejoni, do ta bëj më shpejt dhe shumë më mirë punën që e planifikoj në të ardhmen.

Përndryshe, për atë që e lexuat nga ai raport, duhet t'i lexoni rekomandimet në fund çka thonë. Nuk bëhet fjalë për një tender, sepse ai tender nuk ka qenë tender i KEK-ut. Ai ka qenë tender i Komisionit Evropian. Ka pasur edhe tenderë që shkruajnë të tjerët dhe që i ka fituar kjo kompani nga USAID-i, edhe nga Banka Botërore. Edhe për ato më sulmojnë mua, thua se unë qenkam një supermen që mund ta dirigjoj edhe USAID-in, edhe Komisionin Evropian, edhe Bankën Botërore. Shikoni, ato dhe do të bindeni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Albana Fetoshi, pyetje për ministrin Fadil Ismajli. E kisha ftuar zonjën Bytyçi, pasi ministri i Shëndetësisë erdhi dhe dëshiron t'i përgjigjet, nëse është diku afër, të futet në sallë për ta dëgjuar përgjigjen. Zonja Fetoshi, e keni fjalën.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryesues!

Pyetja ime është për ministrin e Zhvillimit Ekonomik, Fadil Ismajli. Pyetja është se kjo Qeveri ka premtuar uljen e papunësisë prej 8 deri 10% në baza vjetore në planin e saj

Banjsko, që e ka prezantuar në medie, si dhe ka premtuar politika të favorshme fiskale në drejtim të prodhimit vendor. Asnjëra prej tyre tani më nuk ka ndodhur.

Pyetja konkrete është: Çka do të bëni ju konkretisht për zhvillimin ekonomik të vendit, sepse e dimë se kjo Qeveri nuk ka bërë asgjë konkretisht deri më tani. Pra, a do ta keni ju një qasje pak më ndryshe në këtë drejtim, apo do të vazhdoni me këto politika? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, tre minuta i keni.

MINISTRI FADIL ISMAJLI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Së pari dëshiroj të ju falënderoj për pyetjen,

Sa i përket çështjes së parashtruar në pyetje, unë dëshiroj të rikujtoj që plani i Banjskos ka paraparë një sërë masash, siç janë ruajtja e stabilitetit makrofiskal, ristrukturimi i ekonomisë, që nënkupton privatizimin e ndërmarrjeve publike, investimet në infrastrukturë, zhvillimi i kapaciteteve njerëzore, si dhe ndërmarrja e një sërë masash në përmirësimin e ambientit investiv dhe promovimin e ekonomisë kosovare.

Të gjitha këto masa kanë për qëllim të sigurojnë një rritje ekonomike potencialisht në normën 7 deri 8%. Keni të drejtë.

Dua të ju rikujtoj se gjatë viteve të kaluara, Qeveria e Kosovës ka arritur ta realizojë një pjesë të konsiderueshme të masave të parapara në planin Banjko. Investimet kapitale kanë vazhduar, është ruajtur stabiliteti makrofiskal në bazë të të dhënave dhe janë rivendosur programet me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Është përmirësuar ambienti investiv, siç mund të shihet edhe nga rangimet në indikatorët e ndryshëm, siç është “World bank doing bussines”, domethënë në vendin e 28-të, që është një kërcim prej 10 vendeve. Është privatizuar Distribucioni dhe Furnizimi, dhe është në proces privatizimi i PTK-së.

Si do që të jetë, për shkak të rrethanave ekonomike globale, këto masa ende nuk arritur rritjen e dëshiruar ekonomike, mirëpo kanë siguruar një rritje të konsiderueshme të GDP gjatë viteve të kaluara. Pa dyshim që jemi aktor i recesionit që po ndodh edhe në rajon dhe Evropë.

Pjesës së dytë të pyetjes, për përmirësimin e rritjes, ku do të orientohejmë ose në çka do të koncentrohemi, është përmirësimi i mëtejshëm i ambientit biznesor dhe përmirësimi i klimës investive, promovimi i partneritetit publiko-privat si një instrument shumë i rëndësishëm që ka dhënë suksese në vende të ndryshme të botës, përveç në vendet diktatoriale, dhe shfrytëzimi i përparësive komparative të Kosovës me burimet e Kosovës, siç është energjia, bujqësia, që janë sektorë që do të akcelerojnë veprimtari sekondare dhe përpunuese në vend, që normalisht do të ndikojnë edhe në shtimin e punësimit, edhe në rritjen e zhvillimit ekonomik.

Në këtë segment, duke pasur parasysh që shfrytëzimi, sidomos i pasurive natyrore, do të trajtohet me kujdesin më të madh, sepse është element, i cili duhet t'i nënshtrohet rishikimit të ndarjes nëpër gjenerata të këtyre pasurive, e jo edhe shfrytëzimit të egër. Faleminderit!

KRESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Fetoshi?

ALBANA FETOSHI: Po! Faleminderit, kryesues!

Papunësia në Kosovë arrin shifrën prej 44%, 230 mijë persona të aftë për punë nuk kanë punë, 18% është varfëria ekstreme në Kosovë, meqë me 80 centë në ditë jetojnë qytetarët e vendit. Domethënë 18% është varfëria ekstreme në Kosovë. 76 mijë punëtorë e humbën vendin e punës si rezultat i privatizimit që ndodhi në Kosovë.

Është e qartë se gjendja ekonomike në Kosovë është shumë e rëndë. Çka do të bëni ju ministër konkretisht për ta ndryshuar këtë gjendje, pasi ju këtu i thatë të gjitha të arriturat e Qeverisë që ka bërë për zhvillimin ekonomik të vendit. Unë ju dhashë disa shifra dhe ju tregova se nuk ka pasur zhvillim ekonomik. Këtu jetojmë në një gjendje shumë të rëndë ekonomike. Na thoni diçka konkrete, çfarë do të bëni për ta ndryshuar këtë gjendje, sepse çfarë ka bërë Qeveria deri më tash ne e kemi të qartë. E kemi parë.

KRYESUESI: Zoti ministër, e dëshironi fjalën?

MINISTRI FADIL ISMAJLI: Faleminderit edhe një herë!

Sidoqoftë, për përgjigje më detaje në krejt këto që i dhatë, për një plan më detaj, ju kisha lutë që të më jepni pak kohë. Unë ende nuk e kam një javë ditë prej kur jam në atë zyrë dhe pa dyshim që më duhet pak kohë për të qenë më preciz në krejt këto që thoni. Sigurisht i dhashë tri orientime kryesore nëse e keni përcjellë, se ku do të koncentrohet veprimi dhe plani im. Prandaj, kërkoj ndjesë nëse nuk do të përgjigjem me shifra ekzakte. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Zonjës Bytyçi dëshiron t'i përgjigjet ministri i Shëndetësisë ,zoti Agani. Zoti Agani e keni fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: I nderuar zoti kryesues,

I nderuar zoti zëvendëskryeministër,

Zzëvendëskryeministre,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

E nderuara deputete Bytyçi,

Më lejoni që të ju përgjigjem në pyetjen të cilën e keni shtruar, për çështjen që e keni shtruar, për një preokupim mjaft të madh për Ministrinë e Shëndetësisë, siguria e nënave shtatzëna gjatë lindjes.

Duhet theksuar faktin se me gjithë shumë fjalë të përfolura dhe shumë lajme në opinion, megjithatë në Ministrinë e Shëndetësisë, ashtu siç jeni referuar ju në pyetjen tuaj, në vitin 2012 kanë ardhur vetëm tri ankesa përkitazi me këtë çështje, ndërsa në vitin 2013 i kem shqyrtuar katër ankesa, dhe atë në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor.

Në raport me numrin e shërbimeve brenda vitit, numri i ankesave është relativisht i vogël, edhe pse çdo rast është shumë në këtë aspekt.

Pas inspektimeve janë dhënë rekomandimet, janë marrë masat nga Inspektorati, apo është kërkuar shqyrtimi nga komisionet përkatëse brenda institucioneve, të cilat i kanë rezultuar me masa nga vetë institucioni, apo me verifikim se është ofruar i gjithë kujdesi i mundshëm dhe i nevojshëm. Shembuj konkretë të këtyre rasteve janë këto:

Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare ka pasur të bëjë me çështje të transportit të shtatzënës me autoambulancë nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare për Spital; është dhënë vërejtja me shkrim për punëtorin shëndetësor, ka qenë ankesa lidhur me masën disiplinore kundër mjekut, ka qenë ankesa për fëmijë të lindur të vdekur, ka qenë fjala për një spital rajonal. Tri ankesa kanë qenë lidhur me Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Në të tri rastet janë marrë masa me vërejtje, të cilat u janë dhënë punëtorëve shëndetësorë.

Unë dua të theksoj se Ministria e Shëndetësisë e ka themeluar Bordin për Mbikëqyrjen Etike Profesionale që në fillim të mandatit tim si trup administrativ, me qëllim të mbrojtjes së identitetit, të drejtave dhe lirive njeriut, në përgjithësi.

Në këtë aspekt është nxjerrë edhe udhëzimi i ri administrativ 05/2012 për mbikëqyrjen etike profesionale. Me këtë udhëzim janë themeluar komisionet etike në drejtoritë komunale të shëndetësisë, që e kanë mbuluar edhe këtë çështje, si shkallë e parë e ankesave të qytetarëve.

Bordi për Mbikëqyrjen Etike Profesionale në Ministri i ka themeluar gjashtë komisione etike të pavarura vlerësuese për dhënien e mendimit profesional dhe për kryerjen e ekspertizave.

Ky bord, pas ekspertizave të kryera nga komisionet vlerësuese ka kthyer pesë përgjigje nga pesë kërkesat e parashtruara nga gjykatat, dy përgjigje Gjykatës Themelore në Ferizaj, një përgjigje Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe dy përgjigje ekspertize për Gjykatën Komunale në...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bytyçi, dëshironi të bëni pyetje shtesë?

KYMETE BYTYÇI: Faleminderit, ministër!

Unë desha ta di nëse ka ndonjë gjinekolog të larguar prej punës për këtë çështje, që ju po thoni ndëshkuese.

KRYESUESI: Zoti ministër, urdhëroni!

MINISTRI FERID AGANI: Zonja deputete,

Nëse e keni fjalën për pyetjen konkrete, për gabimet profesionale gjatë lindjes, në qoftë se keni atë pyetje, atëherë jo. Përgjigjja është nuk është revokuar, sepse nuk është konstatuar ajo shkallë e shkeljes së detyrave profesionale. Nga Inspektorati Shëndetësor i është revokuar licenca për një vit një mjeku në nivelin e sektorit privat për shkeljen e detyrave profesionale të punës.

Më lejoni që vetëm ta plotësoj, në qoftë se mund përgjigjen time, ngase isha duke e përfunduar. Në përpjekje të ngritjes së cilësisë së lindjeve, në përgjithësi, të kujdesit për shtatzëna, në takimin e prezantimit të raportit perinatal është diskutuar edhe çështja e auditimit të vdekjeve maternale.

Më 5 dhe 7 qershor, pra pas disa ditëve, do ta kemi një simpozium të organizuar nën ombrellën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, me prani ndërkombëtare, ku do të jenë

të pranishëm të gjithë profesionistët e reparteve të lindjes dhe materniteteve të Kosovës, me ç'rast do të diskutohet në veçanti inicimi i një projekti për shqyrtimin e çdo rasti të vdekjes maternale, e jo vetëm të vdekjes, por edhe të rasteve kur shtatzëna ka qenë në buzë të vdekjes, dhe gjithë kjo në funksion të nxjerrjes së mësimave adekuate që kjo të mos përsëritet në asnjë mënyrë.

Pra, auditimi maternal është një projekt, i cili mendoj se në mënyrën më të mirë do ta adresojë shqetësimin tuaj, i cili është shumë i arsyeshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Fetoshi, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryesues!

Unë edhe në seancën e kaluar e kam tërhequr pyetjen për shkak se përgjigjen rreth kësaj pyetjeje e kam marrë në Komisionin për Buxhet dhe Financa, kështu që nuk e shoh të arsyeshme të përsëritet edhe një herë. Faleminderit!

KRYESUESI: Në rregull! Zoti Ailu, pyetje për ministrin Agim Çeku.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Zoti ministër, kenë deklaruar se afati i dorëzimit të formularëve për statusin e veteranit u shty për datën 15 mars të këtij viti. Jemi në muajin maj dhe nuk ka ndonjë përgjigje publike se çfarë po ndodh me listat dhe, mbi të gjitha, me planifikimin për fillimin e kompensimeve për veteranët.

Në cilën datë fillon shpërndarja e kompensimit për veteranët dhe për të tjerët që i përcakton ligji, që i keni të regjistruar.

KRYESUESI: Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI AGIM ÇEKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

I nderuar deputet Aliu,

Është e vërtetë që më 15 mars ka përfunduar afati i dorëzimit të aplikacioneve për njohjen e statusit të veteranit, invalidit, dëshmorit dhe pjesëtarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Dhe, ne si Komision qeveritar jemi duke punuar në këtë drejtim në mënyrë intensive. Se kur do të fillojë implementimi i kompensimeve, nuk bëhet fjalë për kompensime, se asgjë s'mund t'ua kompensojë kontributin e tyre, por bëhet fjalë për realizimin e benificioneve të ndryshme.

Ne sot e kemi një ligj në fuqi, Ligji numër 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së, familjeve të tyre, i cili ligj nuk parasheh që nga ai veteranët të përfitojnë benificione. Por, ky ligj, në nenin 12, paragrafi 2, thotë: “Të drejtat në benificione për veteranët e UÇK-së dhe kriteret e kualifikimit për njohjen dhe realizimin e tyre do të rregullohen me një ligj të veçantë”. Domethënë, pritet nxjerrja e një ligji të veçantë për këto të drejta në benificione.

Sepse deri tash ne si komision nuk jemi sponsorues të këtij ligji dhe nuk kemi përgjegjësi për draftimin e këtij ligji, por për të filluar gëzimi i këtyre të drejtave duhet ta dimë se sa janë dhe kush janë, dhe kjo është puna e komisionit. Ne si komision e kemi për detyrë që ta nxjerrim një listë të veteranëve, të pjesëtarëve të UÇK-së. Pse po vonohemi? Vonohemi, sepse nga 15 marsi, kur ka përfunduar afati i dorëzimit, i kemi mbledhur të gjitha aplikacionet nga të gjitha zyrat, nga të gjitha ambasadat, konsullatat, qendrat e paraburgimit, e tjerë e tjerë, dhe sot i kemi në Sekretarinë e Komisionit 57 556 aplikacione për veteranë, 5 721 aplikacione për invalidë, 3 062 aplikacione për statusin e Dëshmorit të Kombit, çka do të thotë se sot në Sekretari janë 66 339 aplikacione.

Çfarë jemi duke bërë? Sekretariati i Komisionit është duke i sistemuar të gjitha këto aplikacione të marra nga zyrat e ndryshme në bazë të strukturës së UÇK-së, duke filluar nga Shtabi i Përgjithshëm, zonat operative, brigadat, batalionet, kompanitë deri në togje, që ta lehtësojë punën e komisionit dhe duke e përgatitur dosjen e një zone apo një tjetre, që komisioni të fillojë dhe të bëjë verifikimin e tyre. Kjo kërkon punë, sepse një ushtar i një zone nuk ka aplikuar vetëm në atë zonë, por varësisht ku janë gjendur, në komuna të ndryshme ku jetojnë e punojnë, jashtë vendit, e tjerë e tjerë, dhe kjo ka kërkuar punë.

Njëkohësisht, ne si komision e dimë, e dini edhe ju dhe opinioni, se nuk kanë qenë 57 556 luftëtarë, por ne jemi duke bërë përpjekje që të bëjmë kategorizimin e këtyre veteranëve. Nuk mund t'i vëmë në një kategori edhe luftëtarët që kanë qenë të uniformuar,...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti Aliu, dëshironi pyetje shtesë?

LIBURN ALIU: Çështja e njohjes së statusit të veteranit, pavarësisht kategorizimeve, dhe vonesave, a ka të bëjë me zgjedhjet dhe a pritet që përfundimi i tyre të ndodhë pas zgjedhjeve, sepse kur kemi të bëjmë me një shifër kaq të madhe dhe gjendjen e njerëzve që janë peng dhe presin përgjigje, kjo ndikon drejtpërdrejt në ta, sidomos kur me këtë ka të bëjë Qeveria apo pushteti drejtpërdrejt me fatin e tyre.

KRYESUESI: Zoti Çeku, urdhëroni!

MINISTRI AGIM ÇEKU: Me plot përgjegjësi e them se kjo nuk ka fare të bëjë me zgjedhjet. Përkundrazi, si kryetar komisioni, unë vazhdimisht kërkoj nga kryeministri që ta përshpejtoj këtë çështje sa më shumë, por ne nuk jemi duke punuar nën presionin kohës, jemi duke punuar në presionin e të drejtës, që të mos i hyjmë në hak askujt. Kështu që bëhet fjalë për atë që ne duhet ta bëjmë një kategorizim, të pajtohemi si komision dhe atëherë sponsoruesve të ligjit t'ua japim propozimin tonë se si të kategorizohen: veteranë luftëtarë, veteranë pjesëtarë, veteranë mbështetës të UÇK-së, apo veç ka mendime të ndryshme. Ne në këtë kohë jemi duke i harmonizuar këto qëndrime dhe si komision do të dalim me një propozim konkret para Qeverisë që këto kategori edhe t'i legjitimojmë me një ligj të ardhshëm dhe kur të aprovohet ligji, atëherë fillon edhe shfrytëzimi i të drejtave të tyre në benificione. Prapë po them, s'ka fare të bëjë me ndonjë agjendë politike, por thjesht është punë e zorshme, e mundimshme, dhe dëshirojmë ta bëjmë një herë edhe përgjithmonë të dimë se kush çka ka qenë, sa kemi qenë dhe kush janë ata që kanë qenë në luftë.

KRYESUESI: Zonja Haxhiu, pyetje për zëvendëskryeministrin Kuçi.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Në planin e zbatimit të marrëveshjes Kosovë-Serbi, në pikën një të planit, përveç tjerash, thuhet: “Deri në mes të qershorit, të dyja palët do t'i kenë miratuar të gjitha ndryshimet e domosdoshme ligjore të kërkuara për zbatimin e marrëveshjes së parë, përfshirë këtu edhe Ligjin për amnisti”. Andaj, pyetja për zotin Kuçi është se cilat kategori të të dënuarve do të përfshijë Ligji për amnisti në lirim prej mbajtjes së dënimit apo ndjekjes penale? A do të amnistohen strukturat kriminale lidhur me veprat e caktuara penale? Pra, më konkretisht a do të amnistohen vrasësit e Enver Zymberit dhe të Selver Haradinajt?

Sigurisht që mosprania e zotit Kuçi tregon se vërtet e kanë në plan që t'i amnistojnë strukturat kriminale në veri. Unë i bëj thirrje zotit Kuçi që të mos fshihet, por le të vijë në Kuvend dhe ta tregojë publikisht të vërtetën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Hoti, pyetje për ministrin Rexhepi.

AFRIM HOTI: Faleminderit, kryesues!

Gjatë fundvitit të vitit 2012 dhe muajve të parë të vitit 2013 ishim dëshmitarë të aferës korruptive me pasaporta biometrike dhe 1,4 milion euro të humbura.

Aktualisht, gati gjysmë viti më pas, nuk ka asnjë hap apo veprim konkret nga Ministria e Punëve të Brendshme në lidhje me këtë rast. Disa zyrtarë rreth e përqark ministrit u pezulluan, disa edhe u larguan, por se ku mbetën paratë e buxhetit të shtetit dhe se ku u gjetën paratë për tenderin e ri, ende askush nuk ka dhënë përgjigje.

Prandaj, zoti ministër pyetja është: Ku janë 1,4 milion euro, cili është përgjegjësi për aferën e pasaportave biometrike?

KRYESUESI: Zoti Rexhepi, e keni fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuar kryesues,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Në lidhje me çështjen që e shtroi deputeti Hoti, unë kam bërë shpjegimet në interpelancën që ka qenë më parë. Sa për hir të opinionit dhe informimit të qytetarëve, në këtë vlerë si thuhet se është dëmtuar buxheti, pasaportat ne i kemi marrë, i kemi shpërndarë te qytetarët dhe këtë shumë po ashtu ia kemi paguar kompanisë nëpërmjet nënkontraktorit. Ne i kemi ndërmarrë masat që janë konform kompetencave tona dhe i kemi adresuar që të bëhen hetimet. Ky rast është proces gjyqësor, që edhe unë kisha dashur sa më shpejt të përfundojë dhe të dihet se ku janë.

Dhe, me qenë se është në proces gjyqësor, atëherë nëse eventualisht i japim ndonjë përgjigje, duhet t'i drejtoheni gjyqit apo prokurorëve, për arsye se është nën hetime. Unë nuk i di të dhënat se kah kanë shkuar dhe pres me padurim që bashkërisht me ju ta dimë se çfarë ka ndodhur.

KRYESUESI: Pyetje shtesë, zoti Hoti?

AFRIM HOTI: Ministër, në ministrinë tuaj janë bërë disa largime për të shpëtuar ju vetë, ndërsa as ata që janë larguar nuk janë shpallur as fajtor, as janë në ndonjë hetim, as nuk po tregojnë se çfarë ndodhi me paratë e tenderit.

Por, as ju nuk jeni deklaruar që ata janë përgjegjës për këtë punë. Në vendet me drejtësi të konsoliduar, hetimet bëhen shumë shpejt dhe organet e hetuara e japin gjithë informacionin e duhur për këtë punë. Ne nuk kemi informacione se si jeni duke i ndihmuar prokuroritë, por vetëm e dimë që në njërin anë i keni larguar disa njerëz sa për sy e faqe, ndërsa në anën tjetër ia keni mbyllur gojën Natalia Velijajt. Në fakt, ndihma do të ishte dorëheqja e juaj e menjëhershme dhe hapja e rrugës së drejtësisë.

Ministër, kush i mori vërtet 1,4 milion euro?

KRYESUESI: Zoti ministër, urdhëroni!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit!

Edhe më parë thashë se kam marrë masa konform kompetencave që kam pasur, e jo për ta mbrojtur veten, por nëse kam pasur ndonjë përgjegjësi objektive në menaxhim të kontratës.

Dua të ju informoj zoti deputet që unë as nuk jam hetues, as nuk jam prokuror, prandaj unë nuk mund ta përshpejtoj procesin gjyqësor. Publikisht kam thënë që kisha dashur që të kryhet kjo sa më shpejt, por aq janë kompetencat e mia dhe në shtetet demokratike këto janë disa norma, të cilat duhet t'i respektojmë.

Prandaj, se ku kanë mbetur ato shpresojmë që me përfundimin e procesit gjyqësor do të jenë të qarta krejt dhe aty do të shihet që absolut ministri s'ka qenë i përzier me këto gjëra.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Ramë Buja.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Duke pasur parasysh mungesën e madhe të studentëve të shkencave natyrore konkretisht në drejtimin matematikor, edhe me gjithë faktin se regjistrimi ishte pa provim pranues, sot ligjëratat në këto drejtime mbahen me numër shumë të vogël të studentëve.

Zoti ministër, pyetja ime është: Çfarë është bërë me projekt-propozimin për themelimin e Gjymnazit Matematikor në Prishtinë, projekt i punuar nga ekspertët e fushës përkatëse?

KRYESUESI: Zoti ministër Buja, e keni fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: Zoti kryesues,

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Haxhiu,

Projekt-propozimin ose propozimin e parë para një viti e ka bërë Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ose ministri i saj, dhe i ka ftuar përgjegjësit e Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore për ta hartuar një elaborat për bërjen e një gjimnazi matematikor për nxënësit elitarë, e kemi mjaft të tillë në Kosovë, shyqyr Zotit! Kështu që para një muaji e 6 ditësh saktësisht e kam marrë elaboratin nga ky grup profesorësh dhe tash jemi në fazën e bërjes së komisionit: Ministria e Arsimit, Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore dhe Komuna e Prishtinës, dhe natyrisht jemi duke biseduar me Komunën e Prishtinës se ku ta vendosim gjimnazin, të cilën pretendojmë ta bëjmë.

Dhe, ky do të jetë gjimnaz vetëm në Prishtinë dhe do të jetë gjimnaz për tërë Kosovës, jo vetëm i një komune. Faleminderit!

KRYESUESI: Pyetje shtesë, zonja Haxhiu?

TEUTA HAXHIU: Desha më tepër një koment, për t'i treguar ministrit se është vonuar pak në këtë. Ky takim ka ndodhur para një viti me ju ministër, por edhe kur ka qenë ish-ministri Hoxhaj, kanë premtuar shumë, por në fakt po frikohem që kjo prapë do të vonojë.

Të gjitha vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim i kushtojnë kujdes të veçantë cilësisë së përgatitjes së nxënësve nga fusha e matematikës dhe aplikimi i kësaj fushe në shumë fusha të tjera.

Prandaj, ky gjimnaz ka ekzistuar edhe në vitin 1972 deri në vitin 1981, por është shuar pa asnjë arsye. Nga ky gjimnaz janë pikërisht edhe këto kuadro që e kanë përgatitur këtë projekt, prandaj unë uroj që ky projekt të implementohet, pra të realizohet nga ju.

KRYESUESI: Zonja Gashi, pyetje për kryeministrin Thaçi. Kryeministri nuk është këtu, dëshironi ta bëni pyetjen?

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryesues!

Më 21 shkurt të këtij viti, Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka mbajtur një debat parlamentar dhe e ka miratuar një mocion në lidhje me qindra punëtorë të Fabrikës së Tubave të Çelikut në Ferizaj.

Mocioni thotë që Qeveria e Republikës së Kosovës, Agjencia Kosovare e Privatizimit, si dhe organet tjera kompetente ta bëjnë ekzekutimin në afat katërmujor të aktgjykimeve të gjykatave kompetente për pagat e papaguara të punëtorëve të Fabrikës së Tubave të Çelikut në Ferizaj.

Më 21 qershor të po këtij viti bëhen 4 muaj nga miratimi i mocionit dhe ne nuk dimë asnjë informatë në lidhje me këtë, e punëtorët po i vazhdojnë protestat e tyre.

Është dashur që sot kryeministri të jetë këtu dhe të na tregojë se deri ku ka ecur procesi. Mirëpo, meqë sot nuk është, pres përgjigje në seancën e radhës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Gashi.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Më 2 nëntor 2011 e kemi vendimin e kryeministrit të Kosovës me numër 02/46 mbi ndalimin për tre vjet të shfrytëzimit-eksplorimit të inerteve nga shtretërit, brigjet dhe hapësirat përreth lumenjve në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Me këtë vendim obligohen katër ministri në zbatimin e ndalimit të shkatërrimit të mëtutjeshëm të lumenjve tanë.

Pyetja ime është: Ku është përgjegjësia e ministrisë suaj dhe sa ka bërë kjo ministri në këtë drejtim dhe deri ku ka arritur zbatimin e këtij vendimi në ndalimin e këtij fenomeni tepër të dëmshëm që pas luftës po i degradon lumenjtë tanë, duke i shndërruar ato hapësira në diçka të shëmtuar që u ngjajnë arenave të pajetë dhe të lënë pas dore, duke e degraduar dhe dëmtuar rëndë tërë ciklin e një mjedisi të ruajtur dhe të pastër në ato hapësira.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, urdhëroni!

MINISTRI DARDAN GASHI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Kolegë të Kabinetit,

E nderuara deputete Haxhiu,

Çështja e degradimit të lumenjve nuk është çështje që ka ndodhur vetëm pas luftës, por është e trashëguar që nga paralufta. Mirëpo, është e vërtetë se shkatërrimi i theksuar është intensifikuar pas çlirimit.

Duke pasur parasysh situatën e mjerueshme në terren, me propozim tim, Qeveria ka vendosur moratorium trevjeçar në shfrytëzimin e lumenjve si burim i lëndës së parë.

Vendimi ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2012 dhe që atëherë janë anuluar të gjitha licencat dhe lejet për kompaninë që kanë vepruar në shtretërit e lumenjve dhe të atyre në afërsi të ndaluara të brigjeve të lumenjve.

Nga gjithsej 130 kompani, sa kanë operuar para vendimit, vetëm 14 kompani të cilat operojnë në distancën e lejuar nga lumenjtë dhe që nuk përdorin zhavorrin e lumenjve janë lejuar ta vazhdojnë aktivitetin.

Për kompanitë që nuk janë bindur në bashkëveprim me KPPM-në dhe Policinë e Kosovës janë ndërmarrë 19 aksione konfiskime dhe janë konfiskuar mjete të rënda eksploative dhe të transportit.

Njëkohësisht, Ministria, që nga ajo kohë ka financuar 21 projekte të ndryshme anembanë Kosovës për rehabilitimin e shtretërve të lumenjve në shumën prej mbi 6 milionë euro.

Për fund dua të theksoj që nga vendimi është reduktuar në masë të madhe shkatërrimi i lumenjve, mirëpo ende ka aktivitete legale dhe Ministria me vetëm 15 inspektorë për gjithë territorin e Kosovës nuk është në gjendje ta kontrollojë në mënyrë sistematike tërë territorin.

Andaj, ndihma e komunave, e Policisë dhe e qytetarëve është shumë e nevojshme për t'i shpëtuar lumenjtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu, pyetje shtesë?

TEUTA HAXHIU: Situata në terren tregon një pamje krejt tjetër, ku institucionet e shtetit në mënyrë të heshtur janë dorëzuar përballë këtij fenomeni. Cili është rezultati real i këtij vendimi të kryeministrit, zoti ministër, përveç disa çrregullimeve që u kanë shkaktuar operatorëve që kanë punuar me letra, pak a shumë të zyrtarizuar. Pas këtij vendimi dhe mosveprimi nga Ministria juaj, u keni krijuar parakushte që edhe këta operatorë të shfrytëzimit të inerteve të veprojnë në të zezë dhe shfrytëzimi tash është edhe më i egër,

edhe më i papenguar. Në vend që të sistemoheshin këta operatorë, ata janë shtyrë që të mbijetojnë duke vepruar në të zezë në shfrytëzimin joligjor të interteve të lumenjve, edhe ashtu të shkatërruar të Kosovës.

KRYESUESI: Zoti Gashi, urdhëroni!

MINISTRI DARDAN GASHI: E nderuar deputete,

Si duket, brenga juaj është për operatorët, e jo për lumenjtë. Unë ju thashë se prej vendimit e deri sot janë bërë 19 konfiskime, do të thotë në 19 raste të ndryshme. Kompanive, të cilat kanë pasur licenca, u janë marrë, dhe operojnë 14 kompani, të cilat kanë të drejtë të operojnë, që nuk operojnë brigje të lumenjve.

Unë po ashtu e theksova se ka aktivitete ilegale. Është e vërtetë. Edhe këtë vit kemi ndërmarrë aksione konfiskimesh dhe arrestimesh, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, dhe jemi çdo herë në terren. Po ashtu, e theksova se me 15 inspektorë, të cilët janë përgjegjës edhe për urbanizëm, edhe për mjedis, edhe për ujëra, Ministria nuk ka mundësi për gjithë terrenin. Komunitat janë përgjegjëse, edhe komunitat që qeverisen nga ju, dhe për këtë arsye kërkoj që të kemi bashkëpunim më të afërt në këtë punë, e jo që të mbahen brengat e operatorëve, të cilët me vite e me dekada i kanë shkatërruar lumenjtë.

KRYESUESI: Faleminderit!

Faleminderit edhe juve, zonja deputete. Unë desha të bashkëngjitëm me deputeten dhe vërtet të ju them, zotëri ministër, nuk e di kush është përgjegjës, komuna apo ministria, por e vërteta është që ekziston një masakër ambientale përreth lumenjve kudo në Kosovë, ku ka rënë. Argjinatura e lumenjve është shkatërruar. Janë shkatërruar flora dhe fauna.

Dikush duhet të jetë përgjegjës, dikush duhet të shkojë para gjykatave dhe ç'është dëmi më i madh, ne e kemi pasur një sistem ujitës në Kosovë, i cili është bërë nëpërmjet lumenjve dhe nëpërmjet të cilit janë ushqyer qytetarët e Kosovës.

Nga kjo masakër ambientale që është bërë nëpërmjet shkatërrimit të të ashtuquajturave 'grazhdie', sepse penda nuk ka pasur më përpara, dhe shkatërrimit të argjinaturave të lumenjve, një pjesë e madhe e fshatrave ka ngelur dhe në pamundësi ujitjeje të tokave të tyre dhe të produkteve të tyre.

Prandaj, unë mendoj që do të duhej urgjentisht që të veprohet konform ligjeve në fuqi, që të gjithë ata që kanë bërë vepra penale të japin llogari para gjykatave, e jo të flasin për vendime. Faleminderit!

Deputetja Gashi, pyetje për kryeministrin Thaçi. Dëshironi ta bëni pyetjen? Jo. Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për zëvendëskryeministrin Kuçi. Zëvendëskryeministri nuk është këtu. Dëshironi ta bëni pyetjen/

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në një deklaram publik në lidhje me **njësinë** e veçantë të Gjykatës së Apelit në veri, tha se duhet të sqarohet ende për shkak se flitet edhe për një Divizion të Apelit të kësaj Gjykate. Gjithashtu, ai tha se me Ligjin e gjykatave është paraparë vetëm një Gjykatë e Apelit në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Pra, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ende nuk e di se si do të rregullohet çështja e mungesës së bazës ligjore që të ekzistojë një Divizion i Apelit, se si do të sistemohet ai panel, do të rregullohet më tutje me marrëveshje dhe implementim të marrëveshjes, që është në proces e sipër, tha zoti Peci.

Pyetja për ministrin Kuçi është se meqë në seancën e 16 majit, në kohën e pyetjeve parlamentare në lidhje me këtë çështje, tha që me vete në delegacion kishte kryetarin e Këshillit Gjyqësor dhe atij Prokurorial dhe se ata kishin rënë dakord për pikën 10 të marrëveshjes. Pse tash kryetari i Këshillit Gjyqësor, zoti Enver Peci po shpreh këto shqetësime të cilat i kemi edhe ne dhe se a e shkel pika 10 e marrëveshjes Ligjin për gjykatat dhe a e cenon sistemin tonë të drejtësisë?

Sigurisht që mungesa e tij në kohën e pyetjeve parlamentare për dy seanca me radhë është e qëllimshme dhe është përgjegjësi ndaj këtij Kuvendi dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës e gjithashtu, më duhet të them se është edhe shkelje e Rregullores dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës, meqë Qeveria e ka për obligim që t'i raportojë Kuvendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zëvendëskryeministri nuk është këtu. I fundit është zoti Aliu, pyetje për zëvendëskryeministrin, Kuçi. Dëshironi ta bëni pyetjen? Zoti Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Pyetja ime kishte të bënte me Samitin e Ohrit dhe vazhdon të jetë aktuale, por zoti zëvendëskryeministër nuk qenka këtu. Pra, Samiti i Ohrit edhe përkundër faktit që është anuluar nga Maqedonia nuk kemi tërheqje nga qëndrimi i saj në raport me Kosovën. Rrjedhimisht, i bie ende që çështja e fusnotës të jetë temë e diskutimit, se a do të duhet të kemi edhe një fusnotë të re apo si do t'i zgjidhen tani çështjet e samiteve në nivel rajoni?

Pra, po e presim që ministri herën tjetër të vijë dhe t'ia bëjmë pyetjet më konkretisht.

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produktet e ndërtimit

Ju lus që deputetët të vijnë në seancë për të votuar. Zonja Zhivković e ka kërkuar fjalën.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvaljujem predsedavajući!

Ja bih vrlo kratko jednu informaciju i zahtev vezano za pomenuti nacrt Zakona o građevinskim proizvodima.

Naime obraćam se Skupštini u svojstvu predsednika Komisije za prava i interese zajednica, da ovaj zakon nije prošao procedure kroz ovu komisiju, te bih s toga bilo neophodno odlaganje za neku od narednih sednica vezano za ovaj nacrt zakona. Hvala!

KRYESUESI: Pra, ne nuk kemi pse të diskutojmë. Duhet të kalojë në procedura, pastaj ta shqyrtojmë.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për treguesit gjeografikë

Në sallë janë 65 deputetë.

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për treguesit gjeografikë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Zenun Pajaziti, që ta arsyetojë raportin me rekomandime. Zoti Pajaziti e keni fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka shqyrtuar Projektligjin për treguesit gjeografikë dhe i sugjeron Kuvendit për aprovim. Faleminderit!

KRYESUESI: Në projektligj janë propozuar 42 amendamente, të propozuara nga Komisioni FunkSIONAL. Fillojmë votimin.

Amendamenti i parë.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti i dytë.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti i tretë.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti i katërt.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet!

Amendamenti i pestë.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti i gjashtë.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti i shtatë.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti i tetë.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti i nëntë.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti i dhjetë.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 11.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 12.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 13.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 14.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 15.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 16.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 17.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 18.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 19.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 20.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 21.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 22.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 23.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 24.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 25.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 26.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 27.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 28.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 29.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 30.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 31.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 32.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 33.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 34.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 35.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 36.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 37.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet!

Amendamenti 38.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 39.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 40.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 41.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 42.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet!

Votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Në sallë janë 71 deputet. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim elektronik. Votojmë tani.

Faleminderit! Më 68 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin nr. 04/L-137 për treguesit gjeografikë për emërtime të origjinës.

Pika e pestë e rendit të ditës është:

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për odat e profesionistëve shëndetësorë

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për odat profesioniste shëndetësore të Kuvendit dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj raportuesen e Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, deputeten Mustafa, që të arsyetojë raportin me rekomandime.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,
Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në mbledhjet e mbajtura e ka shqyrtuar Projektligjin dhe ka pasur mjaftë debate për këtë projektligj.

Projektligji nga të gjithë anëtarët e Komisionit është konsideruar si shumë i rëndësishëm, i cili rregullon një fushë që ka të bëjë me themelimin dhe funksionimin e odave të profesionistëve shëndetësor.

Në komision është diskutuar dhe janë propozuar amendamente, të cilat e plotësojnë Projektligjin dhe njëherësh e bëjnë më të kuptueshëm dhe rrjedhimisht më funksional.

Kundërshtime ka pasur rreth mënyrës së financimit të odave.

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 24 prill 2013, diskutoi raportin me amendamentet e propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim. Komisioni njëzëri miratoi raportin përfundimtar dhe i rekomandon Kuvendit ta votojë Projektligjin me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, njëherësh të mbështetura nga Komisioni Funksional.

Andaj, ju ftoj që ta përkrahni këtë projektligj.

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara.

Amendamenti i parë. Komisioni për Buxhet dhe Financa, me përkrahjen e Komisionit Funksional, kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet

Amendamenti i dytë. Deputeti Bekim Haxhiu, me përkrahjen e Komisionit Funksional. Zoti Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Grupi ynë Parlamentar do ta kundërshtojë këtë amendament, meqë e konsiderojmë që edhe një Odë e re shtesë do të hapë pastaj rrugën për kërkesa për oda të tjera. Do të thotë, pavarësisht që mund të ketë specifika të veçanta çështja e Odës së Fizioterapeutëve, po ashtu ka në shëndetësi lëmi të ndryshme, të cilat kanë specifikat e veta të veçanta dhe do të hapet mundësia pra, të kemi oda të reja. Pra, do të bëjmë në njëfarë mënyrë diskriminim kundrejt disa çështjeve ose disa mjekëve të tjerë, që janë të specializuar në lëmit tjera në këtë rast, prandaj nuk e shohim të arsyeshme që duhet të ketë edhe një Odë shtesë, siç është Oda e Fizioterapeutëve.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Ky amendament ka kaluar në Komisionin Funksional. Është përkrahur me unanimitet, nuk ka pasur asnjë kundërshti në Komisionin Funksional. Ftoj deputetët që ta votojnë. Nuk bëhen ligjet për hatër apo për individë të caktuar apo për inati të dikujt tjetër, ligji bëhet për qëllime dhe në kuadër të shfrytëzimit të gjithë profileve shëndetësore dhe

propozimi është bërë në kuadër të profileve shëndetësore, të cilat i prodhon Fakulteti i Mjekësisë.

Dhe, i ftoj deputetët që ta përkrahin për arsye se është interes i profesionistëve shëndetësorë që të jenë të organizuar në këtë formë dhe kjo ka kaluar edhe në Komisionin Funkcional pa asnjë kundërshti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E hedh në votim elektronik, meqenëse ka të deklaruar kundër.

Votojmë amendamentin e dytë me elektronikë. Regjia dhe deputetët, votojmë tani.

Faleminderit! Me 48 vota për, 6 abstenime, 9 vota kundër, miratohet amendamenti i dytë.

Amendamenti 3.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 5.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 6.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 7.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 8.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 9.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 10.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 11.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 12.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 13.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 14.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 15.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 16.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 17.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 18.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 19.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 20.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet!

Amendamenti 21.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 22.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 23.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 24.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 25.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 26.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 27 është i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. A dëshiron dikush të flasë? Nuk dëshiron. Atëherë e hedh në votim elektronik.

Është një amendament numër 27 i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Askush nuk dëshiron të sqarojë më shumë. Votojmë tash!

Regjia. Ju lus të votoni. Me 37 vota kundër, 22 për, 5 abstenime, nuk miratohet amendamenti 27.

Amendamenti 28.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 29.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 30.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 31.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 32.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 33.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 34.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 35.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 36.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 37.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 38.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 39.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 40.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 41.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 42.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë, votojmë Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tani.

Konstatoj se me 72 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin nr. 04/L-150 për odat e profesionistëve shëndetësor.

Pika e gjashtë e rendit të ditës është:

6. Shqyrtimi i raportit vjetor mbi gjendjen në Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës për vitin 2011

Raportin vjetor mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2011 e ka shqyrtuar Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Kryetari i Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, zoti Vehapi e ka fjalën për arsyetimin e raportit me rekomandime.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 67 dhe 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 8.5.2013, shqyrtoi Raportin vjetor mbi gjendjen në Shërbimin civil të Republikës së Kosovës për vitin 2011 dhe vendosi, që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim:

- Të miratohet Raporti vjetor mbi gjendjen në Shërbimin civil të Republikës së Kosovës, për vitin 2011.

Arsyetim:

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 8.5.2013 e ka shqyrtuar Raportin vjetor mbi gjendjen në Shërbimin civil të Republikës së Kosovës për vitin 2011 dhe vlerësoi se Raporti vjetor i punës është në pajtim me nenin 6 të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë mendoj që do të duhej të ketë ekspeditet kjo punë, në 2013-ën për ta miratuar raportin e 2011-ës, pak si vonë. Fjalën e ka sipas Rregullores, përfaqësuesi i Qeverisë, zoti Yagcilar.

MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit, kryesues i seancës!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Bazuar në nenin 6, paragrafi 1 i Ligjit për Shërbimin Civil, ku thuhet se Qeveria e Republikës së Kosovës përcakton drejtimet kryesore të politikave shtetërore në Shërbimin Civil, mbikëqyr zbatimin e këtyre politikave dhe i raporton Kuvendit të paktën një herë në vit për gjendjen në Shërbimin Civil, më lejoni që të paraqes Raportin e Shërbimit Civil në Republikën e Kosovës për vitin 2011, i cili është raporti i parë që i paraqitet Kuvendit, pas aprovimit të ligjit në tetor të vitit 2010.

Ministria e Administratës Publike, më 24 shtator të vitit 2012, ka dërguar raportin në fjalë për aprovim në Qeveri, ndërsa më 3 tetor të vitit 2012, është aprovuar në mbledhjen e 93-të të Qeverisë.

Të nderuar deputetë, me miratimin e ligjeve për Shërbimin Civil, për pagat në Shërbimin Civil, për administratën shtetërore dhe për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, u shënuar fillimi i realizimit të reformave në Shërbimin Civil.

Është krijuar baza ligjore për kalimin nga sistemi i pozitës në një sistem të karrierës të bazuar në parimet e meritës. Zbatimi i reformës në institucionet e administratës shtetërore është udhëhequr nga parimi i respektimit të mundësive të barabarta për komunitete dhe gjini.

Zbatimi i ligjeve të përmendura më sipër do të mundësohej nëpërmjet hartimit dhe miratimit të legjislacionit sekondar si dhe krijimit të mekanizmave të nevojshëm për zbatimin e tyre. Viti 2011 ka shënuar një sërë rezultatesh në kuadrin ligjor. Janë miratuar këto rregullore:

- Rregullorja për ndërprerjen, pezullimin dhe përfundimin e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil.
- Rregullorja për punën provuese të nëpunësve civilë,
- Rregullorja mbi dosjet dhe regjistrin qendror të nëpunësve civilë,
- Rregullorja për procedurat e zgjedhjes së kontestëve dhe ankesave,
- Rregullorja për procedurën disiplinore në Shërbimin Civil dhe Rregullorja për pushimet e nëpunësve civilë.

Kurse, nga ana e Qeverisë është aprovuar Rregullorja për pushimet e nëpunësve civilë.

Legjislacioni i ri kufizon fushëveprimin e Shërbimit Civil në poste profesionale dhe administrative në nivelin qendror dhe në administratë komunale, duke përjashtuar kështu kategoritë e nëpunësve publikë të angazhuar në ofrimin e shërbimeve si mësuesit, punëtorët e shëndetësisë dhe ata të zbatimit të ligjit dhe rendit, si gjykatat, doganat, policia, pjesëtarët e forcës së sigurisë, e të tjerë, të cilët do të kenë status të veçantë dhe struktura të ndara të pagës dhe gradimit.

Në këtë aspekt, struktura e të punësuarve në sektorin publik është:

- 24% nëpunësit civilë,
- 42% në arsim,
- 16% shëndetësia,
- 10% policia,

- 4% FSK-ja,
- 4% të tjerë.

Kuadri ligjor i ri ndryshoi në mënyrë drastike sistemin e Shërbimit Civil dhe ka pasur një ndikim në mandatin e disa institucioneve të administratës shtetërore, në veçanti në Ministrinë e Administratës Publike nëpërmjet Departamentit të administrimit të Shërbimit Civil dhe me Departamentin për reformën e Administratës Publike.

Bashkë me institucionet tjera si Instituti i Kosovës për Administratën Publike, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Komisioni Ndërmintor për Reformën e Administratës Publike, është krijuar një qasje e re në fushën e Administratës Publike në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Unë kam përgatitur edhe shifrat statistikore, por janë në raport, kështu që më lejen tuaj kisha për t'i kaluar duke prezantuar se vlerësimi i kryerjes së punës për vitin 2011 u krye në bazë të Udhëzimit administrativ, për arsye se Rregullorja për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë nuk ka qenë miratuar gjatë vitit 2011.

Gjithashtu, një kërkesë tjetër e dalë nga ligjet dhe rregulloret e miratuara, ka qenë hartimi i përshkrimit të detyrave të punës dhe të dhënat janë në raportin e paraqitur. Këto të arritura në këtë raport janë edhe të arritura të Ministrisë së Administratës Publike, bashkë me administratën shtetërore të Republikës së Kosovës.

Viti 2012 ka vazhduar me detyra të shumta, që kishin të bënin me plotësimin e kuadrit ligjor, rritjen e kapaciteteve të punonjësve të Shërbimit civil në çështjet e administrimit dhe menaxhimit publik, si dhe krijimin e kapaciteteve të punonjësve të Shërbimit Civil, për të punuar sipas kushteve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Gjatë vitit 2012 janë përfunduar të gjitha aktet ligjore, është aprovuar plani i veprimit për reformën e administratës publike dhe janë plotësuar të gjitha kriteret afatshkurta sa i përket Marrëveshjes për Stabilizim Asocimit me Bashkimin Evropian.

Duke rikujtuar se ky raport është raporti i parë i tillë në Kuvendin e Kosovës dhe duke besuar që së shpejti do të procedohet edhe raporti për vitin 2012, i cili besoj që do të jetë edhe më i kompletuar si nga aspekti përmbajtjesor, ashtu edhe nga aspekti i rezultateve të arritura, në fund dëshiroj t'ju falënderoj për vëmendje dhe paraprakisht t'ju falënderoj për sugjerimet dhe komentet me qëllim të marrjes së masave për përmirësimin e gjendjes në Shërbimin Civil. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Izmaaku e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka shqyrtuar raportin e Qeverisë për vitin 2011 për gjendjen e Shërbimit Civil në Republikën e Kosovës.

Edhe unë po lidhem me fjalën e ministrit se është me të vërtetë, ndoshta është një defekt që ne do të flasim sot për gjendjen e Shërbimit Civil për vitin 2011, kur dihet se ka pasur edhe të arritura, por edhe sfida të reja të cilat kanë dalë gjatë vitit 2012. Ndoshta kishte qenë shumë më praktike që ne sot të flasim për të dyja raportet, pra për dy vitet, mirëpo ne do të flasim vetëm mbi bazën e raportit, i cili është dorëzuar në Kuvend.

Ndërsa, nëse deputetët do të vlerësojnë vetëm gjendjen mbi bazën e cila flitet në vitin 2011, nuk do të kenë një pasqyrë reale. Për mua ka qenë më e lehtë edhe tani që të prezantoj, për arsye që si Komision Funkcional ne kemi pasur mundësinë që të monitorojmë zbatimin e ligjit gjatë këtij viti dhe shihet që është një ndryshim, pra ka të arritura, po ka edhe sfida të reja.

Raporti fillon me konstatimin, se reformat në administratë janë bërë duke pas për bazë hartimin e strategjive të ndryshme, derisa mbi vetë funksionimin e tij, pra deri në vitin 2010 nuk kemi një ligj të veçantë mbi Shërbimin Civil, mirëpo kemi vetëm rregullore nga koha e periudhës së UNMIK-ut.

Bërja me dy ligje, ai mbi Shërbimin Civil dhe mbi Ligjin mbi pagat e nëpunësve civilë, e fillon një periudhë të re, ku fillon një pako pra, ligjore e cila fillimisht rregullonte funksionimin e mbi 20 mijë nëpunësve civilë në Republikën tonë. Mbi të dy këto konstatime nuk qëndron fakti se reformat në administratë kanë përfunduar, ne e dimë shumë mirë faktin që kemi shumë punë për të bërë, për të krijuar një shërbim profesional dhe të përgjegjshëm.

Sigurisht, duke forcuar rregullativën ligjore, por edhe duke monitoruar zbatimin e këtyre ligjeve, do të kemi mundësi të përmirësojmë dhe të kryejmë punën tonë drejt vizionit për të forcuar shtetin, pasi që administrata është një motor që organizon punën e një shteti ligjor.

Raporti e paraqet shumë mirë punën rreth përfundimit të legjislacionit sekondar dhe unë mendoj që kjo është edhe ka përfunduar realisht në vitin 2012, pasi që raporti që jep në vitin 2011 mungojnë disa rregullore, mirëpo këto vetëm kanë përfunduar, si e tregoi edhe ministri, pra në vitin 2012 nuk është ky problem më.

Por, sigurisht kemi, vazhdojmë të kemi mungesa rreth mekanizmave tjerë, të cilët do ta mundësojnë që të përcjellim implementimin e krejt rregulloreve për funksionimin e Shërbimit Civil në vendin tonë.

Legjislacioni i ri shumë mirë e fuqizon Departamentin e Administrimit të Shërbimit Civil dhe mendoj se ky është një hap i mirë në këtë drejtim, por në anën tjetër edhe gjatë raportit më shqetëson një fakt, që institucioni tjetër siç është Instituti i Kosovës për Administratë Publike, fillon edhe tkurret nga ajo veprimtari, e cila ishte dashur të jetë e vazhdueshme, pra trajnimet për Shërbimin Civil.

Realisht, këtu edhe ne si Kuvend e kemi një defekt, pasi që nuk arritëm ta bëjmë edhe me ligj, së paku Institutin, megjithatë, vërejtjet tona shkojnë në atë drejtim që Departamenti duhet të forcohet, mirëpo jo të lehet tash anash një Institut i terë i cili është investuar si nga institucionet vendore, posaçërisht edhe nga institucionet ndërkombëtare. Edhe në raport shihet që është vetëm një përshkrim dhe nuk tregohet asgjë se çfarë ka bërë, mirëpo një përshkrim Instituti e ka këtë bazë edhe realisht më shumë është përshkrues, nuk është analitik. Mendoj që për raportin tjetër, kemi nevojë pak më shumë të marrim të dhëna.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e dimë që është një institucion, i cili luan një rol shumë të fuqishëm për zhvillimin e Shërbimit Civil në vendin tonë. Po ashtu edhe në raport shihet që është vetëm e tregon rolin dhe e tregon bazën e vet ligjore, mirëpo jo edhe sfidat dhe të arriturat, kur dihet që është duke e kryer një punë shumë të mirë, një punë shumë profesionale. Unë mendoj që në raportin e vitit 2012 ka nevojë që të ketë një raport shumë më detaj, më analitik.

Komisioni Funkcional gjatë monitorimit ka vërejtur pra që kemi nevojë që brenda institucioneve të kemi shumë më shumë shërbyes civilë të nivelit më të lartë profesional. Edhe ministri e tha gjatë tabelave shihet që nuk është një gjendje shumë që duhet ta admirojmë e kënaqshme pra, niveli i arsimimit me të mesëm, mirëpo, po ashtu e dimë që është një sfidë. Është shumë problem për ta ndërruar komplet strukturën e shërbimit civil kur dihet se është një gjendje posaçërisht në nivelin lokal është një periudhë e moshës, e cila nuk mund as të shkohet në pension, po as të ndërrohet komplet. Është problem me punësim. Ne e dimë që kemi vërejtje edhe nga Fondi Monetar, që nuk mund të rrisim numrin e shërbyesve civilë nëpër nivele lokale, as qendror.

Në këtë drejtim, vlerësoj tabelat të cilat referojnë për të dhënat e këtyre kategorive, pra janë tabela të cilat janë reale, por megjithatë mirë ia vlen që kemi një detektim të kësaj gjendjeje, por po ashtu nuk kemi një pasqyrë, ku konkretisht do të dinim se çfarë profesione na mungojnë, ku do të duhej të koncentronim shërbyesit civilë për trajnime e zhvillim. Kjo sferë është edhe një vërejtje, që na vjen shpeshherë në Raportin e Progresit dhe na kemi mundësi ta plotësojmë këtë.

Pra, t'i ndajmë cilat kategori të shërbyesve civilë kanë nevojë më shumë të zhvillohen dhe të trajnohen. Dhe, në këtë drejtim unë kisha dhënë si propozim, që për shembull mund Instituti i Kosovës për Administratë Publike të fuqizohet apo edhe Agjencia e Statistikave mund të na jap të dhëna ma shumë, ku kemi mungesa, të cilit nivel.

Unë e vlerësoj në raport përf forcimin e zhvillimit të rekrutimit brenda institucioneve, pra është një risi që është shumë mirë që me Ligjin e ri për shërbimin civil u mundësohet shërbyesve civilë, që të kenë një zhvillim karriere dhe kjo është një zhvillim karriere dhe kjo është një gjë shumë pozitive për ne. Mirëpo, sa kemi mundësi ta përcjellim sa implementohet, sa është reale, e dimë që nuk është shumë e kënaqshme. Pra, në këtë drejtim duhet të kemi edhe ne një vëmendje më të madhe si deputetë, ta përcjellim se me të vërtetë a kemi përf forcimin e rekrutimit shumë real, brenda institucioneve?

Zëvendësimi i kontratave të punës me akte emërimi, pra ka qenë një akt shumë i pritur prej shërbyesve civilë, i cili po zbatohet. Në raport flitet për vitin 2011, por realisht gjendja në vitin 2012 është shumë më e mirë. Pra, është bërë zëvendësimi i kontratave të punës me akte emërimi edhe niveli qendror, posaçërisht ka shkuar mirë edhe në nivelin lokal dhe në këtë drejtim duhet vlerësuar punën që është bërë edhe nga vetë Ministria edhe nga Qeveria.

Pranimi në Shërbimin Civil mbi bazën e meritës, në raport flitet, mirëpo unë mendoj që duhet të jemi më racionalë në këtë drejtim të çështja e përmirësimit, se pasi që ka vend për të dëshiruar shumë. Pra, kemi nevojë që Shërbimin Civil, vendi ynë ta përforcojë shumë me njerëz profesional dhe në këtë drejtim kemi mundësi për ta përmirësuar.

Realisht, unë pres që viti 2012 me raport do të na jap një shpresë më të madhe, një optimizëm më të madh për zhvillim, mirëpo, jo t'i ikim edhe sfidave. Pra, raporti ka nevojë të na jap shumë pasqyrë, shumë detaje, që ne t'i kemi të detektuar problemet ku qëndrojnë.

Grupi ynë parlamentar e vlerëson dhe do ta votojë, për t'i dhënë hapësirë që të vijë raporti i vitit 2012 dhe të punojmë pak më shumë të gjithë. Kaq. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i LDK-së, zoti Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë,

Edhe në kuadër të Komisionit edhe në shqyrtimin në Grupin Parlamentar e kemi shqyrtuar raportin dhe shpreh që në fillim një keqardhje, që raporti që kryesisht flet për vitin 2011 vjen në vitin 2013, ndërsa ne kemi një kërkesë për azhurnim të reformës në administratën publike edhe në Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit edhe në Raportin e Progresit dhe kërkesat tjera që kemi.

Dhe, tani shtrohet pyetja se kur do ta kemi raportin për vitin 2013, kur neve na duhet të bëjmë veprime aktuale.

Dhe, është për keqardhje ndoshta së paku minimumi do të ishte dashur me qenë që sot bile së paku ta kemi raportin në vitin 2011 dhe komplet të vitit 2012, sepse jemi në maj të vitit 2013, dhe ka afate se kur duhet të paraqiten raportet për vitin paraprak.

Unë vlerësoj shumë veprime nga ato që janë thënë dhe nga këto që janë paraqitur në raport, po edhe nga të gjeturat në monitorimin e zbatimit të Ligjit për shërbyesit civilë, mirëpo mund të konstatoj me plot të drejtë se akoma jemi larg reformës së mirëfilltë dhe arritjes së rezultateve që kërkohen nga institucionet e Republikës së Kosovës.

Nuk dua të zgjatem fare, sepse të gjithë e dimë më se çka paraqet institucioni i konkursit. Të gjithë e dimë se a është më e rëndësishme, që të përfundosh fakultetin në një universitet kredibël, të kesh notë të lartë, të kesh angazhime shtesë, aftësi shtesë, apo të

gjesh një lidhje e cila do të rekomandojë dhe se paneli intervistues formalisht do ta konstatojë se kush pranohet.

Pra, këtë e kemi gjithkund, si në nivel qendror edhe në nivel lokal. Dhe, me këso qasje në administratë, pra me politizim të skajshëm të administratës, e di që gjithmonë ne do të shikohemi si një vend me shumë probleme, në administratë. Po, duke pasur shumë probleme në administratë, neve do të na reflektohet përgjegjësi dhe fuqia, kapaciteti i institucioneve për të ushtruar detyrat dhe përgjegjësitë.

Fare pak flitet në raport dhe fare pak është punuar në drejtimin që të caktohen edhe modalitetet, standardet e vlerësimit, që të përcaktohen pra mekanizma të saktë të performancës, pastaj që të ketë një qasje të definimit të saktë të racionalizimit të administratës, duke u përcaktuar nga sistematizimit, që akoma ne nuk kemi standarde dhe modele të sakta, as analizë të fundme, as për nivelin qendror, po as për nivel të komunave, se sa duhet të jetë madhësia e një administrate.

Ne edhe pas sa vjetëve, pra si shtet i pavarur, pa interferimin e UNMIK-ut, ne edhe sot e kësaj dite nuk kemi arritur që të aprovojmë standarde, se sa duhet të jetë madhësia e një institucioni, qoftë ai qendror apo ky lokal.

Le të mos flasim më tutje, se si trajtohet avancimi dhe trajtimi i performancës, pra duke mos pasur indikatorë publikë dhe të njohur, nëpërmes cilës përcaktohet performanca, ne do të sillemi vazhdimisht dhe jemi nën mëshirën e individëve apo edhe të liderëve të institucioneve.

Problem i veçantë prapë është mosrespektimi i institucioneve dhe vendimeve të institucioneve brenda, do të thotë brenda nesh. Është prapë për keqardhje, që kemi një përparim, por fare të vogël, në implementimin e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, sepse akoma kemi vendimet përfundimtare administrative të Këshillit të Pavarur të cilat nuk zbatohen dhe pa u frikuar nga lideri a nga përgjegjësia e institucionit, akoma kemi zyrtarë që personi, i cili i ka fituar të gjitha të drejtat i thotë, ti rri në shpi, se mua ende s'mu ka mbushur mendja për të kthyer në punë. Dhe akoma nuk kemi dëgjua se një institucion apo një lider, ka marrë masa ndaj ndonjë zyrtari të kësaj natyre, që nuk e lejon kthimin në punë të atyre që i kanë fituar të gjitha të drejtat, që edhe këtu tregojmë se këta zyrtarë, që pranojnë këdo në punë, largon dikë prej pune dhe kur ai fiton të drejtat, ai prapë fiton të drejtën, dhe thotë, unë të kthej në punë kur të dua unë.

Dhe, kjo formë voluntare e organizimit të shtetit të institucioneve tregon për defektet e mëdha që i kemi. Prandaj, duke dëshiruar që shumë shpejt ta kemi komplet raportin për vitin 2012, veprimet që janë bërë në vitin 2013 realizimi i reformave në hapa dhe në kualitetin e kënaqshëm, që së paku ne të shpresojmë tek partnerët tanë, ta ngremë një optimizëm se jemi në rrugën e drejtë dhe se shpejt do të mund t'i realizojmë detyrat tona në këtë drejtim, unë propozoj që të votohet, të aprovet ky raport sot.

Kështu edhe kemi biseduar në Grupin Parlamentar, me të gjitha rezervat që i kemi, me shpresën se shumë shpejt ne ta kemi raportin e vitit 2012. Unë vërtet çuditem, një institucion çka bën nëse nuk i shpenzon katër ditë për të raportuar se çka ka punuar.

Ne nuk po i themi që ai të paraqesë më pak ose më shumë se sa që ka punuar, por mosdorëzimi i raportit nuk nënkupton se ti e ndryshon gjendjen reale të punës në një institucion. Prandaj, minimumi është të kërkojmë që brenda një afati shumë të shkurtër njëmuajor, të vijë raporti i vitit 2012, ngase edhe ashtu ka veprime. Pse nuk paraqiten, unë po çuditem.

Prandaj, për hir të asaj që të mos lëmë përshtypje të keqe, si grup parlamentar jemi dakorduar, që ta votojmë këtë raport, por nëse brenda një muaji nuk vjen raporti i vitit 2012, ne do t'i ngrehim shqetësimet tona, ndërsa, për gjithë punën, angazhimin, përkushtimin dhe përparimin, domethënë japim komplementet tona. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Edhe ne e kemi analizuar Raportin vjetor mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2011.

Ky raport na duket shumë sipërfaqësor dhe si i tillë nuk arrin që t'i adresojë disa nga problemet më fundamentale që e karakterizojnë këtë segment të rëndësishëm të funksionalitetit ligjor. Pra, gjykimin e bëjmë pikërisht mbi premisat se ky raport është i vitit 2011 dhe mungojnë të dhënat mbi raportin e vitit 2012, pasi që ne jemi në vitin 2013 tani.

Raporti përmend miratimin e infrastrukturës ligjore dhe rregulloreve të brendshme, që kanë për synim ta rregullojnë këtë sferë, mirëpo si i tillë në shumëçka ai mund të konsiderohet vetëm si përkufizim i idealitetit, por jo edhe prezantim i gjendjes reale, synim që të paktën nominalisht pretendoi ta jetësojë.

Bie fjala, ndonëse përshkruhet funksioni i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku thuhet se si i tillë ky organ ka për detyrë që t'i zgjidhë ankesat e nëpunësve civilë, por askund nuk tregohet se pse pikërisht këto institucione nuk i respektojnë vendimet e këtij Këshilli të Pavarur Kushtetues.

Po ashtu, përmendet edhe miratimi i rregulloreve që kanë për bazë parimin e respektimit të mundësive të barabarta dhe gjinore, mirëpo statistikën që prezantohen këtu, flasin për një diferencë themelore të punësuarve në këtë sektor. Ndërsa, kur bëhet fjalë te rekrutimi dhe pranimi në Shërbimin Civil nuk ofrohet asnjë e dhënë se çfarë po bëhet në tejkalimin e këtyre diferencave sociale dhe gjinore.

Çështje tjetër diskutabile mbetet edhe mungesa e informacioneve, se përse shumë nga institucionet e nivelit qendror nuk e kanë kryer përshkrimin e punës sipas Rregullores apo nuk e kanë kryer shndërrimin e kontratave të punës në akte emërimi, sipas Rregullores, apo nuk e kanë kryer vlerësimin e rezultateve në punë. Pra, këtu tregohet se janë një varg institucioneve që i kanë shpërfillur këto dokumente, por nuk ofrohen detaje të tjera dhe arsyet se përse ka ndodhur një gjë e tillë.

Si rezultat i këtyre mungesave, në këtë raport e konsiderojmë të paplotë dhe i cili nuk ofron informacione të duhura dhe adekuate mbi gjendjen në Shërbimin Civil, e kemi fjalën për vitin 2011. Dhe, prandaj ne si lëvizje ne do të abstenojmë në këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Mendoj se para se të flas për raportin, duhet ndalur pak te çështja e afateve dhe e kohës. Ka qenë në rregull, sikur ministri të na kish treguar, të paktën të marrë pak mund të na thotë diçka, pse është ky raport duke u shqyrtuar tash, domethënë i vitit 2011, praktikisht në qershor të vitit 2013.

Ministri tha që e ka aprovuar Qeveria diku në fund të tetorit të vitit 2012 këtë raport, mirëpo ne të gjithë e dimë, që kur aprovohet diçka në Qeveri në fund të tetorit, të cilitdo vit kalendarik, kjo çështje definitivisht shkon në vitin pasues, për shkak se nuk ka kohë më për t'u shqyrtuar.

Po, atëherë është shkelur ligji se ka qenë dashtë ky raport të aprovohet herët në vitin 2011, në mënyrë që të vijë me kohë. Po, jo vetëm që është shkelë atëherë ligji, po është shkelur edhe tash, se ne tash definitivisht ka qenë dashur ta shqyrtojmë raportin e vitit 2012, jo të vitit 2011. Kështu që, ka qenë mirë, të paktën bashkë të dy raportet.

Tani kjo është një çështje që duhet të shqyrtohet dhe njëfarë mësimi që del prej kësaj është, që as që po ua ndien, nuk e kanë temë këtë punë, duhet për ta plotësuar një obligim ligjor kur t'iu bie ndërmend, por nuk e kanë seriozisht. Nuk e kanë marrë seriozisht këtë punë të Administratës Publike kurrë asnjëherë.

Çështje tjetër, është që duhet shtruar një pyetje, të paktën ka qenë dashur të na tregojnë, kur vjen tash raporti i vitit 2012, në fjalën e ministrit, të thotë raporti i vitit 2012 vjen javën e ardhshme, ose pas dy javësh ose kur? Për shkak, se edhe atij i ka kaluar afati, ka qenë dashur të vijë deri tash.

Një çështje që duhet prapë të flasim është ajo, se nuk është krejt në rregull si Kuvendi, ta gjykojmë raportin, të themi se a është raporti i mirë ose i keq, raporti mund të jetë i mirë, por duhet parë çka përmban. E se çka përmban raporti e keni faqen 13, krejt aq faqe i ka, në faqen 13 të raportit, për fundi tabelës 9, e keni një faqe komplet me emra të institucioneve të cilat nuk i kanë përmbushur obligimet ligjore.

Mund të ju them, që po qe se kishte shënuar ministri, cilat institucione i kanë përmbushur, do t'i dilte dy rreshta, jo krejt faqja. Domethënë, nuk po ju marr shumë kohë të hyj t'i lexoj se cilat janë institucionet, por sinjerisht po ju them janë gati krejt. Gati krejt ministritë, gati të gjitha agjencitë e pavarura, gati të gjitha komunat, në njërën pikë ose në pikën tjetër, domethënë, çka me i thënë tash raportit për vitin 2011, a është në rregull a nuk është në rregull?

Edhe për vitin 2011, po flasim një vit pasi që është aprovuar ligji, nuk po flasim për një kohë një muaj ose dy muaj, pas aprovimit të ligjit. Sidoqoftë, neve si shtet duhet të na interesoj Administrata Publike, se është esencialisht shteti. Administrata është shteti. Ne ndërrohem, politikanët ndërrohen. Kushdo mund të jetë politikan, t' i fitojë votat, të vijë për t' i vendosur prioritetet, t' i përcjellë prioritetet prej votës, ama administrata e shtetit është shteti. Dhe kur flasin njerëzit për integrim në Union Evropian gabim e kanë, nuk e integron vendin në Union Evropian politika. Politika i vendos disa prioritete, 90% e punës është administrative. Kjo administratë ka për ta integruar Kosovën në Union Evropian.

Edhe nëse administrata është e mbushur me tezakë dhe axhoshë, nuk mund ta qojë vendin në Union Evropian. Më falni, që po e uli kështu këtë sistem, por po dua t' ju tregoj diçka tepër interesant. Nëse cilido prej ministrave ka për ta lye shtëpinë e vet, nuk shkon ta thërrasë djalin e axhës t' ia lyej shpinë nëse nuk është moler. E gjen një moler të mirë edhe e paguan, se e ka për shpi të vetën, por kur ka për ta kryer një punë të shtetit, ama nuk i intereson bash hiç a është profesionist a jo, se nuk është e vetja. Nuk është duke e ndier të veten më edhe e gjen kë të donë, se është vetëm sistem i punësimit, nuk ka lidhje me sensin normal të ndërtimit të shtetit. Dhe, kjo është logjika. Kush të dojë, çka të dojë mund të flasë, kush do çka do mund të na thënë këtu neve, e kemi bërë ligjin, i kemi vendosur gradat. Administratën publike ne e dimë qysh e kemi. Ata njerëz janë të demotivuar totalisht për të punuar, ajo pjesë e njerëzve të mirë dhe të ndershëm edhe profesionistë që janë në administratë. A dini çka kanë parë ata? Dhe, për këtë temë kam folur edhe herën e kaluar, në fillim të seancës. Ata veç i shohin duke iu ndërruar shefat, ose drejtorët e departamenteve, ose sekretarët ose shefat ekzekutiv, vetëm u ndërrohen ata dhe vijnë prej një partie, prej tjetres, prej një lidhjeje familjare, prej një nepotizmi dhe, ata janë ngulur në vend. Nuk kanë përparim në karrierë, nuk kanë.

Është gabim t'i themi vetes ne sot që Administrata Publike e Kosovës ndihet mirë, se e sheh që po ka përparim në karrierë, jo bre, nuk kanë. Janë ngulur. Ka njerëz, shumica dërrmuese e tyre janë qe dhjetë vjet në të njëjtën pozitë. Rrogën të mirë nuk e kanë, nuk shohin përparim në karrierë. Çfarë motivi kanë për punë ata? As nuk mund t'i çojnë fëmijët në shkollë me atë rrogë, as kurrë s'mund të bëjnë. Qysh do t' i motivojë shteti jonë, politika jonë, ministri jonë... qysh do t' i motivojë ata të punojnë mirë për vendin.

Është totalisht absurd. Më mirë është të thuash, të dalësh në foltore të Kuvendit edhe të tregosh deri këtu kemi mbërri edhe çka dom të bëjmë tash e tutje, se sa të themi i kemi bërë ligjet, është mirë edhe njerëzit e shohin veten pa asnjë perspektivë, pa asnjë përparim në jetën e tyre dhe po flasim për njerëz, të cilët duhet të kenë motiv, duhen të jenë njerëz ambiciozë, të cilët lypin për t' u shkolluar më shumë, të cilët lypin të punojnë

më shumë, të cilët duan të përparojnë në karrierë, se ambicia e mban njeriun të ecë përpara, nëse ua mbyl ambicien, e ke mbytur motivin e tyre për punë.

Mendoj, se raporti nuk është as të votohet, as të mos votohet. Çka t'i bëjmë raportit, çka na kallëzon raporti? Në këtë rast, mendoj se duhet, ndoshta edhe e votojmë, ndoshta s'e votojmë, deputetët le të jenë të lirë, por nuk është tema sot, a po votojmë raport, a s'po votojmë raport, mendoj se sot ne nuk duhet të flasim për raportin. Raporti duhet të jetë shkas për të folur për Administratën Publike, që është shkatërrua, është shkatërrua, është shkatërrua motivi i njerëzve. Njerëzit nuk po mund ta gjejnë veten më aty edhe vetëm nuk kanë ku të shkojnë se krejt ata që dinë diçka, krejt ata që kanë grada shkencore, krejt ata që e kanë një kualitet, po të kishin ku të shkojnë ikin prej administratës, nuk rrinë as dy minuta në atë vend të punës.

Kjo është administrata e shtetit të Kosovës. Ju ose votoni, ose mos e votoni, çka të doni bëni, por nuk e ndërron gjendjen kjo. Bile- bile, unë as që kisha diskutuar për raport hiç, se është i vitit 2011, nuk kemi çka të diskutojmë. Duhet diskutuar 2012-ën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, zoti Svirca e ka fjalën.

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë,

Siç e potencuan edhe përfaqësuesit e grupeve parlamentare të tjera, ne sot pra kemi në shqyrtim raportin 2011, i cili nuk e dimë se sa ka logjikë që të shqyrtohet në vitin 2013, apo më mirë thënë s'ka logjikë fare. Dhe, për këtë arsye unë nuk do të lëshohem që të debatoj në këtë raport.

Dua të kujtoj këtu, se Komisioni për Administratë Publike ka pasur mbikëqyrjen zbatimin e Ligjit për shërbimin civil dhe ka dalë me disa rekomandime dhe presim, që Ministria do t'i ketë parasysh dhe do t'i zbatojë në përpikëri. Gjithashtu, presim sa më shpejt që të vijë raporti i vitit 2012. Dhe, në kuadër të kësaj presim, që duke i zbatuar edhe rekomandimet e Kuvendit, po edhe obligimet tjera, të cilat dalin nga ligji, do të ketë ngritje të cilësisë në Administratën Publike. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zajednička Budućnost, gospodin Stojanović.

MILIVOJE STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Uvažene kolege poslanici i članovi Vlade,

Poslanička grupa Zajednička Budućnost razmatrala je i analizirala izveštaj o stanju u Civilnoj službi za 2011.godinu.

Izveštaj o stanju u Civilnoj službi za 2011.godinu je veoma kasno stigao pred poslanike i da je trenutno stanje verovatno različito u odnosu na podatke, koje imamo u datom

izveštaju. A nadamo se da je stanje poboljšano na bolje i zakoni i podzakonska akta primenjena.

Kao što smo čuli od ministra, zakon je donešen 2010. godine, a nakon toga i veliki broj uredbi koje na precizniji način regulišu položaj civilnih službenika u lokalnim i centralnim institucijama.

Pomenutim zakonom i aktima predviđa se jasna procedura prijema u institucijama, jača se i štiti položaj civilnih službenika od političkih pritisaka i pritisaka koji mogu biti izloženi unutar i van institucije u kojima su zapošljeni. Od ovakvih mera se očekuje da civilni službenici nezavisno i samostalno donose odluke, što bi trebalo da iz stimuliše i poboljša njihov rad.

O samom izveštaju možemo reći da je uopšten i da ne daje dovoljno podataka o stanju u Civilnoj službi. Na osnovu onih podataka koje imamo u izveštaju, zabrinjavajuća je činjenica da veliki broj centralnih i lokalnih institucija nisu, ili su delimično uspele da realizuju zamene ugovora o radu aktom o imenovanju, u skladu sa članom 96 i 97 zakona o Civilnoj službi.

Neke institucije nisu formirale disciplinske komisije i ne realizuju jasne disciplinske procedure. Da mali broj centralnih institucija jesu, a mali broj lokalnih institucija nije uspela da obavi opis rada po pravilniku. Zakonskom regulativom predviđa se načelo poštovanja ravnopravne mogućnosti zapošljavanja zajednica i polova, kao i lica sa ograničenim sposobnostima, odnosno postoje jasne procedure pravednog i proporcionalnog zastupanja nevećinskih zajednica u Civilnoj Službi.

U skladu sa odredbama ovog pravilnika najmanje 10% civilnih službenika u centralnim institucijama treba da budu zastupljene od osoblja nevećinskih zajednica. Međutim, ova zakonska načela nisu ispoštovana i nisu realizovana u mnogim institucijama, na šta smo u ovom Skupštinskom domu kazivali vrlo često.

Ovom prilikom pozivam sve rukovodioce centralnih i lokalnih institucija, da se angažuju u poštovanju ovih načela i da tako daju svoj doprinos u aktivnom uključivanju nevećinskih zajednica u institucijama.

Prisustvo u svim institucijama, posebno u Civilnoj službi srpske, turske, bošnjačke, aškaljske, romske i drugih zajednica daje određenu zaštitu i sigurnost pripadnicima ovih zajednica a kosovskom društvu bi obezbedilo izvesniju evropsku perspektivu.

Zabrinjavajuća je činjenica da se polna ravnopravnost ne poštuje, pošto je angažovanje muškaraca u Civilnoj službi 65% a žena smo 35%. U ovom izveštaju na žalost, nismo podatkne o upošljenosti lica sa ograničenim sposobnostima u civilnoj službi, što govori o odnosu prema ovoj grupi ljudi kosovskog društva, iako je zakonom predviđeno da se na svakih 50 radnika zaposli jedno ovakvo lice.

Ako želimo ići ka Evropskoj Zajednici, moraćemo da brinemo i da svakoj grupaciji ljudi obezbedimo ravnopravne mogućnosti i poštujemo zakonom zagarantovana prava.

Poslanička grupa Zajednička Budućnost glasaće za izveštaj, iako smatra da izveštaj ne daje sve potrebne podatke i činjenice za jednu detaljniju analizu u civilnoj službi. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë në emër të grupeve të paraqitur. Zoti Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: I nderuar nënkryetar,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Në vitin 2008 Qeveria e Republikës së Kosovës ka bërë një hap të rëndësishëm duke themeluar një ministri, që është quajtur Ministria e Administratës Publike.

Nuk do ta fsheh ky ka qenë një projekt imi personal me rastin e zgjedhjes ministër i Shërbimeve Publike, unë kam kërkuar që brenda tre muajve të shuhet ajo Ministri dhe të themelohet një Ministri e specializuar për Administratë Publike. E kam bërë këtë, për arsye se e kam ditur se jemi një shtet në krijim e sipër dhe për këtë shtet në krijim e sipër ka shumë rëndësi çështja e reformës së administratës publike dhe vendosjen e bazave të funksionimit të një administrate të qëndrueshme.

Dhe, nuk ka dyshim që atëherë çështja e reformës së administratës publike ka qenë në top-prioritetet e Qeverisë, do të thosha ka hyrë në atë dhjetëshen e parë dhe është bërë një punë jashtëzakonisht e madhe me faktin që në atë kohë janë draftuar të gjitha ligjet e administratës publike do të thosha pakoja e pesë ligjeve:

- Ligji për shërbimin civil,
- Ligji për pagat,
- Ligji për pagat e nëpunësve të lartë, i cili ende s'është miratuar,

dhe ligje tjera, që kanë krijuar bazën e administratës publike.

Unë me thënë të drejtën, më inspiroi pak fjalimi i zotit Gjini, i cili me të drejt refuzoi të flasë për një raport të vitit 2011, por foli për rëndësinë që ka krijimi i një administrate publike për aspiratat tona për integritet evropiane. Nëse ne lexojmë raportet evropiane: Raportin e Progresit; raportin e studimit të fizibilitetit, do të shohim se në top prioritetet në kriteret kryesore politike është krijimi i një administrate profesionale, administrate të qëndrueshme dhe të depolitizuar.

Dhe, ne duhet ta shikojmë në këtë kontekst, se ky është një kusht ekzistencial për një shtet të ri, sepse partitë politike do të vijnë dhe do të shkojnë nga pushteti, pushtetin do ta mbajë një administratë, e cila duhet të jetë lojale ndaj shtetit dhe e cila do ta mbrojë shtetin edhe kur ka kriza politike, sepse mos të harrojmë, ka pasur shumë shtete ku ka pasur kriza të thella politike. Për shembull, Belgjika ka qenë shumë kohë pa qeveri, pa

kryeministër, por administrata ka pasur një funksion patriotik që ta ruajë shtetin dhe të mos dëmtohet shteti për shkak të krizave politike.

Nuk ka dyshim se Shërbimi Civil është zemra e administratës publike. Krijimi i një shërbimi civil profesional, të pavarur, lojal ndaj shtetit është një e arritur kombëtare dhe një shenjë e emancipimit të shtetit. Dhe, ne në vitin 2010, me miratimin e Ligjit të shërbimit civil, me mbështetje të fuqishme të donatorëve, kemi promovuar këtë koncept të një shërbimi civil profesional, shërbimit të karrierës dhe shërbimi plotësisht të depolitizuar.

Duhet të diskutojmë sa i kemi arritur këto synime strategjike, që janë shumë të rëndësishme për një shtet të ri të krijuar, sepse nëse në krijim të shtetit themelohet një administratë e qëndrueshme, ajo bën një vlerë afatgjate. Mund të themi se është bërë një punë shumë e madhe në reformimin e Shërbimit civil, sepse Shërbimi civil i Kosovës ka numëruar diku rreth 80 të punësuar dhe me Ligjin për Shërbimin civil ne kemi krijuar shërbimin e pastër civil apo administratën duke hequr nga shërbimi civil shumë kategori: punëtorët e arsimit, punëtorët e shëndetësisë, pjesëtarët e FSK-së, pjesëtarët e policisë, artistët, aktorët, dhe shumë kategori të tjera, që kanë specifikat e shërbimit civilë dhe kjo ka qenë e një rëndësie jashtëzakonisht të veçantë.

Gjithashtu, kemi miratuar edhe Ligjin për nën pagat e shërbyesve civilë, ku kemi promovuar këtë koncept të shërbimit civil të karrierës dhe kemi instaluar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, si një gjykatë administrative edhe pse s'është gjykatë, po si një organ administrativ i kontrollit të rregullsisë dhe disiplinës në Shërbimin civil, edhe pse nga raportet e këtij kemi parë shumë moszbatim të vendimeve të këtij Këshilli nga organet dhe institucionet shtetërore.

Çështja e parë që duhet të përfundojë ky profilizimi i Shërbimit Civil dhe ministri na tregoi se gati ka përfunduar prodhimi i legjislacionit sekondar. Zoti ministër, ju keni pasur donacione të fuqishme për këtë që e kanë origjinën nga Konferenca e Donatorëve, ku unë personalisht kam lobuar dhe kam siguruar mjaftë fonde, që t'i ndihmohet Shërbimit civil, të prodhohet legjislacioni sekondar dhe të instalohet plotësisht ky shërbim civil, i cili duhet të mundësojë edhe integrimin e Kosovës në nivel të Bashkimit Evropian.

Çështja e dytë, ne kemi një Shërbim Civil në bazë të Ligjit Shërbim të karrierës, ku i mundësohet shërbyesit civil që të arrijë çdo pozitë në kuadër të Shërbimit Civil, nga pozita e parë deri te pozita e lartë, që është sekretari permanent dhe ligji ka instaluar një varg mekanizmesh të evaluimit të kualitetit të brendshëm, në mënyrë që të instalohet e ashtuquajtura ngritje gjatë gjithë jetës në karrierë, deri te pensionimi. Dhe, janë instaluar shumë mekanizma të matjes së kualitetit të performansës dhe stimulimit të gradimit të shërbyesve civilë.

Sa i kemi këta mekanizma funksionalë? Nëse neve shërbyesit civilë na ikin prej shërbimit civil dhe punësohen nëpër kompani private apo punësohen nëpër institucione private, do të thotë nuk e kemi bërë atraktive punën në shërbim civil, për shkak se s'kemi siguruar

kushte adekuate që shërbyesit civilë të jenë të stimuluar edhe për sa i përket ngritjes në karrierë dhe sa i përket stimulimit të tyre material.

Është e vërtetë që Qeveria e Kosovës ka vite që ka formuar një fond, fond për kthimin e trurit, një fond i cili stimulon një numër të madh të kuadrove deficitarë, por mendoj se ai fond është i pamjaftueshëm, sepse të investosh në shërbimin civil dhe në shërbyesit civilë është diçka që i duhet secilit shtet.

Përgjithësisht mendoj se ne duhet të jemi të kujdesshëm, ne e kuptojmë luftën politike, pluralizmin politik, rrotacionin dhe alternimin e Qeverive, por kujdesi ndaj shërbimit civil është kujdesi ndaj shtetit dhe nuk duhet të lejojmë, që pas çdo cikli të zgjedhjeve të atakohet shërbimi civil. Të gjitha vlerësimet ndërkombëtare, zoti ministër, tregojnë që administrata jonë është e stërngarkuar. Unë e kuptoj se është pak një risk politik racionalizimi i administratës publike, por është një proces i domosdoshëm që duhet të ndodhë.

Thjeshtë, angazhohem që të vazhdohet me implementimin e plotë të këtij koncepti të Shërbimit civil dhe të investohet, sidomos në dy segmente të cilat mund të themi se ka një ngecje, është Instituti për Administratë Publike, i cili duhet t'i reformojë kurrikulat dhe programet dhe duhet të ofrojë programe atraktive, programe të cilat Qeveria e Kosovës i ka miratuar, programe që do të mundësojnë edhe modernizimin e administratës. Shumë pak po dëgjojmë për projekte të reja të qeverisjes elektronike. Neve na kujtohet zotimi i Qeverisë, që Kosova të ndërtohet si një zonë e teknologjisë informative dhe ne, jo rastësisht e kemi çuar edhe kryeministrin tonë për ta parë përvojën e republikës së Estonisë dhe ka pasur gatishmëri që të shkohet drejt modernizimit.

Nuk është këtu faji i ministrit të Administratës Publike, ai bën gjithçka është e mundshme, po përgjegjës për progresin në Shërbimin civil dhe Administratën Publike është i komplet shteti, sidomos Qeveria, sidomos Komisioni Ndërmintor i cili ka një rol kyç, që ta vendosë çështjen e Shërbimit civil dhe Administratës publike në top temë.

Javën e kaluar apo në një nga seancat ju kam bërë një pyetje, zoti ministër, për implementimin e procesit të rishikimit funksional. Unë e di, që ky proces gati ka përfunduar, por ju mos hezitoni që t'i bëni përgjegjës aktorët apo subjektet që hezitojnë të implementojnë plotësisht procesin e rishikimit funksional, sepse ka qenë një proces tërësisht i përkrahur nga Bashkimi Evropian dhe implementimi i plotë i atij procesi do të bënte që raportet e progresit të tregojnë më shumë progres në sferën e reformës së Administratës Publike dhe në sferën e Shërbimit Civil.

Mendoj se padrejtësisht ne kemi anashkaluar debatin për themelimin e një Akademie Shtetërore sa i përket administratës publike, sepse të shkollosh njerëz gjatë gjithë jetës në nivele të larta akademike, për administratë publike, është të investosh në të ardhmen e shtetit, në siguri të shtetit, sepse administrata efikase profesionale e depolitizuar është një garanci që shteti do të shkojë përpara dhe asnjë krizë politike nuk mund ta ndalë.

Zoti ministër, unë uroj që procesi i administratës publike të ketë prioritet. Ky proces ka prioritet vetëm me një vullnet politik, vetëm me një mbështetje të fuqishme politike dhe duke qenë se jemi vetëm pesë vjet shtet, është shumë me rëndësi që reforma e administratës publike, ndërtimi i një administrate profesionale me një shërbim civil profesional dhe lojal ndaj shtetit është një interes permanent yni, në mënyrë që të shkurtrojmë edhe rrugën e integritetit evropian, po në një mënyrë të sigurojmë funksionalitetin dhe qëndrueshmërinë e plotë të shtetit dhe administratës sonë publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Konsideroj se në bazë të këtij raporti që është paraqitur nga ana e ministrit, do të thotë po t'i shikojmë miratimin e ligjeve dhe nxjerrjen e udhëzimeve administrative, do të thotë na lë përshtypje që këtu është gjithçka në rregull, mirëpo, konsideroj se po t'i referohemi raportit, që u thanë edhe nga parafolesit tjerë, Raportet të Progresit, na del se reforma e administratës publike për Qeverinë e Kosovës dhe për raportin e stabilizim- asocimit do të thotë, është njëra prej prioritetëve dhe duhet të jetë njëra prej prioritetëve.

Mirëpo, në këtë raport që është dhënë për periudhën 2011 – 2012 vlerësohet se deri më tani sot ka pasur edhe progres të vogël në zbatimin e strategjive, pastaj ka pasur progres shumë të vogël në implementimin e ligjeve, por njashtu progres shumë të vogël edhe në implementimin e udhëzimeve administrative, të cilat i ka nxjerrë vetë Ministria e Administratës Publike.

Do të thotë, kërkohet në këtë raport që administrata publike dhe shërbyesit civilë në përgjithësi të mos jenë të politizuar, gjë që realisht në disa ministri dhe në disa agjenci, kemi të bëjmë me politizimin e administratës publike, kemi të bëjmë me politizimin e shumë drejtorive, pastaj shumë udhëheqës divizionesh dhe sektorëve tjerë. Dhe, ne kërkojmë që për të pasur një sukses më të mirë, një progres më të mirë, administrata publike në përgjithësi duhet të jetë e depolitizuar, duhet të jetë shumë e qëndrueshme, duhet të jetë shumë efektive.

Dhe, një shqetësim të cilin unë dua ta ngre sot ka të bëjë pikërisht me kontratat për shërbime këshillimore që kanë filluar të aplikohen gjatë vitit 2012 e këndeje, sepse deri në vitin 2011 kanë qenë si kontrata mbi vepër, për të cilat në njëfarë forme kanë pasur njëfarëlloj legjitimiteti në kuptimin e asaj, që aty ku ka pasur mungesë profesionale në shumë institucione, do të thotë janë angazhuar njerëz profesional, për të ndihmuar, qoftë në hartimin e ndonjë projektligji apo hartimin e ndonjë strategjie, gjë që tash këto kontrata me vitin 2012, janë shndërruar në kontrata për shërbime këshillimore, gjë që edhe për mua kjo do të ishte në rregull, po të merreshin njerëz dhe sikur ministrinë kanë nevojë që të hartojnë strategji apo kanë nevojë që të hartojnë projektligje.

Mirëpo, këtu po ndodh e kundërta, sepse nëpërmjet këtyre kontratave të shërbimeve këshillimore, në shumë ministri, do të thotë ka punëtorë të cilët janë shoferë ose vozitës të ministrave, ka edhe disa punëtorë që janë asistentë të ministrave apo zëvendësministrave apo të një dikasteri tjetër, gjë që kjo bie në kundërshtim, do të thotë me Ligjin për shërbyesit civilë, sepse e lejueshme do të ishte sikurse në këtë kontratë për shërbime këshillimore të jenë njerëz profesionalë që do t'i ndihmonin do të thotë ministrive ose institucioneve përkatëse, por në këtë rast këtu kemi një keqpërdorim dhe do doja të thosha, që kjo nuk është aspak e arsyeshme që të merret një asistent me kontratë tremujore, pastaj t'i shpallet vendi i punës dhe të legjitimohet.

Mendoj që kjo është në kundërshtim me Ligjin për shërbimin civil dhe kërkoj nga ministri këtu, që të marrë masa dhe të shikojë në ato ministri dhe në ato institucione, ku numri më i madh ose kemi shifra mbi 40 ose kemi shifra ndoshta edhe më shumë që kanë të bëjmë me punëtorë që punojnë me kontrata për shërbime këshillimore.

Një çështje tjetër, që po i kushton Buxhetit të Republikës së Kosovës, ka të bëjë me, kur flitet për politizimin e administratës publike, do të thotë me ardhjen e ministrave, ose me ndryshimin e pozicioneve, në këtë rast të koalicioneve të ndryshme që po ndodhin, kemi një numër të madh të punëtorëve të shërbyesve civilë, sidomos të drejtorëve të cilët largohen nga veni i punës dhe pastaj fillohet me ankesat e tyre në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës dhe pas dy vjetësh Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës po të njëjtit persona, do të thotë i kthen në vendin e punës.

Ndërsa, Ministria në këtë rast e merr një person tjetër, gjë që kemi një duplikim të buxhetit dhe është shumë i kushtueshëm për Buxhetin e Republikës së Kosovës, kur dihet mirëfilli që është një buxhet shumë i limituar dhe nuk kemi nevojë që ne të paguajmë do të thotë dy persona me të njëjtin koeficient, në rastin kur kemi të bëjmë me kthimin nga Komisioni i Pavarur Mbikëqyrës.

Prandaj, janë disa vërejtje që u thanë edhe nga parafolësit tjerë, sepse kemi të bëjmë me një raport të vitit 2011 dhe ne presim që shumë shpejtë nga ana e ministrit të vijë edhe raporti për vitin 2012 dhe të shohim se a ka lëvizje dhe a ka progres sa i përket këtij raporti.

Por, po t'i shikojmë raportet e progresit, po ta shikojmë edhe raportin e Fondit Monetar Ndërkombëtar, besoj që ministri e di shumë mirë që në vitin 2004 ka qenë e lidhur një marrëveshje memorandumi ndërmjet Qeverisë dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar për shkurtimin e vendeve të punës, në kuptimin e asaj që administrata publike nuk mund të jetë do të thotë një organizatë, ose nuk mund të jenë ato institucione të cilat mund ta zbusin papunësinë, sepse në administratë publike duhet të jenë njerëz profesionalë, njerëz të cilët e njohin punën dhe nuk duhet të jetë si administratë për të plotësuar do të thotë apetitet e grupeve të interesit apo subjekteve politike. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedavajući!

Poštovani ministre,
Uvaženi poslanici,
Poštovani građani,
Stanje u Civilnoj službi Republike Kosovo za 2011. godinu ali i ranijih godina govori nam da moramo izvršiti ogromne reforme, kako bi se to stanje ispravilo.

Zaposlenost manjinskih zajednica po javnim institucijama na lokalnom i centralnom nivou je jako zabrinjavajuća. Za stanovništvo bošnjačke zajednice gde se absolutno nigde ne poštuje zakon o zaposlenosti manjinskih zajednica od 10%. Problem zaposlenosti odnosi se na opštine, poštu, KEK, zdravstvene centre, ambulante i bolnice, razne agencije, bordove, banke ali i privatne biznise.

Možete proveriti koliko je pripadnika bošnjaka zaposleno po ministarstvima, Parlamentu Kosova, kabinetu predsednice. Postoje ministarstva gde uopšte nismo ni zastupljeni.

Ja vas ministre, molim da ozbiljno shvatite ovu problematiku ako treba i da formirate ispred vašeg ministarstva agenciju ili komisiju, koja će se pozabaviti tom problematikom, kako ne bismo dišli do nesuglasica i problema kojih već imamo. Zahvaljujem se!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Teutë Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot kemi raportin e gjendjes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2011. Për vetë faktin se ky raport ka ardhur në këtë muaj të vitit 2013, nxjerr në pah edhe njëherë një pyetje që e kam nxjerr sa e sa herë tjera, pse miratohen raportet në Kuvendin e Kosovës.

A i marrim votat apo nuk i marrim, kjo nuk është me rëndësi. E dimë, jemi të gjithë dëshmitarë, që edhe nëse votohen edhe nëse nuk votohen, nuk ndërmerret asnjë masë. Çka të themi ne? Të themi se raporti për vitin 2011 paraqet një gjendje reale, andaj duhet ta votojmë.

Unë kisha për të thënë paraqet një gjendje të mjerueshme, andaj po bëjmë si të doni. Gjatë monitorimit të Ligjit për shërbimin civil, që e kemi pasur ne si grup në kuadër të Komisionit Funkcional, ne kemi hasur në shumë probleme. Dhe, tani kur Ligji për shërbyesit civilë ende nuk i ka të gjitha nën aktet të nxjerra, gjatë monitorimit ne kemi parë që është nevojë urgjente e plotësim-ndryshimit të këtij ligji.

Pra, po diskutojmë që ende jo të gjitha aktet nënligjore kanë dalë dhe është nevojë urgjente për t'u ndryshuar ky ligj. Kemi pasur e kemi shumë e shumë probleme pra që janë diskutuar vazhdimisht, që janë çështje të padefinuara dhe shpeshherë bien në kundërshtim me vetë ligjin. Çështja e drejtorëve të shkollave është e padefinuar edhe në këtë ligj.

Kemi pasur një rast që vetë Këshilli për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka nxjerrë një vendim, që ka emëruar, në fakt i ka lëshuar një vendim një ish-drejtori të shkollave si shërbyes civil, e në fakt është në kundërshtim me ligjin.

Kemi parë që në raportin e Këshillit të Lartë të Shërbimit Civil, ka qenë një raport që ne duhet të diskutojmë shumë herë për vendimet e këtij Këshilli. E kam thënë sa herë, nuk e di pse ekziston ky Këshill, më mirë të mos ekzistojë fare, sepse nuk implementohen vendimet e tij.

Shkeljet më të mëdha pikërisht të këtyre vendimeve që ka nxjerrë ky Këshill i Pavarur, janë nga institucionet qendrore e që këtu kryeson Ministria e Tregtisë me shkeljet më të mëdha. Ka ndodhur që një nga shërbyesit civil, Këshilli ka vendosur të kthehet në punë dhe është kthyer në punë për vetëm 12 ditë. Ministria e Tregtisë, pra për 12 ditë e ka mashtruar edhe Këshillin, na ka mashtruar edhe të gjithë neve, mbas 12 ditësh e ka kthyer, e ka larguar prapë personin në fjalë. Pra, vetëm sa për të thënë që është kthyer, janë vendimet enorme që shkelen vazhdimisht nga ky këshill.

Pra, në njërën anë Këshilli, në anën tjetër janë dy ministrinë. Gjatë monitorimit të ligjit në Ministrinë ku, Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Pushtetit Lokal, ndodhen në të njëjtën ndërtesë, ne gjatë monitorimit të ligjit kemi hasur në një kundërshtim, që iu është bërë pikërisht nga këto dy ministri komunave të Kosovës.

Komunave të Kosovës u shkon një shkresë nga Ministria e Pushtetit Lokal, që të nxjerrin rregullore mbi sistematizimin e vendeve të punës të shërbyesve civilë dhe a dini çka ka ndodhur? Kanë punuar komunat me muaj të tërë, kanë shpenzuar kohë, kanë shpenzuar të holla, dhe pas shumë kohe ne i kemi vërtetuar këto kur kemi dalë në monitorim, ju shkon një shkresë nga Ministria e Administratës Publike dhe ju thotë që nuk jeni kompetentë për të nxjerrë rregullore.

Pra, dy ministri në një ndërtesë nuk mund të bisedojnë ndërmjet vete dhe kështu krijojnë një huti tek komunat tona. Pra, kjo është Qeveria e Kosovës, kështu funksionon kjo Qeveri.

Pra është e mjerueshme, po them që sot të diskutojmë këtë raport, është e mjerueshme gjendja çfarë është dhe janë kundërshtimet që janë të vazhdueshme, që kanë dalë e po dalin pikërisht në këtë ligj dhe më mirë është nevojë urgjente, edhe njëherë po e përsëris, që të bëjmë plotësim-ndryshimin e këtij ligji dhe të diskutojmë shumë urgjentisht edhe njëherë kryetar, çështjen e miratimit apo të mosmiratimit të raporteve, sepse dikush duhet të ndëshkohet, për të ndryshuar gjendja. Faleminderit!

KRYETARI: Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar! Do të përpiqem të jem shumë i shkurtër, pasi që jemi duke diskutuar një raport të vitit 2011, të plotësohen vetëm nja dy çështje për shkak se është ministri këtu.

E pashë që në raportin e vitit 2011 nuk është e paraqitur fare e-qeverisja. Më intereson, i nderuar ministër, në cilën fazë është, sa është realizuar strategjia e Qeverisë për e-qeverisjen dhe në cilat fusha të administratës publike dhe në çfarë niveli është ajo, për arsye se në raport nuk është fare e paraqitur.

Dhe, çështja e dytë, gjithashtu e cila nuk është e paraqitur në raport, më intereson sa zyrtarë të lartë, drejtorë dhe sekretarë permanentë janë ushtrues detyre, që nuk janë me kontrata të rregullta të punës dhe përse vazhdojnë të neglizhohen këto çështje në vazhdimësi edhe pse nuk janë të paraqitura në asnjë tabelë, në asnjë raport të vitit 2011?

Shpresoj, që në raportin e vitit 2012 dhe në raportet tjera të kemi një pasqyrim edhe më detaj në raportin e funksionimit të administratës publike, duke pasur parasysh si çelës të funksionimit të një shteti demokratik. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti ministër Yagcilar,

Më lejoni fillimisht, që ta falënderoj ministrin, sepse ka qenë raport mbi progresin në reformë të administratës në Komisionin për Integritet Evropian dhe jam i njoftuar për disa nga shqetësimet dhe progresit që tash janë shkaktuar edhe në Shërbimin Civil të Kosovës. Por, ajo që reforma pretendon në Shërbim Civil është tregues i qartë që është duplikuar administrata. Dhe, tash po bisedojmë vetëm për një pjesë të administratës, që është themeluar me rregullore të veçantë e më vonë me legjislacion, lidhur me shërbyesit civilë në Kosovë.

Janë disa probleme, që unë do t'i përmend këtu. E para është ndërtimi i kapaciteteve të IKAP-it, në mënyrë që ta trajnojë, ta përgatitë dhe ta aftësojë gjithmonë stafin tonë në Shërbim Civil. Këtë po e përmend si pasojë të politizimit të administratës, për këto 13 vjet. Po e përmend si pasojë të asaj që disa nga ministrat kanë thënë, që gjysma e stafit të mos vijnë në punë, nuk vërehen që s'janë në punë.

Dhe raporti i fundit teknik i Komisionit Evropian është që një shërbyes civil në Kosovë punë efikase bën 2.3 orë në ditë. Nga 8 orë të obliguara me ligj ata punojnë vetëm 2.3 orë në ditë. Këto janë probleme serioze. Problem serioz është politizimi, problem serioz është kapacitetet dhe në 3, shfrytëzimi i kohës dhe menaxhimi i kohës, sepse kjo tregon qartë për duplikim dhe për probleme tjera, që i ka Shërbimi Civil.

Nën dy, Gjykata e Shërbyesve Civilë, që është Bordi i Pavarur Mbikëqyrës, është organ i Kuvendit, kjo do të duhej të merret me të gjitha problemet, që punëtorët, zyrtarët, menaxherët në shërbim civil i kanë. Fatkeqësisht, nga moszbatimi i rekomandimeve të këtij organi, shumica e lëndëve shkojnë në gjykata. Ikja e lëndëve nëpër gjykata, mandej vendimi i gjykatave, me kthim në vende të punës, me kompensim të rrogave dhe me vendime tjera, e ka tejkaluar autoritetin e këshillit, që është organ i Kuvendit, e ka lënë Këshillin shpeshherë pa punë dhe në fund e ka lënë pa autoritet ligjor, që është problem serioz.

Nuk do të duhej gjykatat të merren në atë shkallë me të drejtat e shërbyesve civilë përderisa nuk përmbahet ky vendim nga institucionet për të cilat është thirrur. Gjykatat janë organe tjera të pavarura, që do të duhej t'i zgjidhin problemet, por tash shërbyesit civilë, duke i besuar autoritetit të gjykatës, po ikin dhe nuk po merren me organet e pavarura. Praktikisht, organet e pavarura e kanë lënë pa punë. Duhet parë se a ka nevojë të ekzistojë një organ i tillë më në Kosovë, a ka nevojë të jetë si i tillë në letër, sepse autoritetin ia kanë marrë gjykatat me fajin tonë, me fajin e institucioneve, apo në këtë rast të Ekzekutivit.

Përveç kësaj, zoti ministër, unë po dua ta bëj publike edhe një herë në seancë. Sipas disa vlerësimeve dhe gjetjeve, 160 punëtorë vetëm në administratat komunale marrin rrogë si shërbyes civilë, e nuk jetojnë në territorin e Kosovë fare. Ata jetojnë jashtë territorit të Kosovës, ndërsa rrogën me të parin e marrin sikur çdo punëtor që punon 8 orë në ditë, 7 herë në javë. Ky është problem serioz, të shkojnë rrogat prej Kosovës, në kohën kur papunësia në Kosovë është shumë e madhe, në kohën kur kërkesa për përfaqësim gjinor, kërkesa për përfaqësim etnik vazhdon të jetë problem në Kosovë, mendoj që është jashtëzakonisht shqetësuese dhe do të duhej të bëhej hulumtim në shkallë të parë nga Qeveria, dhe shkallën e dytë edhe nga Prokuroria.

Nuk ka të drejtë të marrë rrogë askush në këtë vend duke ndenjur në shtëpi. Na kemi pasur skandale që janë gjetur, por janë eliminuar. Ky që po shihet, edhe nëse është i vërtetë, po del sepse ka emra konkretë që as nuk është shtetase e Kosovës, është e martuar me qytetarë të Kosovës, dhe e merr rrogën e plotë, ndërsa punon në një institucion krejt tjetër, diku tjetër. Janë bërë të pavarur me lista, e ata para zgjedhjeve janë problem serioz.

Kështu që 4 vjet, qytetari i Kosovës po e paguan taksën e njerëzve që nuk punojnë në Kosovë. Mendoj që ka mundësi të eliminohet ky problem. Faleminderit!

KRYETARI: Të lajmëruar për diskutim më nuk ka. Ministër, e dëshiron fjalën? Mirë, urdhëro merre fjalën, por Administrata Publike realisht ka filluar që në mandatin e dytë të qeverisjes në Kosovë të rrënohet dhe ai rrënim si duket nuk është ndalur. E ke fjalën, ministër!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Vërtet raporti është vonuar, sepse ka ndodhur edhe me vonesën e Ministrisë të Qeverisë, por ka ndodhur edhe në procedura parlamentare, por as unë vetë nuk kam menduar që do të shtyhet aq. Sa i përket raportit për vitin 2012, ai është gati, por unë me qëllim e kam pritur këtë debat që raportin ta plotësojmë, të jetë shumë më përmbajtjesore dhe të japim shumë më shumë. Në këtë aspekt, unë besoj që sot një javë do të plotësohet raporti për vitin 2012 dhe do të dërgohet në Qeveri për aprovim, e më tutje në Parlament.

Por, gjithashtu, ky raport nuk përgatitet vetëm me të dhënat nga Ministria e Administratës Publike. Është një lloj anketimi, ku kërkohen prej të gjitha institucioneve t'i dërgojnë të gjitha këto informata.

Nga aspekti tjetër, sistemi i pagave dhe i informatave, sa i përket çdo nëpunësi civil, do të ndryshohet me projektin e Bankës Botërore dhe në të ardhmen do të kemi shumë më shumë informata sa u përket personave, shërbyesve civilë, por gjithashtu edhe institucioneve. Kështu që besoj që çdo vit raporti do të jetë shumë më i plotësuar. Gjithashtu, jemi në fazën e plotësimit të Ligjit për Shërbimin Civil, duke bazuar edhe në rekomandimet nga zbatimi i Ligjit të Shërbimit Civil nga Komisioni Parlamentar. Është duke u punuar dhe, sipas planit, do ta dërgojmë në kuartalin e tretë në Qeveri.

Gjithashtu mendoj se nga aspekti i raportit, Ligji i Shërbimit Civil nuk ka saktësuar çka duhet të përmbajë ky raport, a duhet të jetë edhe nga aspekti i çështjeve politike a vetëm statistikor. Do të ishte mirë që kur plotësohet ligji, të bëhen edhe disa nene sa i përket përmbajtjes së raportit, sepse raporton gjithashtu edhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil dhe nuk ka nevojë për raporte përafërsisht të njëjta. Do të ishte shumë mirë të qartësohet roli edhe e këshillit, por gjithashtu edhe i Ministrisë.

Nga aspekti i sfidave dhe prioritetëve, për këtë vit janë sfida dhe prioriteti i parë për këtë vit janë klasifikimi dhe gradimi i vendeve të punës për çdo shërbyes civil. Prioriteti i dytë është të aprovohen të gjitha rregulloret për organizimin e brendshëm dhe sistematizimi i institucioneve qeveritare.

Kalimi në sistemin e ri të pagave, i cili është gjithashtu i ndërlidhur edhe me projektin për përkrahjen e modernizimit të sektorit publik me Bankën Botërore. Por, gjithashtu, planifikojmë për ta përforcuar Administratën Publike dhe të përgatitet edhe Ligji për inspektimin administrativ, të riprocedohet në Parlament Ligji për pagat e funksionarëve publikë, të plotësohen ligjet gjithashtu edhe për pagat e nëpunësve civilë, Ligji për Administratën Shtetërore, procedurat administrative dhe Ligji për kontestet procedurale. Gjithashtu, të riprocedohet Ligji për Institutin e Administratës Publike.

Sa u përket standardeve të Bashkimit Evropian në Administratën Publike, nuk ekziston acqui communautaire, por tash herën e parë, më 18 qershor, do ta kemi takimin, meqë është krijuar me një grup special me Bashkimin Evropian sa u përket sfidave dhe reformave në Administratën Publike. Aspekti tjetër, është aprovuar dokumenti i interpropabilitetit bashkë me Ligjin për organet e shoqërisë informative, e besojmë që edhe përparimet në e-qeverisje do të jenë më të projektshme.

Në plan është të hartohet një ligj për Agjencinë për Inxhinieringun, i cili është tani departament, por do të ishte mirë në fund edhe këto reforma të rrumbullakohen edhe me ligjet për pagat për fushat tjera në sektorin publik. Sa i përket disiplinimit numerik, në qoftë se mund të ndërtohet në Administratën Publike, Administrata Publike është përgjegjëse për aprovimin e organizimeve të brendshme, por Ministria e Financave dhe Parlamenti nëpërmjet ligjit vjetor për buxhet e cakton numrin e të punësuarave në çdo institucion.

Besoj se këto sugjerime do të ndihmojnë shumë në hartimin e raportit për vitin 2012, i cili do të procedohet javën e ardhshme në Qeveri. Faleminderit!

KRYETARI: Të pranishëm janë 63 deputetë, prandaj mund të shkojmë në votim. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. E votojmë raportin për gjendjen e Shërbimit Civil. Votojmë tash!

Konstatohet se me 43 vota për, 5 kundër, 17 abstenime, Kuvendi e miratoi raportin vjetor për gjendjen e Shërbimit Civil në Republikën e Kosovës për vitin 2011.

Pika e shtatë e rendit të ditës është:

7. Ratifikimi i vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e universiteteve publike në Gjakovë, në Gjilan dhe në Mitrovicë, si institucione publike të arsimit të lartë

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka proceduar për ratifikim në Kuvend propozim-vendimin për themelimin e universiteteve publike në Gjakovë, në Gjilan dhe në Mitrovicë, si institucione publike të arsimit të lartë.

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media i ka shqyrtuar propozim-vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e universiteteve publike në Gjakovë, në Gjilan, në Mitrovicë si institucione publike të arsimit të lartë dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Në emër të Qeverisë, fjalën e ka ministri i Arsimit, zoti Ramë Buja.

MINISTRI RAMË BUJA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Çështja e ratifikimit të tri projektvendimeve ose propozim-vendimeve të Qeverisë për themelimin e tri institucioneve publike ose universiteteve të Gjilanit, të Gjakovës dhe të Mitrovicës është bërë mbi bazën e një propozim-vendimi po ashtu që e ka bërë Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të nenit 145, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, që është pasqyruar në Gazetën Zyrtare nr. 82, 21 tetor 2010, si dhe duke u bazuar në nenin 8, paragrafi ...4, dhe në shtojcën gjashtë të Rregullores nr. 92/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të ministrive, të datës 22.3.2011, dhe nenit 9, paragrafi 1 dhe 10, paragrafi 1, po ashtu të Ligjit për arsimin e lartë që është pasqyruar ose është botuar në Gazetën Zyrtare nr. 14.9, shtator 2011.

Kështu që themelimi i këtyre tri institucioneve publike arsimore universitare është bërë mbi bazën e kërkesave që i kanë bërë qytetarët e këtyre pjesëve ose këtyre qyteteve, edhe të Mitrovicës, edhe të Gjakovës, edhe të Gjilanit, dhe mbi bazën e kësaj kërkeje, edhe Qeveria ka marrë vendim që këto institucione t'i themelojë atje, por t'i themelojë mbi bazën e një arsyeshmërie të plotë, duke pasur parasysh se këtu, në këto tri qytete, ka pasur njësi, faktikisht filiale të njësive akademike të Universitetit të Prishtinës, edhe në Gjakovë, edhe në Gjilan, edhe në Mitrovicë, dhe si bazë e këtij themelimi janë pikërisht këto njësi akademike dhe, në fakt, ka ekzistuar një shqetësim se mos vallë me këtë

themelim, me këto themelata që do të bëjmë do ta ngarkojmë anën financiare të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Aktualisht kjo gjë nuk bëhet. Mund të ketë diçka nevojë për rishikim, të bëjmë një përplotësim, por në fakt nuk ka ndonjë ngarkesë për faktin që këto njësi akademike që janë atje, tani më veprojnë edhe ashtu, por vetëm tani i emërtojmë si institucione të pavarura dhe besojmë se do ta kenë një funksionalitet më të madh, efikasitet më të madh, cilësi më të madhe arsimore, e kjo është edhe arsyeja për të cilën ne edhe mund të flasim dhe gjithsesi arsyetimi për këtë gjë ka plotëni. Faleminderit!

KRYETARI: Radha është për kryetarin e Komisionit Funkcional, deputeti Idriz Vehapi, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari zoti ministër,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 62, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 15 maj 2013, i shqyrtoi vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e universiteteve publike në Gjakovë, në Gjilan dhe në Mitrovicë si institucione publike të arsimit të lartë dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

R E K O M A N D I M

I rekomandohet Kuvendit t'i ratifikojë vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e universiteteve publike në Gjakovë, në Gjilan dhe në Mitrovicë si institucione publike të arsimit të lartë.

A r s y e t i m

Komisioni i shqyrtoi vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e universiteteve publike në Gjakovë, në Gjilan dhe në Mitrovicë si institucione të arsimit të lartë dhe konstatoi se vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e tri universiteteve publike janë në pajtim me nenin 9, paragrafi 1, të Ligjit nr. 04/L-037 për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

Komisioni vlerësoi se vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e universiteteve publike kontribuojnë në interes të përgjithshëm, me qëllim të përfshirjes sa më të madhe të të rinjve në arsimin e lartë.

Komisioni, pas debatit të gjerë, me shumicë votash i përkrahu vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e universiteteve publike në Gjakovë, në Gjilan dhe në Mitrovicë si institucione të arsimit të lartë.

Ditën kur janë shqyrtuar vendimet e Qeverisë për themelimin e tri universiteteve si institucione publike, në komision ka qenë edhe ministri i Arsimit, zoti Buja, bashkë me

stafin e tij, dhe një debat i gjerë, të gjithë anëtarët e Komisionit, po ashtu edhe ministri me stafin e tij kemi ardhur në përfundim që t'i rekomandojmë Kuvendit themelimin e këtyre tri universiteteve si institucione publike për arsimin e lartë, me motivacion që të rinjtë e Kosovës të kenë mundësi të përfshihen në arsimin e lartë, po ashtu një pjesë edhe e Luginës së Preshevës, në Universitetin e Gjilanit, po ashtu edhe në Universitetin e Gjakovës, një pjesë e të rinjve, që mund të vijnë nga Shqipëria, ndërkaq për Mitrovicën kemi menduar që është me interes dhe është një vendim strategjik që të kemi një universitet në Mitrovicë, me qëllim që të rinjtë e Kosovës të jenë të koncentruar sa më shumë që është e mundur edhe në atë pjesë të vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Radha është e kryetarëve të grupeve parlamentare. Nga Partia Demokratike, e do dikush fjalën, në emër të Grupit? Kryetari i Grupit, Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i jep mbështetje dhe u bën thirrje të gjithë deputetëve që ta japin votën, sepse është me interes për të gjithë pa përjashtim. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, nënkryetari Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar i Kuvendit, Krasniqi!

Kolegë të nderuar

Zoti ministër Buja,

Akti i formimit të tri universiteteve me një vendim dhe në një ditë është diçka e jashtëzakonshme. E jashtëzakonshme si imagjinatë, e lëre më si realitet. Dhe kjo kërkesë po del në Kosovë, te ne. Madje tri universitete publike, të cilat duan t'i bashkohen edhe tri universitete publike ekzistuese, të famshmit, jo një kuptimin pezhorativ, por të vërtetë - Universitetit të Prishtinës, dhe dy të tjera që kanë dalë viteve të fundit.

Çfarë po them me këtë? Kam parasysh universitet në kuptimin e vërtetë të fjalës - një institucion i nivelit të lartë, që ofron dhe prodhon dije, që nuk është e njëjta punë, dhe krijon shtresën që përgatitet ta udhëheqë këtë shoqëri te ne, siç e krijojnë edhe në vendet tjera.

Universitet që dijetari i madh shqiptar Sami Frashri e përkthente me një kalk shqip 'gjithëdije' ose 'gjithëmësime'. Kalk të ngjashëm kanë bërë sa di unë edhe kroatët, i thonë "sveučiliste", që i bie e njëjta gjë. Pra, një institucion që i jep të gjitha dijet me pretendimet që ta japë nivelin më të lartë. Atëherë, edhe ne këtu nuk kemi se si t'i trajtojmë ndryshe këto institucione, por si të tilla, si gjithëdije që jepet dhe prodhohet në nivelin më të lartë. Pak a shumë, kështu përpiqet ta sanksionojë këtë institucion edhe Ligji, që ne e kemi në fuqi. Domethënë, nuk është se i kemi ligjet edhe aq të këqija. Nuk janë perfekte, por janë, janë paparë këtu.

Tani, ne e kemi një propozim që vjen nga Qeveria, në të vërtetë, sipas Ligjit, vjen nga ministri në bërthamë, por te ne vjen nga Qeveria, që t'i hapim këtu tri universitete.

Kërkesa e parë e ministrit për hapjen e tyre, si dhe projektvendimi i parë i Kryeministrit nuk ka datë, nuk ka motivim. Motivimi është popullor, elementar. Dikush ka kërkuar universitet dhe ne ia plotësuam kërkesat. Ku do të shkruhet e njëjta fjali, thotë: “Me kërkesën e pareshtur ose të pafund të Gjakovës, po e hapim universitet”; “Për kërkesën e Gjilanit, do të bëjmë universitet”. Domethënë kërkesa është popullore, që është legjitime, që kërkojnë të kenë institucion të tillë të lartë në ambientin e vet, dhe kjo është në rregull.

Problemi është tutje. Kërkesa popullore a i qëndron kriterit, a i qëndron ligjit. Meqë për kriteret është problem të flitet, për diçka që nuk është ende, dhe nuk është provuar, unë po flas për ligjin. Ligjit nuk i referohet, pos vendimi i fundit i kryeministrit, të dyja letrat para, edhe e ministrit të Arsimit, dhe letra e parë e kryeministrit, nuk ka motivim. Thotë: ‘Ligji për arsimin’, por nuk i referohet asnjë neni. Tash, unë e dëgjova ministrin kujdesshëm, faleminderit prej tij, e ka bërë një hap para, se i përmendi dy nene, nenin 9.1 dhe 10.1, dhe tash do të jua lexoj pse i përmend këta dy, se nuk është edhe i pamençur ministri ynë pse i kombinon ato dyja, e i harron të tjerat.

Po pse të mos i harrojë ky kur i harron Komisioni? Dhe, shihni çfarë na jap Komisioni, që na rekomandon, domethënë që bëhet ‘kumbar’ të themi, ose mbështetës i vërtetë, me krejt fuqinë, i ndërtimit të tyre. Ky e përmend një nen, neni 9.1. Janë pak më të plotë këta, domethënë e dinë ligjdhënësit tanë, janë shumë të mirë ose jo shumë të mirë, që diku, nëse përmendet ligji, duhet të mbështeten diku, dhe këta varen në nenin 9.1, të cilin e përmendi edhe ministri, dhe e përmendi edhe 10.1. E tash, të nderuar kolegë deputetë, më lejoni që të jua lexoj këto nene. Pse të jua lexoj? Sepse, propozimi çfarë është dhënë, nuk është në bazë të Ligjit në fuqi. Ja pse nuk është:

E përmendën edhe Komisioni, edhe ministri nenin 9.1, i cili thotë: “Bartës publik të arsimit të lartë mund të krijohen vetëm me vendimin e Ministrisë, i cili duhet të ratifikohet nga Kuvendi”, dhe këtu ndalet. Ky nen tash e ka edhe një nen 2, një nen 3, por 4-shi është me rëndësi, sepse ai tregon që kur të ndodhë kjo, këto universitete e marrin një licencë, i bie që mund t’ia nisin të punojnë rregullisht prej ditës kur merret vendimi, por në propozim nuk thuhet kjo.

Edhe më me rëndësi është neni 10, të cilit i iket në propozime, por kësaj radhe nuk i ik ministri, e përmend njëshin. Njëshi, çka thotë? Thotë: “Universiteti është institucion arsimor dhe i kërkimit shkencor, që jep diploma dhe grada, duke përfshirë nivelin e doktoratës me synim e tjera”. Po pra, njëfarë definomi pak a shumë i universitetit. Problem është, meqë universiteti qenka i tillë dhe që propozohen tre, neni 2, që nuk e përmend njeri i gjallë këtu, e që është përcaktues. Çka thotë neni 2, paragrafi 2, neni 10, thotë: “Në bazë të dispozitave të këtij ligji, emërtimi universitet mund t’i jepet vetëm një bartësi të akredituar të arsimit të lartë që ka ofruar kurse, apo programe të akredituara për së paku 5 vjet në të paktën 5 fusha studimi, sikur përcaktohet me akt nënligjor të Ministrisë dhe i cili ka nxjerrë të paktën nga një të diplomuar me doktoratë të akredituar në secilën nga këto programe”. Po e thjeshtësoj. Universitet nuk mund të bëhet ai që nuk i ka 5 fusha të ndryshme të studimit, që nuk janë të gjitha të akredituara, që nuk i ka 3 nivele të shkollimit, plus që nuk ka prodhuar nga një doktor brenda në institucion në 5 vjet.

Këto që i propozoni, zoti ministër, pos Mitrovicës, që i ka të akredituara edhe një vit dy degë dhe edhe 2 vjet 3 tjera, të dy qendrat tjera nuk e kanë të akredituar asnjë program. Ata punojnë, por nuk janë të akredituar. Domethënë asnjë program, qoftë të nivelit të parë, e jo tri niveleve, jo se jo që nuk ka prodhuar doktoratë. E çfarë të them unë tash finalisht? Mos kujtoni që unë nuk kam qejf të kemi shumë universitete në Kosovë dhe më të mirat e dynjasë. Harrojeni këtë! Veçse nuk është formimi i universitetit punë kaq e lehtë. Do planifikim, do kushte, do para, do programe, do studim të degëve çfarë hapen dhe, në fund, do planifikim ku do të shkojnë eventualisht ata që e marrin këtë dije. Pastaj, me një projeksion të studiuar mirë, me një përvojë të studiuar me interesa të vihet dhe të kalohet në Kuvend.

Edhe një herë po them, neni 9.1 thotë: “Bartësit publikë të arsimit të lartë mund të krijohen vetëm me vendimin e ministrit”, veç ka diferencë bartës së arsimit të lartë edhe në ato vende, zoti ministër, mund të formoni dhe do të ishte në rregull, por bartësi i arsimit të lartë mund të jetë shkollë e lartë, mund të jetë një fakultet, mund të jenë dy fakultete, tri, por jo universitet. Dhe, unë votoj menjëherë. Unë votoj menjëherë që të formohen bartës të lartë të arsimit të lartë publik. Unë votoj menjëherë, por nuk mund të votoj për universitet, se nuk më lejon ky ligj, dhe ajo etikë pak a shumë profesionale që e kam, edhe dije. Domethënë, unë nuk jam ai që pengoj, por është vendi të thuhet.

Dhe, në fund, unë i kam edhe vërejtjet në mënyrën e shkrimit. Zoti ministër, këtu në foltore pa letër flet shumë më mirë shqip, më drejt se që flet kur...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Edhe një minutë e ke!

SABRI HAMITI: ...kjo është me rëndësi, sepse Bujën e kam koleg të vjetër. Thashë: ministri Buja flet pa letër më bukur shqip se që flet letra e Ministrisë së tij që mbetet dokument shtetëror, dhe këtu kam shumë vërejtje. Unë e di që nuk e ke shkruar ti, por mos i nënshkruaj letrat që t’i shkruajnë keq. Pse po them? Po them se jemi duke folur për Ministri të Arsimit dhe për shkallën më të lartë që po përmend ministri i Arsimit, pra universitet. Këto janë dokumente, e nis me njëjës, e del në shumës. Sigurisht janë këta nëpunësit e famshëm, për të cilët biseduam më parë. Po atëherë bile, ti si ministër, se të njoh kush je, mos i nënshkruaj për universitete letrat që t’i shkruajnë keq. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit “Vetëvendosje”, fjalën e ka deputeti Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar

Të nderuar deputetë,

Vendimet groteske të kësaj Qeverie nuk kanë të ndalur. I tillë mund të konsiderohet edhe ky vendim i Qeverisë së Kosovës, që po e diskutojmë sot për themelimin e universiteteve publike në Gjilan, Gjakovë dhe Mitrovicë. Me mendime të tilla, besoj se absurditeti institucional e arrin kulmin e tij. Prandaj, Lëvizja “Vetëvendosje” e mban një qëndrim të thellë kritik ndaj vetë mënyrës se si po themelohen këto universitete, strukturës së tyre

administrative dhe qeverisëse, kualiteteve që ato posedojnë, si dhe kapaciteteve që këto institucione aktualisht ofrojnë për zhvillimin e jetës shkencore, akademike dhe kulturore.

Duke u bazuar në programin tonë qeverisës, që përfshin sferën e arsimit, ne konsiderojmë se përfshirja e numrit më të madh të rinjve në procesin e arsimit të lartë mbetet një detyrë qenësore e institucioneve qeverisëse në Republikën e Kosovës, sidomos kur dihet se sot Kosova, jo vetëm në Evropë, por edhe në rajon vazhdon ta ketë numrin më të vogël të përfshirjes së studentëve për kokë banori dhe nuk ka dyshim se për zbatimin e kësaj strategjie, si shoqëri kemi nevojë për institucione që e mbulojnë këtë sferë të jetës sonë shoqërore. Madje, gjykuar numerikisht, ky relacion në mënyrë reale do të arrihej nëse për çdo vit akademik në nivelin bachelor dhe master, ky raport të ishte 1 000 studentë dhe 100 000 banorë.

Mirëpo, shtrohet pyetja a duhet të realizohet ky dimension sasior mbi atë cilësor. Pa mëdyshje se jo. Kurse ky raport të mos mbetet thjesht vetëm një pasqyrim kuantitativ shoqëror, por të shndërrohet në një moment transformimi kualitativ akademik, si lëvizje inkurajojnë dhe mbështetim edhe hapjen e programeve dhe drejtimeve, kryesisht me orientim profesional.

Po shtrohet pyetja se këto tri universitete që sot kanë ardhur për ratifikim, a i plotësojnë këto kushtet e domosdoshme për jetën akademike dhe zhvillimin tonë shoqëror ekonomik? Nuk ka dyshim se si të tilla ato ndodhin larg këtyre synimeve dhe rrethanat janë mosbesuese. Madje, këtë fakt e mbështet edhe materiali tejet i përciptë e shumë sipërfaqësor që na e ka ofruar Ministria e Arsimit mbi nacionalitetin e këtij vendimi, kurse vetë mënyra se si po themelohen këto tri universitete dhe përmbajtja e tyre qëndron në antinominin e nevojave tona qenësore, sepse pikërisht kjo politikë me qasjen e saj të deritanishme e ka degraduar sferën e arsimit në Kosovë në të gjitha nivelet, në përgjithësi, e atë të arsimit të lartë, në veçanti, ndërkaq tani po i themelon këto institucione pikërisht mbi këto premisa strukturore politike që domosdoshmërisht do ta kenë brenda vetes fatin e predestinuar të dështimit akademik.

Madje, është kjo qasje ajo që ndoshta më shumë se asgjë tjetër është treguar si një nga strategjitë më varrmihëse për idenë e universitetit, duke e bastarduar dhe nëpërkëmbur atë pikërisht në kuadër të atyre institucioneve, që në të vërtetë është dashur të jenë vend i mëshirimit të kësaj ideje. E si shembull eklatant i kësaj gjendjeje të pashpresë se ku është katandisur sot misioni ynë i universitetit, mund të merret edhe vetë Universiteti i Prishtinës. Ky institucion akademik ka kohë që është shndërruar në poligon për realizimin e ambicieve të partisë në pushtet, me synim akomodimin e militantëve të saj brenda tij.

Kjo logjikë partitokratike hegjemonike ka bërë që kriteret akademike ta humbin kuptimin, duke ndikuar kështu në degradimin e plotë të cilësisë së studimeve. Gjykuar mbi këto premisa, edhe hapja e tri universiteteve të reja publike, në Gjakovë, në Mitrovicë dhe në Gjilan, pa ndonjë analizë të mirëfilltë të fizibilitetit, por vetëm mbi premtimet propagandistike, ashtu siç u hapën më herët edhe dy universitete tjera publike, sikur Universiteti Publik “Ukshin Hoti” në Prizren, si dhe Universiteti Publik “Haxhi

Zeka” në Pejë, pikërisht në kohë fushatash elektorale, janë format më të ulëta të keqpërdorimit të arsimit të lartë për motive partiake. Kjo për faktin se as Universiteti i Prishtinës nuk arrin të krijojë kushte për studime cilësore, ndërkohë që zgjerohen kapacitete, të cilat nuk mund të mbështeten as me fonde publike të mjaftueshme, e as me kuadro akademike të kualifikuara.

Institucionet publike të arsimit të lartë aplikojnë pagesa për semestrat, të cilat janë krejtësisht të paarsyeshme, ndërkohë që mundon angazhimi i tyre në projekte kërkimore, që mund t’i sjellin të ardhura shtesë institucionit. Madje sa për të rikujtuar gjendjen e pashpresë ku ndodhen këto institucione të arsimit të lartë, në të gjitha aspektet e mundshme dhe atë veçanërisht sa i përket veprimtarisë kërkimore-shkencore, është me rëndësi që të sjellim disa fakte të shpejta në këtë drejtim. Bie fjala, vlen të ceket se agjenda e Lisbonës është që deri në vitin 2020 të gjitha vendet e Bashkimit Evropian dhe të Evropës, në përgjithësi, duhet të ndajnë rreth 3% nga bruto-prodhimi kombëtar apo GDP-ja për hulumtime shkencore, dhe nëse bëhet një analizë e shpejtë, në rajon ndoshta mund të themi se vetëm Kroacia është vendi që ndan më së shumti buxhet për këtë veprimtari, mirëpo kur bëhet krahasim me Kosovën, mund të themi se vendi ynë qëndron tmerresisht larg nga ky standard i agjendës së Lisbonës. Është e ditur se nominalisht Kosova ndan vetëm 0,1% të GDP-së kombëtare për hulumtime shkencore, por praktikisht as kjo shumë nuk arrin të realizohet.

Prandaj, siç theksojnë shumica e analizave që merren me këtë punë, pikërisht mungesa e fondeve paraqitet si një faktor demotivues për angazhim të personelit në projekte hulumtuese. Në këtë kontest, është e ditur se investimi në sferën akademike dhe shkencore mbetet esencial për progresin e gjithëmbarshtëm ekonomik, social, politik dhe kulturor të një shoqërie. Kjo relevancë është edhe më e madhe, sidomos edhe për vendet e pazhvilluara, sepse praktika historike ka treguar se pikërisht investimi në resurset humane është treguar krucial në zhvillimin socio-ekonomik të atyre shoqërive. Janë pikërisht këto dështime që e karakterizojnë vetë Universitetin e Prishtinës, si njërin nga institucionet më të vjetra akademike në Kosovë, e lëre më universitetet tjera.

Përmbajtësisht kjo gjendje e mjerë nuk ka dyshim se është pasojë e investimeve të pamjaftueshme në fushën e kërkimeve, e mungesës së personelit të mjaftueshëm, të kualifikuar, si dhe mungesës së mobilitetit apo bashkëpunimit të nevojshëm me institucionet akademike ndërkombëtare, e deri te mungesa e pajisjeve laboratorike, e të mos flasim këtu edhe për mungesën e revistave akademike me resension ndërkombëtar.

Është e ditur se dy kanë qenë kthesat më të rëndësishme në kulturën perëndimore, të cilat kanë ndikuar në emancipimin, zhvillimin dhe themelimin konstituiv të këtyre shoqërive mbi premisat e racionalitetit. E para ka të bëjë me shpleksjen e dijes nga instancat institucionale të skolastikës doktrinale. Kjo ka ndikuar në lindjen e universitetit dhe shndërrimin e tij në vatra autonome për kërkimin e dijes universale.

Pikërisht kjo është përhapje e dijes. Nga një qendër e vetme ka ndikuar që universiteti të shndërrohet në një vend të prodhimit të saj me vokacion universal. Për këtë arsye, përmbajtja e tij është e lidhur me universalen dhe të përgjithshme, kurse kthesa tjetër ka

qenë ajo e lindjes së qendrave hulumtuese kërkimore dhe shkencore që shërbejnë për prodhimin e dijes si një e mirë e përbashkët që shërben për zhvillim të gjithanshëm. Ndërkaq, braktisja e kësaj trashëgimie i partikularizon këto institucione dhe i distancon nga misioni i tyre dhe si i tillë ky veprim shënon edhe tradhtinë më të rëndë intelektuale dhe mëkatën më të madh moral që mund t'u bëhet atyre. Në këtë kuptim, ky tjetërsim që është duke u ndodhur universiteteve tona, si atij të Prishtinës, atyre që janë themeluar më herët, si dhe atyre që po themelohen sot nga ky pushtet, si i tillë, nga vendbanim për ide të zhvillimit të përgjithshëm, tani ato janë partifizuar dhe pleksur me struktura partiake.

Substantialisht janë këto veprime, të cilat bëjnë që ky Kuvend sot të legalizojë vetëm godina universitare, por jo universitete në kuptimin fundamental të fjalës. Kështu, funksionimi i këtyre institucioneve mbi këtë bazë, edhe përkundër faktit se ato e mbajnë në ballinë të tyre këtë emër, jo vetëm nuk është kundër-argument i ekzistimit të tyre, por më tepër është kusht i bjerrjes së universitetit në idenë e vet. Në fund të fundit, nëse i perceptojmë sipërfaqësisht vetëm sa i përket ndërtimit të jashtëm arkitekturor, godinat universitare u ngjasojnë burgjeve, kazermave, spitaleve e tjera, mirëpo është veprimtaria e brendshme aty që ushtrohet ajo e cila i diferencon këto institucione ndërmjet veti dhe nëse mungon kjo veprimtari e brendshme, atëherë të gjitha ato u ngjasojnë më shumë burgjeve.

Mbase edhe kjo ndoshta mund të jetë ideja e kësaj Qeverie që të krijojë institucione të tjera të sofistikuara të mbylljes, vetëm sa për ta blerë përkohësisht paqen sociale nga armata e të papunëve, që e ka përfshirë rininë tonë, derisa kjo kategori shoqërore ta gjejë shpëtimin, duke kërkuar forma të tjera të strehimit në trajtën e azilit ekonomik në vendet e tjera perëndimore. Prirje kjo që siç theksojnë sot shumica e hulumtimeve sociale është dëshira e vetme e pjesës më të madhe të rinisë sonë, sepse të kapluar nga dëshpërimi dhe zhgënjimi, ata e kanë humbur shpresën se mund të marrin dije në këto universitete e të gjejnë vend pune në këtë vend. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, fjalën e ka Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Vendimin për themelimin e këtyre tri universiteteve e përkrahim. Në veçanti, do të flas për Universitetin e Gjakovës.

Shkolla e Lartë Pedagogjike në Gjakovë u themelua në vitin 1967, me këto drejtime: gjuhë dhe letërsi shqipe, matematikë, kimi, biologji, histori, gjeografi, mësim klasor. Në vitin shkollor 2001-2002, vazhduan studimet bachelor në grupet e lartpërmendura. Në vitin shkollor 2002-2003, e filloi punën Fakulteti i Edukimit, me drejtimin program fillor, kurse në vitin shkollor 2003-2004, e filluan punën dhe drejtimet lëndore gjuhë dhe letërsi, teknologji-informatikë, kimi-biologji, histori-edukatë qytetare, gjeografi-edukatë qytetare. Në vitin shkollor 2010-20011, u hap edhe drejtimi parashkollor në kuadër të Fakultetit të Edukimit, qendra në Gjakovë.

Po këtë vit akademik u hapën edhe drejtimet: gjuhë dhe letërsi angleze dhe gjuhë shqipe. Këto drejtime u hapën në kuadër të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës.

Në vitin shkollor 2011-2012, Fakulteti i Shkencave Natyrore e hapi drejtimin kimi arsimore, kurse Fakulteti i Mjekësisë i hapi dy drejtime, infermieri dhe mami. Aktualisht në Gjakovë janë 4 fakultete. Fakulteti i Edukimit me 7 drejtime, me mbi 1 300 studentë; Fakulteti i Filologjisë me dy drejtime, me mbi 320 studentë; Fakulteti i Mjekësisë me shumë se 230 studentë; Fakulteti i Shkencave Natyrore me më shumë se 40 studentë. I përmenda këto me qëllim për të treguar se në Gjakovë ka edhe shumë fakte tjera dhe iniciativa për themelimin e këtij universiteti ka datuar qysh më herët.

Në Gjakovë, në fakultetet e drejtimet e ndryshme janë pra gjithsej 2 600 studentë. Në përgjithësi janë nga komunat e Rrafshit të Dukagjinit, por edhe nga vendet tjera, si Shqipëria dhe Mali i Zi. Përveç Fakultetit të Edukimit, fakultetet tjera nuk janë ende të hapura, pra në Universitetin e Pejës dhe Prizrenit. Kjo është shumë me rëndësi për t'u treguar skeptikëve, se nuk synojmë universitete mëhallësh, por synojmë universitete që të kenë cilësi.

Këto fakultete janë vetëm në dy objekte, me kabinete dhe teknologji, që pak kund mund ta kenë teknologjinë siç është në Fakultetin e Gjakovës. Për ata që nuk e dinë, le të shkojnë t'i vizitojnë, e që është në funksion të organizimit të mësimdhënies dhe detyrave kërkimore që kanë 3 500 metra katror në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimor.

Me vendimin e Kuvendit Komunal, këtyre fakulteteve u është dhënë edhe objekti i Shkollës së Mesme Teknike në Gjakovë, me sipërfaqe 4 136 metra katror, i cili objekt, sipas projektit të financuar nga Bashkimi Evropian do të rinovohet dhe do të jetë i gatshëm për vitin e ri akademik. Hapësira prej 7 636 metrash katror do të jetë në feniksin që në fillimin e vitit akademik 2013-2014. Nisma për themelimin e universitetit pra ka qenë synim jo vetëm i stafit akademik të Fakultetit në Gjakovë, por edhe i Kuvendit Komunal të Gjakovës. Kështu, që nga viti 2010, Kuvendi Komunal i Gjakovës, me vendim të Asamblesë komunale të Gjakovës, më 23 shtator 2010, e përcakton truallin në hapësirë prej 13 hektarë e 26 arë për kampusin universitar jashtë qendrës urbane në Gjakovë. Pos kësaj, e ka shpallur tenderin për hartimin e projektit ideor dhe me vendimin 011-2024, të datës 26 prill 2012, e miraton projektin ideor urbanistik, arkitektonik të kampusit universitar, i cili është pra në zyrën e ministrisë, dhe në vitin e kaluar buxhetor ka qenë në pozicione financiare për fillimin e punimeve.

Kështu, Kuvendi i Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2013, me vendimin 011/618, e miraton kërkesën e kryetarit të Komunës së Gjakovës, doktor Palë Lekaj, që të ndërmerren hapat e duhur me Qeverinë e Kosovës, përkatësisht me MASHT-in, duke ofruar partneritet për krijimin e të gjitha mundësive si kuvend komunal, të cilat janë në kompetencë të Qeverisë lokale për themelimin e Universitetit të Gjakovës. Po ashtu, Kuvendi Komunal i Gjakovës zotohet që do ta ofrojë edhe objektin e Shkollës Mesme Teknike në Gjakovë, pas realizimit të projektit të renovimit me fonde nga Bashkimi Evropian në dispozicion të këtij universiteti.

Dhe, për fund, dje kemi filluar monitorimin e Ligjit për arsimin e lartë, ne si komision funksional, dhe dje kemi qenë si grup së pari në vizitë në Ministrinë e Arsimit, kurse vizita jonë e dytë ka qenë në Agjencinë për Akreditim. Unë dua ta pyes nënkryetarin e

Kuvendit se aty e vërtetova që është anëtar i Agjencisë për Akreditim, se a kanë kritere, a kanë cilësi një numër shumë i madh i të vetëquajturave universitete? Sot shkoni e shiheni universitetin ILIRIA. Shkruan shumë mirë, shihet ngado që shkoni. Universiteti AAB, universiteti që kamufllohet, institucioni universitar AAB, Universiteti UBT. Nuk dyshoj dhe nuk paragjykoj që nesër të mos jenë universitete këto. Sot, të nderuar, ato nuk janë universitete. Mashtrohen studentët, mashtrohen fëmijët tanë. A kanë programe dhe cilësi mbi 42 000 studentë që janë në këto degë, që akreditohen nga agjencia, duke besuar gjithëherë që akreditohen dhe shikojnë mirë. Por, ajo mua çka më intereson, më intereson që në Gjakovë të ketë universitet që fëmija e nxënësi të mos paguajë mijëra euro, por ta ketë universitetin aty dhe me 50 centë, një punëtor i arsimit, me një pagë, apo edhe pa pagë fare, ta shkollojë fëmijën e vet aty, e jo të paguajë mijëra euro. Pra, le të jenë universitetet, le të ketë cilësi. Kjo më intereson, por jo pa cilësi.

Sot, ju lutem, të punojmë të gjithë bashkërisht që të ketë cilësi në cilindo prej universiteteve, por jo të kamufllojmë se po bëjmë diçka për cilësi, e në anën tjetër po bëhet biznes, të nderuar deputetë.

KRYETARI: Urdhëro, replikë nënkryetari.

SABRI HAMITI: Nuk kam kurrfarë vullneti të bëj replikë, por ajo e bëri një pyetje për përgjigje. Po pra, nuk kemi nevojë të flasim me entuziazëm, apo me mërzi të madhe, por pikërisht këtu është problemi, se ato që i thonë vetes universitete, janë private, asnjëra nuk janë universitete. Asnjëra nuk është e akredituar. Janë krejt katër kolegje universitare, pikërisht sepse njeriu mund t'i thotë vetes raketë, por nuk është. Ata vetes po i thonë. Mijëra herë i ka thënë agjencia për t'i informuar kandidatët, 'ej, mos shkoni se nuk janë të akredituara'. Është punë tjetër, njerëzit nganjëherë shkojnë, nuk pyesin. Po rezymoj. Prandaj, po them unë, pse jo universitete, por pa nguti të krijohen kushtet, të krijohet kualiteti, të kenë ku të shkojnë studentët dhe të marrin dije të vërtetë. Asnjë i ashtuquajtur, po themi i ashtuquajtur, sepse nuk janë, universitet nuk ekziston në Kosovë. Ekzistojnë disa kolegje universitare dhe institucione të arsimit të lartë. Ju thonë me një emër të përgjithshëm, ato mund të jenë shkolla trevjeçare, diku janë edhe dyvjeçare, shkolla të larta të të zanateve e tjera. Kjo është e vërtetë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritet për ministrin dhe deputetët,

Duke marrë parasysh edhe gjatë shqyrtimit të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, do të nis nga aty, meqë kemi diskutuar shumë në mënyrë parimore, duke marrë parasysh se ministri besoj që ka dije dhe ka vullnet dhe është duke punuar në të ardhmen e gjeneratave të reja që të kenë dije dhe të konkurrojnë me dije edhe nëpër vendet e Evropës, edhe çdo kund tjetër. Mirëpo, në efekt, edhe në bisedën e Kryesisë së Kuvendit, apo në takimin e Kryesisë së Kuvendit, i nderuar ministër, ne kemi shfaqur dilemat tona në lidhje me formimin e tri universiteteve publike në Gjakovë, në Gjilan, në Mitrovicë. Jo pse nuk duam të kemi universitete, të mos

etiketohemi me këtë metodë, se ne jemi që të mos kemi universitete dhe vende të dijes për gjenerata tona, mirëpo sa janë plotësuar kriteret për formimin e këtyre universiteteve, sa ka infrastrukturë ligjore në bazë të vendimit për formimin e këtyre universiteteve dhe çka kishim mundur ndryshe, edhe në bazë të kostos financiare që e kërkojnë këto universitete që të themelohen si bartëse të arsimit të lartë dhe të respektohet ligji.

Edhe një herë kërkoj ndjesë nga gjeneratat e reja që presin të marrin dije dhe presin të konkurrojnë me dije edhe në Evropë, edhe në Amerikë, edhe kudo tjetër, çka jemi duke bërë për gjeneratat e ardhshme me hapjen e universiteteve. Nuk ka çështje lokale këtu apo komunale, kush ku po hap universitete, por çka po bëjmë me hapjen e universiteteve për gjeneratat e ardhshme? Ne jemi këtu në nivelin qendror të Kosovës. Ne nuk jemi në nivel komunal të shohim kush ku po e hap një universitet. U tha edhe nga parafolësit se sa është në viza-vijë me ligjin hapja e këtyre universiteteve. Besoj se ministri ka dije, ka vullnet dhe do të na japë mundësinë ta kuptojmë se çka po ndodh. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi, e ka fjalën.

JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Sigurisht njeriu këtu vërtet ka nevojë ta japë mendimin e vet, se jemi të thirrur që ta japim mendimin tonë. Në fund të fundit, ne jemi përfaqësues të qytetarëve të Kosovës dhe duhet të mendojmë për të ardhmen e qytetarëve që i përfaqësojmë dhe të mendojmë për të ardhmen e tyre vërtet me qëllimin më të mirë dhe me ndershmëri për t'i kryer detyrat dhe përgjegjësitë që i kemi.

Unë do t'i bëj vetëm disa pyetje. Nuk do ta jap mendimin tim, por do t'i parashtroj disa pyetje, dhe unë ministrin e kisha pyetur: A është arritur cilësia e duhur në universitetet publike që i kemi, për të shkuar në hapin tjetër, në formimin e universiteteve tjera? A ka ndonjë planifikim të studiuar për nevojat 10-vjeçare të Republikës së Kosovës për kuadro ekspertë të fushave të ndryshme? A është bërë ndonjë krahasim me numrin e banorëve, por edhe me mundësitë financiare me ndonjë vend evropian, që ne pastaj ta tejkalojmë atë numër të universiteteve? A është bërë ndonjë bashkëpunim në universitetet kombëtare, e kam fjalën edhe me universitetet e Shqipërisë dhe në universitetin shqip në Maqedoni. Pastaj, cila është infrastruktura fizike e këtyre universiteteve që do të hapen? Cilat janë kuadrot që do të punojnë në ato universitete? E vërtet kemi bërë aq shumë kuadro në Universitetin e Prishtinës, që prandaj ato kuadro t'i shpërndajmë edhe në universitetet tjera të Republikës së Kosovës? Sa këto universitete garantojnë cilësi arsimore që njerëzit, studentët, pasi ta kryejnë universitetin, të kenë mundësi t'i bashkëngjiten tregut të punës edhe jashtë Kosovës? Dhe, kemi arritur, nuk kemi pse, prandaj po e them, edhe një herë e kam përdorur një fjalë, 'pse e futim kryet në zall dhe nuk duam me pa'.

Ne kemi arritur që me nxënësit që e kryejnë shkollimin e mesëm të krijojmë analfabetë. Mos po synojmë që ta shtojmë numrin e analfabetëve dhe me njerëzit që mund ta kenë

një diplomë universiteti?! Unë e kam këtë frikë dhe unë mendoj që angazhimi i shoqërisë sonë dhe angazhimi ynë si deputetë, si përfaqësues të qytetarëve të Kosovës, duhet të jetë lufta për të vendosur rend, rregull e cilësi në universitetet ekzistuese, e unë mendoj që këtë nuk e kemi arritur dhe kalimi nga një kaos në kaosin tjetër, besoni se nuk i ndihmon qytetarit të Kosovës, nuk është në shërbim të kualitetit të dijes të qytetarëve të Kosovës. Ne kemi obligim të mendojmë për këto gjëra.

Dhe, në fund të fundit, pse jo, cila është qesja e Buxhetit të Kosovës për të krijuar kështu siç po duam të krijojnë universitete e komuna, e kushedi çka tjetër. Ne e kemi një buxhet që nuk e arrin shifrën 1 miliard e 500 milionë euro. Ne e kemi buxhetin që e ndajmë, por nga mbetjet që vijnë, nga buxheti që e marrim brenda një viti, ne nuk kemi arritur pas 13-14 vjetësh ta bëjmë në buxhet me 2 apo 3 miliardë euro. Le ta bëjmë me një përgjegjësi buxhetin e Kosovës. Le ta ndajmë atë buxhet siç ndahet në vendet që e kanë një drejtësi sociale. Jam për këtë, por jo pa një planifikim serioz, jo pa një qasje serioze dhe jo pa një përgjegjësi serioze.

Unë e ndiej veten të obliguar për të ju thënë këtë juve dhe qytetarëve të Kosovës. Në këtë krizë globale jemi duke parë që shtete me traditë goxha të lartë janë në prag të falimentimit. A dëshirojmë ta forcojmë, ta bëjmë shtetin funksional ligjor, apo duam që brenda 3-4 vjetëve ta falimentojmë këtë shtet? Unë mendoj se këtë përgjegjësi, ne si përfaqësues të qytetarëve, e kemi t'ia themi këtij vendi.

Jam i vetëdijshëm dhe edukimi im është për të qenë njeri i arsimit dhe ta dua arsimin më shumë se çdo gjë tjetër. Unë frikësohem se me këtë qasje të papërgjegjshme të njerëzve që kanë marrë përgjegjësi, po krijojmë diçka që nesër secili nga ne do ta kritikojë. Unë dëshiroj që për gjërat që mendoj që nuk janë të menduara mirë, nuk janë të planifikuara mirë, nuk janë të studiuara mirë, ta them fjalën time para kohe. Pas kohe mund të flasë shumëkush, por atëherë do të jetë vonë.

Unë jam i shqetësuar me papërgjegjësinë, ta quaj kështu, të komisionit përkatës, pa asnjë dokument serioz, pa asnjë dokument të studiuar, në asnjë aspekt vjen, dhe rekomandon që të krijohen universitete. Vota ime edhe mund të jetë 'për'. Unë nuk dua ta paragjykoj këtë, por një gjë po ju them, që kjo nuk është përgjegjësi as kombëtare, as institucionale, e as njerëzore. Unë po ju thërras që për ndërmarrje të tilla të mëdha vërtet ta kemi një seri dokumentesh, të kemi 5 kilogramë dokumente, duhet t'i kemi për një universitet. Ne po mendojmë t'i hapim 3 universitete, e kemi një letër. Ku ndodh kjo kështu?!

Unë jam i bindur se nuk ndodh në asnjë shoqëri ku mendohet kthjellët, dhe mendohet për gjenerata, dhe mendohet për kualitetin e dijes në këtë shoqëri. Ne kurrëgjë më shumë nuk kemi nevojë se ta ngremë kualitetin e dijes. Por, unë nuk besoj dhe nuk mendoj se kështu mund ta bëjmë këtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zotëri kryetar i Kuvendit! Fjalën e ka deputeti Eqrem Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Ta them të drejtën, unë e ndiej si të them njëfarë detyrimi publik që të prononcohem, duke qenë se edhe vogëlsia ime është në Komisionin për Arsim dhe në këtë aspekt do të duhej pak a shumë ta justifikoj pse kam qenë pro të këtij vendimit të Qeverisë. Kjo nuk do të thotë se dua të hyj në debate me njerëzit që i respektoj mirëfilli, si kryetari i Parlamentit, ose nënkryetari i Parlamentit, por po dua t'i justifikoj ato rrethana, në të cilat unë kam votuar pro dhe, në anën tjetër, ende qëndroj atypari.

Tani, unë do të përdor një metodë që nuk e përdor zakonisht. Do të lexoj. Ky është lajm i keq për gjithë deputetët edhe të tjerët jashtë kësaj salle, sepse nuk shkëlqej shumë në lexim. Madje-madje lexoj edhe me rrokje, kështu që kam mirëkuptim për ato personalitete që lexojnë me rrokje, sa nganjëherë po më teket të them: O, ju që lexoni me rrokje, ejani të bëhemi bashkë! Por, lajmi i mirë është se nuk do të lexoj gjatë, se janë veç nga 8 vargje. Kështu, ky është njëfarë lajmi ngushëllues.

Tetë vargje janë të Tagores. Është si njëfarë urate, lutje, dovë. Rabindranat Tagore. Në këtë rast, më lejoni ta falënderoj zotëri Stojanoviçin, që pati mirësinë të ma gjejë botimin e fundit serb që ka dalë të veprave të zgjedhura të Tagores, por për këto 8 vargje, dua të ju thënë për këtë uratë të Tagores. Përpos origjinalit, origjinal e quaj përkthimin veprave të Tagores të tij në anglisht, kam përdorur 8 vargjet në frëngjisht, të përkthyer nga Andre Zhidi, gjithashtu një favorit imi. Kam përdorur nga 4 përkthime në serbisht, një përkthim në kroatisht dhe nga tri përkthime në shqip.

Por, duke qenë se çalojnë, sidomos përkthimet në shqip, i pari Mekuli e pati përkthyer, madje kemi pasur shansin ta kemi këtë lutje të Tagores edhe në librat e klasës së dytë të leximit. Pastaj e përkthye Agim Vinca dhe Nexhat Mustafa, dhe i fundit është i Mihal Hanxharit. Mirëpo për fat të keq, çalojnë fjalitë dhe kështu unë besoj se e kam dhënë një version shumë besnik të lutjes së Tagores në këto tetë vargje dhe më lejoni tash të lexoj, me gjithë paralajmërimin tim që të mos jua grithë veshi diku në qoftë se çaloj në të lexuar në rrokje. Edhe ai e nis këtë lutje kështu, por ju lutem mos harroni se Tagore, jo që ishte një artist i shumanshëm, por me paratë e veta ai e krijoi universitetin për carrokë. Kjo është ajo që mua më implikon më shumë të lexoj dhe ato themele që i vuri në pasurinë e babait, Shante Niketan, tani është universiteti shumë i njohur në Indi, 'Visva Bharati'. E tani më lejoni të jua lexoj atë uratë të Tagores, që me të vërtetë ka qenë njeri shumë i madh, por ju e dini më mirë se unë fundi i fundit këtë gjë.

Atje, thotë Tagoare, atje ku shpirti nuk ka frikë dhe ku balli ngrihet lart,
Atje ku dituria është e lirë,
Atje ku bota nuk ndahet me muret e ngushta të shtëpisë,
Atje ku fjalët burojnë nga thellësia e çiltërisë,
Atje ku përpjekja kurrë e lodhshme shtrin krahët e vet drejtë përsosmërisë,
Atje ku rrjedha e kthjellët e arsyes nuk tretet në shkretëtirën e trishtë zallore të zakoneve të vdekura,
Atje ku ti (e ka fjalën për Zotin) i prin shpirtit kah mendimi dhe veprimi që nuk kanë skaj, tek ai qiell lirie, o zoti im!
Zgjoje vendin tim.

Kaq Tagore. Në këto rrethana, i dashur kryetar, shumë i nderuar, sinqerisht po them, i dashuri nënkryetar shumë i nderuar, tepër sinqerisht po them, ne i kemi kuptuar si rrethana në të cilat do të duhej kapluar më shumë nga një entuziazëm, nga një shpresë, nga një frymëzim që jep liria e një populli. Dhe, në këtë situatë frymëzimi, shprese dhe entuziazmi, nuk ka reagim më normal se sa t'u ofrua një mundësi kolopuçëve që të shkollohen. Kështu që unë po e pranoj dhe e kemi pasur bisedë me ministrin e nderuar çështjen e kualitetit dhe të arsyeshmërisë. Është e vërtetë, mirëpo, megjithatë, në këto rrethana, unë për vete, që nuk jam ilegalist, as nuk kam lidhje me ligje, mezi që i lexoj, me rrokje edhe ligjet i lexoj, por opinionimi im është që t'i lexojmë ligjet, të cilat na mundësojnë të bëjmë aventura të tilla shpresëdhënëse. Të mos i lexojmë ligjet që na pengojnë për gjëra të tilla. Unë guxova dhe u përzjeva edhe në lëmin e zotit Arsim Bajrami për ligjet, por natyrisht nganjëherë edhe mua më lejohen disa qyfyre. Faleminderit!

(Drejtimitin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuari kryetar i Kuvendit,

I nderuari ministër,

Të nderuar kolegë,

Zgjerimi i mundësive për edukim dhe arsimim, apo siç thuhet në letrën e ministrit - afrimi i mundësive për shkollim të lartë të studentët, pa dyshim se është i rëndësishëm dhe Kosova ka nevojë që ta rrisë përqindjen e gjeneratave të përfshira në arsimin e lartë dhe, fatbardhësisht, kjo ka ndodhur. Ne e kemi punuar para një dhjetë vjetësh një strategji të arsimit të lartë, nuk di a është dikush tjetër, mund të jetë Arsimi ndoshta, ose dikush tjetër. Ka qenë e paraparë që në vitin 2015, përfshirja e gjeneratave në arsimin e lartë të jetë diku rreth 25%, dhe kjo përqindje nuk është paraparë rastësisht, sepse bashkë me përqindjen duhet të shkojë edhe personeli që do të japë mësim, do të shkojë edhe infrastruktura, do të shkojnë edhe kapacitetet për studime dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me pyetjet që këtu i bëri kryetari i Kuvendit.

Ne tash regjistrojmë diku në vit, Universiteti Publik dhe universitetet private, sigurisht mbi 20 000 studentë, që do të thotë se gjeneratën në arsimin e lartë e përfshijmë së paku diku mbi rreth 40%, e ky është një standard për afërsisht që e kanë shumë shtete shumë më të zhvilluara se na, me buxhet shumë më të madh se ne, që e theksoi kryetari i Kuvendit.

Parimisht, ne duhet ta mbështetim Qeverinë, në qoftë se intenca është që t'i rrisë mundësitë, oportunitetet për përfshirje, mirëpo nuk mund të kalojmë mbi standardet e nevojshme, mbi ligjet, mbi rregullat dhe ato duhet të zbatohen njësoj, si për universitetet publike, ashtu edhe për bartësit privatë të arsimit të lartë. Dëshiroj të theksoj se nuk ka asnjë universitet privat të akredituar dhe nuk ka asnjë kolegji universitar, siç tha kolegu im dhe miku im, profesor Hamiti. Ka vetëm kolegje, nuk ka as kolegje universitare.

Prandaj, unë nuk di pse nuk ecim në një rrugë normale, që e kemi në ligj, dhe ta themelojmë një bartës të arsimit të lartë në Gjakovë, bartës publik të arsimit të lartë në Mitrovicë, bartës publik të arsimit të lartë në Gjilan. Dhe, në ecje e sipër, kur ata t'i ofrojnë programet e tyre, kur ta ofrojnë personelin mësimdhënës, kur t'i ofrojnë aftësitë e kërkimit shkencor, kur t'i ofrojnë mundësitë e përfshirjes së absorbimit të studentëve, t'i shpallim kolegje universitar apo kolegje, siç po veprojmë edhe në rastin e kolegjeve private. Sepse, me të vërtetë, shpallja e universiteteve publike me një dekret, pa një elaborat, pa një plan, pa një analizë, edhe unë i kam, më lejoni të them, të njëjtat brenga dhe të njëjtën frikë që e ka edhe kryetari i Kuvendit dhe nënkryetari, që e theksuan këtë çështje.

Prandaj, unë jam në favor që sot këtë dekret që të themelohen bartësit e arsimit të lartë publik në këto tri qytete. Ato le të shkojnë në Agjencinë e Akreditimit, le t'i bëjnë analizat e veta, mundësitë e veta dhe le të zhvillohen sipas mundësive që do t'u ofrojë buxheti, që do t'u ofrojë menaxhmenti, që do t'u ofrojë bashkëpunimi me bizneset dhe mbështetja me komunitetet dhe me ato komuna. Sepse për mua është shumë simpatike kjo që tha zonja Haxhiu, që Komuna e Gjakovës është shumë e interesuar të mbështesë mirë, edhe Komuna e Gjilanit sigurisht, edhe komuna e Mitrovicës. Unë i kam parë të tre kryetarët duke u angazhuar në këtë drejtim, por nuk mjafton ajo. Duhet që bartësit e arsimit të lartë duhet t'i futim në disa standarde, të cilat duhet t'i respektojnë të gjithë. Mandej po shkaktohet edhe një konfuzion këtu, si quhen universitetet?

Unë e di se Ministria e Arsimit ua ka dhënë urdhër krejt bartësve të Arsimit të lartë që të mos e përdorin fjalën universitet, por kjo diku zbatohet, diku nuk zbatohet, e mendoj që kjo duhet të zbatohet me rigorozitet edhe nga agjencia dhe të gjithë të jenë të barabartë në treg.

Krijimi i këtyre bartësve të arsimit të lartë në këto tri qytete, në këto tri komuna, e rrit konkurrencën, edhe me Universitetin Publik, edhe me universitetet private, edhe me tjerat, gjë që është mirë të rritet konkurrenca, por jo t'u jepet diçka që nuk meritojnë, diçka që nuk mund të krijojnë artificialisht, të krijohet përshtypja... Universiteti, dihen kushtet. Unë nuk mund të votoj të krijohet universiteti në qoftë se diçka është në kundërshtim me nenin përkatës të Arsimit të lartë, që u citua këtu.

Prandaj, le të jemi të sinqertë me vetveten, të votojmë atë që është me ligj. Unë e kuptoj entuziazmin, e kuptoj dëshirën, por entuziazmin të shkelet ligji nuk e kuptoj. Më fal! Nuk e kuptoj entuziazmin të shkelet ligji.

E kisha kuptuar një entuziazëm të zbatohet ligji në këtë moment. Prandaj, ju ftoj që ta rritim entuziazmin dhe përkushtimin për ta zbatuar ligjin. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë me diskutime. Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Pas akcenteve të deputetit dhe simpatikut tim Eqrem Kryeziu, dhe akcenteve të ambientit që krijuan ato, nuk do të merrem me interpretime statutare të këtyre universiteteve. Nuk do të merrem me interpretime ligjore, sepse ato edhe mund të jenë të diskutueshme, por për mua janë të pranueshme dhe mjaft qartë të interpretuara nga ministri dhe të tjerët që diskutuan. Në fakt, duhet të theksojmë dhe të na motivojë një e vërtetë, e cila është ashikare, është mjaft publike, është e pranishme në jetën tonë. Universitete meritojnë Prizreni, Peja, Gjakova, Gjilani, Mitrovica. Nëse nuk do t'i bëjë Qeveria këto universitete në këto qytete, iniciativa private është e pandalshme dhe do të veprojë para institucioneve tona dhe ajo nuk do të pyesë për cilësinë, për iniciativa private dhe logjika e biznesit të tyre nuk do të jenë motor lëvizës cilësia, emancipimi, arsimimi i kësaj shoqërie, po do të jetë logjika që i vë në lëvizje gjithnjë ato biznese, profiti i tyre.

Dhe logjika e iniciativa private për themelimin e universiteteve e ka kapur nevojën e kësaj shoqërie, nevojën për të pasur konkurrencë, nevojën për të pasur universitete sa më afër familjes, shtëpisë, e ka kapur nevojën e kësaj shoqërie me mungesa financiare për ta mbërri qytetin e Prishtinës dhe për të arritur regjistrimin në universitete private, të cilat aktualisht veprojnë dhe janë të ligjshme, të diskutueshme mjaft në baza ligjore, por ato veprojnë legalisht dhe prodhojnë numër të madh diplomash.

Duke i respektuar gjithnjë kriteret pas themelimit të këtyre universiteteve, për angazhimin e personelit pedagogjik, natyrisht ne do ta ruajmë edhe një brengë që e ngriti edhe kryetari, edhe nënkryetari i Kuvendit, edhe të tjerët këtu që i dëgjuam me të drejtë, shqetësime për cilësinë e diskutueshme në këto universitete që i kemi tani dhe në këto që do të themelojmë pas këtyre.

Natyrisht, nëse neve, apo atë që angazhohen, që do të jenë përgjegjës për drejtimin e këtyre universiteteve, do të kujdesen që t'i respektojnë kriteret për angazhimin e personelit akademik, natyrisht që edhe cilësia nuk do të mungojë. Ndoshta nuk do të shkëlqejë dhe nuk do të shpërthejë përnjëherë një performansë e të madhit që ai gjithnjë e quan vogëlsia ime, Eqrem Kryeziu, por madhështia e tij në një periudhë kur e konstrukton këtu jashtë ligjeve, jashtë interpretimeve statutare, jashtë frymës së asaj që quhet përsëritje, por që me origjinalitet e manifeston këtu, natyrisht që edhe këso performansa do të prodhojnë këto universitete. Ndoshta, jo përnjëherë, nuk e bëjnë një Eqrem Kryeziu tash me flokë të bardha përnjëherë dhe nuk e bëjnë me titull shkencor përnjëherë, dhe nuk e bëjnë me këtë nivel që e ka tani, por do ta prodhojnë në kontinuitet, në vazhdimësi.

Nëse kjo përbërje e këtij Kuvendi, bashkërisht qysh jemi, doni të mbahet mend për të mirë nga shoqëria jonë, ju lutem një nga veprimet e këtij Kuvendi do të jenë themelimi i këtyre universiteteve.

Dhe, bashkë me këto vendime, natyrisht bashkërisht ashtu siç po vërej në të gjitha grupimet që ka mbështetës të këtyre ideve edhe në vendimet tjera, edhe në zhvillimet e tjera që janë akute, që janë imediate, që janë të ngutshme, që janë të domosdoshme për këtë shoqëri, nëse na karakterizojnë neve këto vendime të përbashkëta, kjo përbërje e

këtij Kuvendi në shoqërinë tonë, në këtë brez dhe në breza të tjerë, do të mbahet mend për të mirë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputetë të nderuar! Unë vetëm një gjë dua të them, ne duhet të përcaktojmë a jemi institucion poezish a institucion ligjvënës? Dhe, ju kisha lutur që ta bëni një dallim. Ne jemi për të mbrojtur ligjet dhe për të respektuar ligjet, poezitë, mendoj që e kanë vendin diku tjetër.

(Ndërhyrje)

Jo, ne jemi këtu për t'i mbrojtur ligje dhe për të respektuar ligje, për poezitë, janë të tjerët. Ne s'kemi ardhur për poezi këtu. Fjalën e ka deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Sot, para veti kemi një shkresë të vetme, po them - shkresë të vetme të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me të cilën i rekomandohet Kuvendit që të miratojë vendimet e Qeverisë së Kosovës për themelimin e hiq më pak se tri universiteteve publike dhe atë në Gjakovë, në Gjilan dhe në Mitrovicë.

Që në fillim do të theksoja se sa u përket të rinjve, studentëve, por edhe qytetarëve të këtyre tri regjioneve, me tërë qenien time do të përkrahja, jo vetëm themelimin e Universitetit, por edhe hapjen e shumë fabrikave, shkollave, bizneseve, bibliotekave, shtëpive të kulturës e çka jo për të mirën e tyre.

Mirëpo, vendimi i këtillë nga kjo Qeveri e cila aktualisht po ballafaqohet me një numër të madh të aferave, sikur në nivelin qendror ashtu edhe në atë komunal, më duket paksa i dyshimtë dhe joprofesional, apo më mirë të them një vendim jo i analizuar mirë, me të cilin synohet t'i hidhet hi syve popullit për të mos parë se çka vërtet është duke ndodhur në jetën politike, por edhe në atë arsimore të Kosovës.

Thellësisht jam i bindur se ky vendim nuk ka karakter dhe prapavi profesionale, që do të thotë, nuk ka për qëllim të krijojë institucione të qëndrueshme të arsimit të lartë, të cilat do të ofronin shërbime cilësore dhe të kualitetit të krahasueshëm me universitetet e regjionit apo edhe më gjerë, por thjesht vendimi ka për qëllim përmbushjen e interesave të ngushta politike, grupore dhe familjare të partisë në pushtet.

Për të vërtetuar vlerësimet e mia, unë para jush do t'i paraqes disa fakte, të cilat kanë të bëjnë sikurse me rrjedhat e arsimit të lartë në vendin tonë, përfshirë edhe përvojat e universiteteve rishtas të themeluara, por edhe me përvojat e universiteteve me renome të Evropës.

Se ky vendim është i karakterit politik e jo profesional, në radhë të parë:

1. Tregon fakti se as Ministria e Arsimit e as Qeveria nuk kanë bërë ndonjë studim të mirëfilltë të fisibilitetit për kapacitetet infrastrukturore, njerëzore, akademike, shkencore dhe nevojat e tregut të punës për themelimin e këtyre universiteteve.

2. Argumenti i dytë është se kjo Qeveri e Kosovës është duke themeluar universitete publike dhe private, thuaja se të panumërta, në kohën kur trendët në Evropë dhe botë shkojnë drejt bashkimit, unifikimit të universiteteve të vogla nën ombrellën e universiteteve të mëdha dhe me renome me qëllim të ruajtjes së cilësisë së studimeve.

Kështu, Universiteti i Shefilldit në Britani i ka disa qendra, madje njërin e ka edhe në Selanik, por cilësinë e punës e kontrollon dhe menaxhon nga qendra e Universitetit në Angli.

Rast i ngjashëm është edhe me Universitetin e Berlinit, i cili operon me kampuset e veta edhe jashtë shtetit, por që cilësia e tyre menaxhohet nga qendra e tij në Berlin.

Më tutje, Universiteti Alto, në Finlandë ka pesë degë të veta në tërë Finlandën, por që cilësia e tyre menaxhohet nga selia qendrore e Universitetit.

3. Argumenti i tretë është mungesa e kuadrit të mjaftueshëm profesional për mësimdhënie në arsimin e lartë, respektivisht në universitetet e Kosovës.

Këtë po e them duke pasur parasysh personelin angazhuar në dy universitetet publike të krijuar pikërisht për interesa politike të partisë në pushtet, sepse në mungesë të kuadrit adekuat në këto dy universitete, pra në atë të Prizrenit dhe të Pejës, pjesa dërmuese e bartësve të lëndëve janë kandidatë që sapo kanë përfunduar studimet e tyre të masterit, pa asnjë ditë përvojë pune në arsimin e lartë, duke u bërë kështu me automatizëm profesorë universitar, madje as pa ndonjë raport apo vlerësim të ndonjë Komisioni përkatës recensues.

Kështu, për shembull, në Universitetin e Prizrenit, nga i tërë personeli akademik, vetëm 4 apo 5 sish janë me doktoraturë, kurse të gjithë tjerët janë me master.

Në një situatë të tillë kaotike, një numër i madh i personelit administrativ ka shfrytëzuar rastin dhe brenda natës janë bërë profesorë, e kjo mund të ndodhë vetëm në Kosovë dhe vetëm mbi bazën e vendimit të kësaj Qeverie, pra që shumë referentë të arsimit të lartë të jenë në të njëjtën kohë edhe profesorë të Universitetit.

Andaj, bazuar në faktet e theksuara, por edhe në gjendjen e krijuar në arsimin e lartë në përgjithësi në Kosovë, vlerësoj se kjo Qeveri është përgjegjëse kryesore për rrënimin e theksuar të njërit prej sistemeve më të rëndësishme dhe më vitale të shtetit tonë, e që është sistemi i arsimit të lartë. Por, fatkeqësisht, ndonëse shenjat e rrënit të këtij sistemi tani më veç jemi duke i vërejtur, pasojat e mirëfillta të tij do të paraqiten pas 15 apo 20 vjetëve, kur në Kosovë do të kemi diploma të lëshuara pa kurrfarë kriteresh, kur do të kemi me qindra- mijëra persona me tituj akademik e shkencor, të fituara pa kurrfarë pune shkencore, e të cilat nuk do të mund të shfrytëzohen as në Kosovë e as jashtë vendit,

sikurse për shkak të stërbushjes së tregut të punës me diploma të profileve të njëjta, ashtu edhe për shkak të cilësisë së dobët.

Pra, Kosova shumë shpejt do të jetë një vend që do të ballafaqohet me krizën e shkaktuar nga hiperinflacioni i diplomave universitare.

Mirëpo, kjo Qeveri nuk është duke e rrënuar sistemin e lartë arsimor të Kosovës as nga mosdija e as nga pakujdesia, por veprimet e tilla është duke i ndërmarrë me plan dhe qëllime të caktuara.

Nën një, qëllimi i parë i saj është me motiv politik, sepse gjatë fushatave zgjedhore elektoratit kosovar i pat premtuar se do të themelojë universitete në çdo qytezë të Kosovës. Andaj, duke mos zgjedhur mjete, madje edhe me çmimin e rrënimit të një sistemi të shenjtë për vendin tonë dhe me kusht që të fitojë pushtetin në mandatin tjetër, është në gjendje që pa kurrfarë studimi fizibiliteti, pa pasur kuadër të mjaftueshëm universitar, të themelojë brenda dy vjetëve 5 universitete publike dhe mos të flasim për numrin e madh të kolegeve private.

Arsyeja e dytë e kësaj ndërhyrjeje brutale të politikës në arsimin e lartë është fakti se derisa politikanët e vendeve demokratike të Evropës dhe botës paraprakisht janë shkolluar dhe kanë fituar titujt akademikë dhe shkencorë, e pastaj janë kyçur në politikë, në Kosovë po ndodh e kundërta, sepse ka politikanë te ne, të cilët para luftës kanë qenë pa diploma dhe pa tituj universitar, andaj, nëpërmjet rrënimit të sistemit të arsimit të lartë, dëshirojnë të krijojnë një gjendje të tillë ku nuk ka kritere dhe vlera shkencore në universitete dhe kështu t'i krijojnë vetit terren të përshtatshëm për të fituar fillimisht diploma të fakulteteve e pastaj masterit dhe doktoratës dhe kështu të plotësojnë kushtet formale për t'u bërë mësimdhënës apo siç preferojnë ata ta quajnë veten – profesorë të Universitetit të Kosovës. Për fat të keq, vërtet ia kanë dalur dhe po ia dalin me sukses, sepse pas luftës në Kosovë shumë e shumë politikanë kosovarë, krahas jetës së tyre politiko-publike, krahas bizneseve të shumta të ligjshme apo të paligjshme, nëpërmjet të cilave edhe janë bërë milionerë, ata kanë arritur që me rënie të lirë të kryejnë edhe fakultete, mastere dhe doktorate dhe brenda natës të bëhen edhe profesorë të Universitetit. Dhe jo vetëm kaq, por janë bërë edhe udhëheqës dhe menaxhues si të universiteteve, ashtu edhe të fakulteteve ku punojnë.

Mirëpo, sistemin e rrënuar nga politikanët dhe politikat e tyre ditore e kanë shfrytëzuar edhe familjarët dhe të afërmit e tyre, siç janë: bashkëshortët, vëllezërit, motrat, truprojat, vozitësit e të tjerë, disa prej të cilëve tanimë i kemi profesorë dhe mësimdhënës, qoftë në universitete publike, qoftë në ato private.

Hapave dhe shtigjeve të politikanëve dhe të afërmeve të tyre, normalisht që kanë shkuar edhe shumë qytetarë të tjerë, të cilët duke e shfrytëzuar gjendjen e këtillë të arsimit të lartë në Kosovë, pas luftës janë pajisur me diploma universitare, ndonëse para luftës të njëjtit ose nuk i kanë regjistruar fare studimet ose studimet e filluara i kanë ndërprerë duke mos besuar se do të vijë koha që në Kosovë pajisja me diplomë universiteti do të jetë e njëjtë me veprimin e blerjes së gazetës në shitore.

Si mësimdhënës i Universitetit të Prishtinës kam punuar në tri etapa të ndryshme të ekzistimit të tij. Konkretisht kam punuar në fazën kur arsimi i lartë është organizuar dhe menaxhuar së bashku me arsimin në gjuhën serbe, pastaj në fazën kur studimet në gjuhën shqipe ishin pavarësuar dhe zhvilloheshin nëpër shtëpi private, pronarëve të cilëve shfrytëzoj rastin që t'u falënderohem për ndihmën dhe përkrahjen e arsimit shqip në kohërat më të vështira për studentë dhe popullin tonë në përgjithësi dhe, në fazën e tretë, kur arsimi kosovar organizohet dhe menaxhohet nga organet dhe institucionet shtetërore të vendit tonë.

Po që se bëhet krahasimi i kualitetit të studimeve, procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, procesit të menaxhimit dhe organizimit të studimeve gjatë këtyre tri fazave, atëherë, për fat të keq, më duhet të theksoj një vlerësim timin e që njëherit është vlerësim edhe i shumë kolegëve tanë profesorë të Universitetit, se pa fije dyshimi gjatë kësaj faze të tretë kualiteti i studentëve....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: I nderuar kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Është vështirë për t'ia qëlluar se nga këto biseda të ndryshme, nga shumë kënde duke u goditur edhe nga shumë hipotekime dhe nga shumë konkludime nga nivelet akademike, vjen nganjëherë në çudi se nga kanë ardhur këto nivele akademike për të krijuar ne nivele akademike e tjera?

Prandaj, propozimi që ka ardhur në Kuvend këtu për të krijuar tri universitete të kaluara, më kujton disa qëndrime të disa kolegëve të mi të cilët merren edhe me edukimin, ku para disa vjetëve thoshin në çdo qytet duhet të hapim universitet.

Unë personalisht e kundërshtoja, mirëpo arsyeshmëria pse ne duhet të hapim universitet varet nga arsyetimet që ata i bënin dhe unë i kundërshtoja, por një arsyetim që ishte kur unë kundërshtoja se cilësi mund të mos kemi dhe të gjitha, në arsytetime thoshin se fëmija nuk lind me flokë të bardha, si Eqrem Kryeziu ose të tjerët, por ai lind pa dhëmbë, fillon dikur t'i rriten edhe dhëmbët, dikur fillon të pjekët dhe fillon të ecën vetë.

Prandaj, ne po kërkojmë një situatë e cila nëse ne në perfeksion nuk mund ta rregullojmë, që ne jemi të vetëdijshëm se një perfeksion nuk mund ta rregullojmë edhe ma kualitetin e arsimit, ne nuk do të arrijmë askund.

Prandaj, Gjilani ka nevojë për universitet, i ka ra hise kësaj Qeverie ta ekzekutojë vendimin dhe ne e përgëzojmë.

Ka nevojë Gjakova për universitet, sepse vetvetiu, prezenca fizike e të quajturit universitet në atë qytet do të imponojë edhe sjelljen shoqërore në atë qytet.

Prandaj, tregu i lirë sot që përgatitet edhe për intencat tona dhe aspiratat që i kemi për të hyrë në Bashkimin Evropian, më mirë është në Bashkimin Evropian të shkojnë persona me diploma se sa analfabetë funksional që ne i kemi në rritje sot për sot. Prandaj, jemi përgjegjës komplet për t' i ngritur në këto universitete, por kemi nevojë edhe në Mitrovicë për t' i aftësuar ato shkolla të larta t' i shndërrojmë në universitete dhe të arrijmë nga ajo sasi një pjesë të cilësisë dhe jemi koshientë që mund të mos jenë të gjithë aq kualitativ.

Prandaj, shqetësimet që ngritën këtu janë të bazuara, por nuk mundemi dhe parafolësit kur folën për disa, se ne kemi persona të tillë që kanë kryer diploma ose s'kanë kryer, është mirë të denoncohen, por jo të bëhen pjesë e foltores, këtu. Kush janë ata persona të cilët janë bërë, por jo edhe të jenë fat për t' u anuluar për të mos u hapur Universiteti në Gjilan, të mos hapet Universiteti në Gjakovë, të mos hapët Universiteti në Mitrovicë.

Sot nga Gjakova kishim që ka qenë përkrahje edhe e kuvendit komunal, edhe e qytetarëve, edhe në çdo takim që e bëjmë ne me qytetarët, është kërkesë e tyre, prandaj mos u çoni edhe kundër kërkesave të qytetarëve dhe nevojave të cilat sot janë të bazuara dhe janë nevojë që kjo mundësi, siç tha edhe kolegu im Halit Krasniqi, nëse ne si sistem publik nuk i hapim këto universitete, pamëshirshëm do të gravitojnë universitetet private ku shumica nga ju që jeni këtu ulur pedagogë jepni edhe atje mësim.

Prandaj, ne kemi edhe shumë pyetje për ato universitete që spekulojnë me emrin universitet, e quhen vetëm kolegji zyrtarisht dhe nuk i kundërshton askush që ato nuk janë universitete edhe nga pedagogët këtu, mirëpo ne nuk guxojmë të dorëzohemi, sepse kemi obligim publik dhe nuk do ta fashitim ose nuk do ta stopojmë edhe edukimin privat dhe mundësitë që të jepen private. Prandaj, lus të gjithë kolegët ta thërrasin arsyen e të votojnë për këto tri universitete të cilat do t' ia rrisin vlerën Kosovës, do t' ia rrisin vlerën shoqërisë tonë, do ta kompensojnë atë kohë kur Universiteti për herë të parë është hapur në vitin 1971, ne kemi thënë se nuk do të bëjmë kurrnjëherë universitet me 4-5 profesorë të Shqipërisë dhe me 2-3 nga Beogradi, por sot ky Universitet, është bërë një shtyllë e cila është duke lëshuar rrënjë në të gjitha qytetet dhe ta përkrahim të gjithë fuqishëm dhe ta kritikojmë edhe cilësinë nëse nuk prodhohet, por jo ta stopojmë për të mos u hapur këto universitete. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Sadri Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Pra, edhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit dhe në kuadër të Grupit Parlamentar, kam pasur rastin që të diskutojmë për propozimet e themelimit të këtyre tri universiteteve, që do të thotë një tendencë që të dekoncentrohet arsimimi i lartë në qendra të caktuara, pra për Mitrovicë, Gjakovë dhe Gjilan, përveç të tjerave që i kishim.

Dhe një tendencë, fillimisht do të thotë e mirë, mirëpo duke mos e rrezikuar gjithmonë kualitetin përfundimtar që duhet ta ketë një universitet, pra një arsim kualitativ dhe konkurrues.

Unë dua të thërras ministrin që nëse sot votohet ky propozim që të ngritë të gjitha kapacitetet dhe t'u ndalë në ndihmë të këtyre qendrave, përkundër përvojës që e kanë dhe që të mësohet shumë nga përvoja e Prizrenit, ngase siç dihet atje është humbur një vit, sa për të thënë se ka pasur universitet, ndërsa vitin e dytë jemi të gjithë dëshmitarë që është një progres, prandaj të shfrytëzohet kjo përvojë e të mos humbet një vit, por që tash të bëhen përgatitjet edhe infrastrukturore që diku – diku janë duke u bërë dhe në ngritje të kapaciteteve dhe të gjitha çështjeve tjera që çojnë deri në sukses.

Ndërsa, duke mos e përjashtuar mundësinë se nuk është momenti për një propozim që do ta jap unë, jam i fiksuar pas kësaj dhe do ta jap një propozim që në rast se votohet, atëherë unë propozoj që ministri, gjegjësisht tani është këtu edhe kryeministri, që të bartet si një propozim që Universiteti në Mitrovicë të emërtohet me emrin e profesor Latif Berishës. E di që nuk është momenti të elaboroj më gjatë, sepse e dimë të gjithë, sidomos ata që memorja e tyre shkon përtej një mandati të një ministri dhe të një deputeti, konform procedurave që parashikohen më tutje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti kryeministër, ministër,

Kolegë deputetë,

Mbase janë shterur gati dhe shumica, debati mori kahe të tillë që pati përveç argumenteve dhe momente inspiruese, për çka unë nuk shpresoj që do të jemi edhe aq shumë, por mendova t'i sjell disa argumente që ne si deputetë i kemi për detyrë t'i sjellim këtu.

Është e vërtetë që na nevojiten edhe përgjigje në pyetjet që kanë të bëjnë me çështje të përgatitjeve më të mëdha të Ministrisë për çka ministri është kompetent dhe shumicën prej tyre i ka thënë. Është institucioni i Ministrisë që ka resor të veçantë dhe që bazohet në ligjin ekzistues që merren me standardet e cilësisë, që merren me licenca dhe me çështjet tjera për të cilat nuk mendoj se ne do t'i anashkalojmë, por ne jemi këtu t'i sjellim edhe argumentet tjera për çka e bëjmë këtë vendim të arsyeshëm.

Vetëm llogaritni një familje që duhet ta shkollojë një fëmijë jashtë vendit të tij, të qytetit të tij, sa i kushton një kosto mujore në gjendjen në të cilën ekzistojmë. Dhe për fatin tonë të mirë ky vendim sot nuk ka të bëjë vetëm me tri qendra të mëdha dhe qytetet më të vogla përreth tyre, po ka të bëjë edhe me qytete si Presheva, Bujanovci e Medvegja, të cilat kanë shprehur radhazi disa herë kërkesa të tyre që t'u ofrohen më afër mundësitë edhe për ta të shkollimit. Pra, Universiteti i Gjilanit rrjedhimisht tani do t'i krijojë edhe këto mundësi dhe ne duhet të bëjmë të pamundurën ndoshta që t'u bëjmë lehtësira edhe tjera këtyre banorëve, këtyre të rinjve që dëshirojnë të shkollohen aty.

U tha këtu se do të kemi, përveç tjerash dëgjova edhe krizë nga diplomat e tepërta e tjera. Ju kisha thënë përveç asaj që ne do të bëjmë pyetje, që po bëjmë e shtrojmë pyetje tash për cilësinë, kriteret e tjera, vetëm le t'i krahasojmë rrethanat në të cilat është krijuar Universiteti i Prishtinës dhe të balancojmë, të gjejmë se çka është sot e rëndësishme, sa është e rëndësishme t'u ofrojmë sa më afër një shkollim gjeneratave të reja, brezi të ri dhe

ne do të kemi krizë jo nga diplomat e tepërta, por nga mungesa e tyre. Tashmë ne po synojmë të përgatisim gjeneratën e re për tregun e punës, është konkurrenca ajo që do t'u japë përparësi atyre që duhet ta zënë një vend të punës dhe mendoj që Universiteti publik duhet ta bëjë punën e vet që këtë cilësi ta ngritë dhe mendoj që është çështja e politikave të Ministrisë dhe të Qeverisë ta arrijë këtë.

Unë i bashkëngjitëm pyetjes, në një aprovim që jam shumë i lumtur që sot mund ta votoj sot një vendim të tillë. Kërkoj nga Ministria e Arsimit, sepse është koha shumë e shkurtër, që në bashkëpunim edhe me pushtetin lokal të këtyre tri qyteteve të bëjë përgatitje , të fillojë përgatitjet që sa më shpejt këto universitete që në tetor të kemi kushte edhe fizike për fillimin e punës së tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Ardian Gjini e ka kërkuar fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Mendoj se shumëçka që u tha këtu është e vërtetë. Mendoj se askush prej nesh nuk ka dilemë që vendimi për themelimin e këtyre universiteteve është më tepër politik sesa i bazuar në ndonjë analizë ose ndonjë plan të ngritjes së kualitetit.

Sidoqoftë po e them të fundit të parën se Kuvendi duhet ta votojë këtë, duhet ta ratifikojë këtë vendim edhe arsyet janë të shumta.

Për një kohë të gjatë të studimit jashtë, e kam mësuar një nocion i cili ka qenë totalisht i panjohur për mua në Kosovë, sa kam studiuar në Prishtinë, dhe ai është ekonomia e Universitetit publik. Çka është në ekonomi Universiteti publik.

Në Britani të madhe, në një qytet jo të vogël, prej rektorit deri te Aimejer, kryetar i qytetit, më kanë thënë që Universiteti është ekonomia më e madhe e qytetit, për shkak se studentët paguajnë qira, ushqehen, blejnë libra, veshmbathje, frekuentojnë. Tani e di se kjo mund të jetë edhe e keqkuptueshme në Kosovë, se dikush thotë çka ka lidhje ekonomia me shkencë. Unë po ju them se vendimi i parë i dal për themelimin të këtyre universiteteve i cili e ndryshon ekonominë e universiteteve publike në Kosovë, e ka një të metë dhe mendoj se ky është problemi i këtij propozimi, jo vetëm ajo se a kemi ne kapacitet akademik ose a kemi mundësi që të ofrojmë kualitete mësimdhënie edhe në universitete tjera, është si do të pasohet ky vendim.

Çka do të ndodhë e cili do të jetë plani i shtrirjes së mësimdhënies? Është e vërtetë që ndoshta numri i studentëve do të rritet pak, jo shumë. Ata që kanë vendosur të studiojnë e gjejnë mënyrën të studiojnë, mirëpo, fakti ndoshta se do ta kenë universitetin afër, do ta rritë pak numrin e studentëve, ndërsa numri i personelit akademik, sidomos i personelit të vërtetë akademik për të cilin disa kolegë folën këtu dhe duhet nënvizuar atë – personelit të vërtetë akademik, do të mbetet i njëjtë. Ai plan do të konsistonte në distribuimin e atij personeli sa të jetë e mundur. E kemi të qartë se nuk është e mundur që një gjë e tillë të bëhet saktë, edhe ashtu si do të kishte qenë në rregull.

Çka do të ndodhë në të ardhmen, çka do të prodhojnë këto universitete, mendoj se duhet të jetë temë e debatit të vazhdueshëm, jo vetëm në Qeveri, por edhe në institucione tjera akademike në Kosovë, për shkak se një gjë, po them një premisë ndoshta është e qartë. Nuk rrezikohet shumë që të ulet kualiteti i mësimi, po them i mësimi ose i studimit në Kosovë për shkak të universiteteve, mirëpo rrezikohet seriozisht që të jenë totalisht institucione të arsimit të lartë të cilat nuk prodhojnë vlerë shtesë për Kosovën. Dhe nëse nuk prodhojnë kurrfarë vlere shtesë, atëherë projekti do të dështojë.

Edhe një herë po them, mendoj se këto universitete duhet të themelohen, por vetëm 10% të punës që duhet ta kryejmë për t'i funksionalizuar këto universitete, kryhet me këtë vendim i cili eventualisht do të merret sot. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Komisioni për Arsim, një prej komisioneve shumë serioze u atakua nga fjala e kryetarit që e pat.

Unë vetëm, të nderuar deputetë, përpos profesori Hamiti që u thirr në pika të caktuara, në nene të caktuara, fjala e kryetarit të Kuvendit ishte më shumë propagandë kundër universiteteve, por mua më vjen shumë keq që disa profesorë këtu, të nderuar, që janë dhe që e dinë, studentët vijnë prej Peje, prej Gjakove për një rezultat të provimit, dy muaj presin dhe si nuk është kjo e rëndë për ne të gjithë neve këtu të diskutojnë këta dhe mos t'u lehtësojnë njerëzve të studiojnë atje afër shtëpisë së tyre.

Po më vjen shumë keq, por ne në Komision, për shkak se kemi qenë serioz e kemi thirrur ministrin aty dhe në Komision kemi vendosur me shumicë votash ta sjellim vendimin e Qeverisë, për ta ratifikuar në Kuvend.

Fjala e kryetarit ishte shumë atakuese për Komisionin dhe vërtet ishte e pa matur. Faleminderit.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYETARI: Replikë! Unë nuk kam bërë politikë, edhe pse politikën e kam profesion nga 40 vjet, sa ke edhe vjet ti. Nuk jam kundër arsimit se jam punëtor i arsimit dhe sigurisht se e dua edhe më shumë se ti, po unë po dua ta them këtë.

Unë i bëra pyetje ministrit: a ka bërë studim fizibiliteti për të hapur universitete të reja dhe a i ka kapacitetet edhe financiare edhe intelektuale Kosova për t'i hapur tri universitete publike përnjëherë? Unë, pyetje i parashtrova.

Dhe unë kam të drejtë të dyshoj se e kam një përgjegjësi edhe njerëzore edhe kombëtare para këtij vendi, dhe Kosova i ka vetëm 10 000 kilometra katrorë. Mund të hapen degë të Universitetit të Prishtinës në çdo qytet të Kosovës, nëse vërtet ka kuadro dhe ka nevojë.

Prandaj, mos tentoni t'i vëni njerëzit në pozita që s'i kanë. Jam për arsim, por për arsim

cilësor. Këtu edhe deputetët e grupit tuaj parlamentar të Partisë Demokratike, kanë vënë në dyshim tezat e doktoraturës edhe të kolegëve të vet. Ne e dimë që me shkollë të mesme ka analfabetë, që e kryejnë shkollën e mesme dhe s’di shkrim – këndim.

Ju lutem, t’i kemi parasysh këto. Ne dëshirojmë të kemi universitete dhe fakultete, por që kanë cilësi dhe diploma e tyre nuk mund të kontestohet, jo vetëm në Kosovë, por në asnjë vend tjetër. Ne po kërkojmë cilësi. Ne po kërkojmë të krijojmë kushte dhe unë mendoj që edhe për këta studentë dhe për këto universitete që i kemi ne s’kemi krijuar kushte.

Unë kërkoja studim fizibiliteti për mundësinë e hapjes së një universiteti.

I nderuar deputet, ti e ke pasur vetëm një dokument. Asnjë material studimor që e arsyeton krijimin e universiteteve nuk e ke pasur.

(Ndërhyrje)

Unë nuk e di çka ke diskutuar, unë e kam pasur materialin para teje. Para teje e kemi pasur materialin dhe e kemi parë çfarë materiali ka, prandaj kujdes në fjalët që i flisni. Këtu jemi dhe secili e ka mendimin e vet. Unë kam bërë pyetje më tepër se sa që kam folur dhe unë pres përgjigje prej ministrit, jo prej deputetëve.

Unë po pranoj që ka shumë profesorë të Universitetit edhe këtu edhe jashtë tij, por nuk e di sa e meritojnë ata të hyjnë në derë të Universitetit.

KRYESUESI: Idriz Vehapi e ka fjalën, veç sa më shkurt.

IDRIZ VEHAPI: Po përgjigjem ashtu shumë shkurt! Unë në politikë s’jam kohë të gjatë, por profesor në Universitet, jam prej vitit 1989. Dhe unë jam ai që kam shkuar në Zagreb për të marrë dije dhe të di çka është Universiteti. Me tren kemi udhëtuar atëherë, aeroplanët s’kanë qenë shumë.

Prandaj jam kundër atyre që bëhen profesorë për një vit, dy, sikur që e përmendi një koleg imi, por jam për t’iu lehtësuar njerëzve për t’u shkolluar, sepse parametrat në Kosovë flasin se ende jemi larg në përqindje me numrin e popullsisë të njerëzve me arsim të lartë. Sepse, ke kërkuar ta dish përqindjen, dhe ndoshta ministri ta jep përgjigjen, por ne jemi diku 26%, ndërkaq në vende tjera është mbi 40.

Kryetar i Kuvendit, Komisionin për Arsim, edhe një herë po flas pa ndonjë arsye, e ke atakuar dhe ky Komision për të qenë më funksional është dashur me kohë të mendoj dhe dy komisione i keni bërë bashkë në fillim të legjislaturës, e keni shtuar edhe administratën e pushtetin lokal, e pastaj edhe diasporën, asnjëherë nuk jeni lodhur për të qenë këto komisione funksionale dhe vërtet për t’i ndarë përgjegjësitë edhe te tjerët për të qenë më mirë.

Por, edhe përkundër kësaj, unë shumë i falënderoj anëtarët, të gjithë anëtarët e Komisionit dhe dy nënkryetarët, sepse ne punojmë me nga 7 – 8 orë në ditë në Komision,

i diskutojmë të gjitha çështjet të cilat na vijnë aty, të gjitha raportet me kohë i procedojmë, prandaj edhe një herë e pashë të arsyeshme që t'i mbroj edhe anëtarët tjerë të Komisionit, sepse vërtet bëjnë një mund të madh. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit!

Unë vetëm dëshiroj të qartësojmë këtu. Nuk është mirë për t'i ndërruar tezat, nuk është dikush kundër ofrimit të arsimit të lartë, dhe unë jam për dhe e mbështes. Natyrisht edhe në këto tri qytete ne kemi nga një institucione të caktuara, fakultete, shkolla të larta e tjera.

Ne këtu po flasim për themelim Universiteti, e për të qenë Universitet, janë kriteret e caktuara. Me ligj, ky Kuvend i ka aprovuar dhe po insistojmë që ato të zbatohen edhe për institucionet, bartësit privatë, edhe për institucionet publike.

Prandaj, mendoj se vendimi i Qeverisë duhet të korrigjohet, të shkruhet – ratifikohet vendimi për themelimin e bartësve publikë të arsimit të lartë në Gjakovë, në Pejë dhe në Mitrovicë. Nuk ka këtu problem, për Universitet ekzistojnë kushtet. Në qoftë se ne i quajmë universitete, këto automatikisht me ligj e fitojnë fuqinë që të shpallin dikë profesor Universiteti, profesor të rregullt, profesor inordinar e shumë, e shumë çështje tjera, të cilat janë shumë serioze. Janë tejet serioze në qoftë se ne dom t'i zbatojmë standardet e dijës dhe standardet e cilësisë, po flasim për standardet evropiane, për integrimin evropian.

Prandaj, situata është që një vendim i Qeverisë të vihet në korniza ligjore brenda Ligjit për arsimin e lartë, ju lutem. Këto janë dy çështje, a po domi ne të krijojmë bartës të arsimit publik në Gjakovë, në Prizren dhe në të gjitha këto qendra që janë brenda.....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Fjalën e ka Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Ta shfrytëzoj kohën, mos të humb shumë kohë se kam shumë të them.

Këtu në këtë Kuvend, asnjëherë, asnjëherë nuk është ngritur çështja e bartësve të arsimit privat që kanë emrin universitet dhe kolegji universitar, as nga nënkryetari i Kuvendit që unë dje mora vesh se është anëtar i Bordit të Agjencisë për Akreditim.

Ju lutem, ju lutem deputetë, mos flisni politikisht, por mendoni qysh është më së miri për të gjithë studentët, të gjithë ata që janë të interesuar të studiojnë.

Edhe një herë po ju them, Komisioni i ka pasur të gjitha materialet në shqyrtim, ashtu siç është kërkuar prej Kryesisë. E kemi thirrur ministrin, e kemi gjithë materialin, por edhe një herë po ju them – ju lutem, mendoni mirë kur votoni, mos flisni dhe mos veproni tani

kur është momenti që këto të hyjnë në mënyrë institucionale njëherë e përgjithmonë, lë të merren diplomat false, diplomat që blihen brenda nate, të masterit e tjera, e tjera, që ju të gjithë e dini, po këtë nuk e keni thënë asnjëherë.

Sot duhet t'ia jepni votën për dhe kjo është mënyra për t'i kontrolluar. Kjo është mënyra për të pasur cilësi në arsim, jo të blihet diploma brenda nate, që shumica prej juve e dini se si merren ato diploma.

Prandaj për t'u kontrolluar ato diploma, për të qenë të licencuara, për të qenë të vlefshme, për t'i dalë ballë secilit shtet me diploma të Universitetit të Prishtinës, ju sot duhet t'ia jepni votën këtij vendimi.

Pra, edhe një herë, gjithnjë duhet të ketë llogaridhënie, gjithnjë duhet të ketë kontroll nga inspektorati që shumë pak vepron dhe nuk vepron as Ministria këtu, as Ministria s'ka vepruar asnjëherë në vendimet që janë marrë nga Agjencia e në fakt nuk janë vendime, aty është shkelur ligji për arsimin e lartë. Nuk kemi Universitet, shkelet vazhdimisht. Nuk kemi as koleg universitar, shkelet vazhdimisht, pjesë e asaj është edhe nënkryetari i Kuvendit, ju lutem, në Bord.

KRYETARI: Sabri Hamiti, replikë.

SABRI HAMITI: Unë jo replikë, por shpjegim, sepse është një mori njerëzish që ma kanë përmendur emrin, unë s'kam reaguuar. Dikush funksionin, s'di pse, emri është mjaft, nuk ka nevojë për t' i identifikuar me funksione njerëzit, se s'po më pëlqen.

Problemi është i thjeshtë. Arsimi publik dhe arsimi privat është i barabartë në të drejta dhe obligime me Ligjin e Republikës së Kosovës. A është i mirë a s'është i mirë, janë, ai vlerësohet, edhe ai edhe ai. Kaq! Ata janë të barabartë.

Dhe duke qenë të barabartë Qeveria dhe Kuvendi, bashkë me Qeverinë, janë të obliguar t'i këqyrin çfarë kualitete japin, se edhe pse është privat, marrin përgjegjësi institucionale për studentët që studiojnë atje.

E dyta, shikoni, këtu të mos të bëhemi edhe pak qesharak. Ne jemi ligjvënës, e tash këtu po duhet bërë njeriun t' i vijë marre pse po thotë të zbatohet ligji. Po ju, a po doni bre shtet ligjor, përditë, nëpër deklarata?

(Ndërhyrje)

Ngadalë, zonjë. Zbatimi i ligjit, ajo që po kërkoj unë dhe kërkon edhe ju nesër, të gjithë do të kërkonin, nëse është Universitet, i ka kushtet, qysh quhet, me ligjin, se nuk është punë qejfi. Nuk është punë qejfi i jemi, i juaji, i atij, me ligj bëhet kjo. Kaq, unë s'kam kurrgjë tjetër.

Sa për vullnetet, të kemi shumë shkolla, këto s'na ka hije t'i themi njëri-tjetrit se të gjithë kemi qejf të kemi shumë shkolla të mira, të larta dhe kjo s'ka kuptim dhe s'duhet të bisedojmë për këtë punë. Mos t'ia bëjmë si një udhëheqës që e ka lënë....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Unë dua ta lexoj rregullën 40 - Shqyrtimi i Projektligjit ose mocionit përmbajtjesor.

Nën pikën c) është në fakt, e drejta për replikë, do të thotë pika 4 për një çështje në një pikë të rendit të ditës, deputeti mund të diskutojë vetëm një herë, me përjashtim të replikës.

Vazhdojmë. Kryeministër, e kemi edhe një deputetë, dhe ndoshta pastaj ka qenë mirë ta merrni fjalën.

Gëzim Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër, ministra të nderuar,

Deputetë të nderuar,

Vendimi për themelimin e universiteteve të reja padyshim që i ka edhe anët pozitive dhe negative. Por, unë uroj dhe jam optimist që ky vendim për hapjen e universiteteve të reja publike, le të jetë si motiv shtesë për mbylljen e fakulteteve apo si quhen sot kolegjeve private, ngase prej momentit kur kanë hapur, lulëzuar universitetet private, konkretisht kolegjet private në Kosovë, nuk kemi cilësi në arsim. Këtë duhet ta dimë, se u përmend cilësia në arsim.

Nuk ka cilësi. Dihet kriteri i provimeve në fakultete private dhe dihet në fakultete publike. Po e bëj vetëm një krahasim me fakultetin tim ku e kam kryer, në fakultetin publik të Universitetit të Prishtinës – në Fakultetin e Mjekësisë, i cili vetëm vite i ka 6 vjet teori provime dhe praktikë, ndërsa fakulteti privat që ka qenë dhe është funksional në Kosovë, po edhe në vende jashtë Kosovës janë me vetëm 4 vjet dhe studentët me 4 vjet fakultet privat, por edhe duke iu nënshtruar edhe kriterëve joreale, kanë marrë nota shumë të larta dhe kanë garuar e zënë vende të atyre që e kanë kryer fakultetin publik në Universitet publik.

Do të thotë sot nuk mund të flasim për cilësi, gjithçka mund të flasim por cilësia ka rënë. Mirëpo, uroj ministrin e Arsimit, që ky vendim për hapjen e universiteteve publike në vende të ndryshme të qyteteve të Kosovës, të jetë hap nxitës që të mbyllën ato private, ngase është degraduar arsimi në Kosovë.

Unë shpresoj dhe jam optimist që ministri do të ndërmarrë hapa të tillë ngase nëpërmjet fakulteteve private s'kemi prodhuar cilësi, por kemi prodhuar vetëm diploma e shpeshherë në momente të caktuara, edhe ashtu u përmenden, diploma fals dhe tituj postdiplomik pameritor. Faleminderit!

KRYETARI: Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Zoti kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Padyshim që hapja e universiteteve të reja publike është një ngjarje e rëndësishme për çdo shtet, natyrisht edhe për Republikën e Kosovës, sepse ne kemi pasur një universitet të vetëm publik dhe Ligji për arsimin e lartë ka bërë një arritje shumë të madhe duke e futur pluralizmin e bartësve të arsimit të lartë, por duke e futur edhe konkurrencën në sferën e arsimit të lartë publik.

Njëkohësisht, po t'i shohim edhe shtetet tjera të tranzicionit edhe ato pak a shumë e kanë decentralizuar sferën e arsimit të lartë, por kanë pasur shumë kujdes që sidomos në sektorin publik të arsimit të lartë të mbrohet me standarde, sepse ecuria e standardeve në cilindo universitet të arsimit të lartë, rrezikon edhe integrimin e Kosovës brenda hapësirës evropiane të arsimit të lartë.

Unë mendoj se ky propozim që ka ardhur nga Qeveria është fillimi i themelimit të dy universiteteve. Jam i sigurt se Qeveria ka bërë edhe përgatitje tjera, sepse në pikën pasuese e kemi edhe miratimi ne statuteve të këtyre organeve. Do të ishte mirë ndoshta të ishte edhe studimi i fizibilitetit të cilin po e kërkon me të drejtë kryetari i Kuvendit, por unë mendoj se ai do të bëhet. Por dua t'i heq shqetësimet legale që i pati nënkryetari dhe që i shtroi me të drejtë, sepse krahas dëshirës për të ofruar arsim të lartë studentëve dhe për të decentralizuar arsimin e lartë, ne duhet të veprojmë edhe në baza legale.

Dua ta siguroj se ky nuk është një proces i mbyllur votimi i sotëm, sepse komplet programet, kurikulat e këtyre tri universiteteve do të shkojnë te Agjencia e Akreditimit. Dhe Agjencia e Akreditimit do të shohë sa programe do të mund të realizohen dhe ajo do ta japë fjalën e fundit. Ministri mund ta konfirmojë kur kanë konkurruar kolegjet universitare në akreditim, të gjitha kanë konkurruar me emrin universitet, por vendimet e Agjencisë së Akreditimit i kanë kthyer në kolegje, sepse ato nuk i plotësojnë kushtet dhe ne nuk duhet të mendojmë se këtu do të ketë një stih apo një anarki, do të funksionojë sistemi, janë institucione të themeluara me ligj dhe ky vendim i Qeverisë dhe i Ministrisë do të shkojë në hapa tjerë, do të shkojë në Agjencinë e Akreditimit....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, vazhdojani! Jo, ti i ke dy minuta, fol, se s'ke folur. Regjia, gabim është.

ARSIM BAJRAMI: Do të thotë, dua t' i heq shqetësimet legale që u paraqitën me të drejtë, sepse askush në këtë sallë nuk është kundër themelimit të universiteteve. Këtu u paraqitën disa shqetësime legale. Dua të theksoj se ekzistojnë institucionet relevante në sferën e arsimit të lartë që do ta thonë fjalën e vet. Ky është vetëm fillimi. Ministri nuk do të lejojë fillimin e punës së universiteteve derisa nuk akreditohen programet. Në qoftë se zoti ministër nuk do të kesh gjashtë programe të akredituara, atëherë ty ligji të obligon që

këtyre mos ua jepni emrin universitete dhe të kërkonti që në vitin e ardhshëm të shtohen kapacitetet, kështu që nuk duhet menduar se ne po bëjmë shkelje.

Qeveria ka të drejtë, sepse është përgjegjëse të japë propozime për themelim të universiteteve publike, është propozues i autorizuar, por procesi duhet të shkojë deri në fund në pajtim me rregullat e Ligjit për arsimin e lartë në mënyrë që këto universitete të funksionojnë me standarde, sepse tanimë po fusim edhe konkurrencën në sferën e arsimit publik të lartë. Do të kemi gjashtë universitete , kjo është jashtëzakonisht mirë.

Unë edhe më herët i kam bërë një pyetje ministrit dhe i kam thënë se Ministria duhet t'i forcojë kapacitetet e monitorimit të cilësisë në këto universitete, sepse edhe ne në Universitetin Publik të Prishtinës po vijmë në situatë jo të mirë për shkak se tani një diplomë që jepet në cilindo nga këto pesë universitete është e barasvlefshme me diplomën e Universitetit publik dhe kemi nevojë që të kërkojmë standarde dhe kritere të njëjta, edhe te kualiteti i mësimi, po sidomos të kualitetit të kuadrit, sepse jam i sigurt që Kosova nuk ka kuadro të mjaftueshme të përgatitura që t'i mbulojë nevojat e gjashtë universiteteve. Për këtë arsye duhet të jemi të kujdesshëm që duke themeluar universitete të mos e mbyllim derën e integritetit në sistemin e Bolonjës, sepse kur do të vijmë në prag të pranimit në sistem të Bolonjës do të ketë një kontroll të rreptë të cilësisë dhe ne nuk guxojmë të improvizojmë, sepse kjo do të na kthehet pastaj si bumerang.

Kështu që, unë mendoj se edhe këto shqetësimet legale që me të drejtë u ngritën nga nënkryetari i Kuvendit, do të merren në konsideratë nga institucionet përkatëse të përcaktuara me ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pasi që jemi veç në fund të debatit, do të provoj të jem shumë i shkurtër.

Është fakt se Universiteti do ta ndryshojë strukturën kualifikuese të popullsisë dhe do të ndikojë në zhvillimin ekonomik të regjioneve ku do të legalizohen këto universitete.

Kjo do të rritë, sigurisht, edhe konkurrencën dhe një konkurrencë të shëndoshë edhe në raport, universitetet publike dhe universitete private dhe sigurisht se do të ndikojë edhe në shkarkimin e Universitetit të Prishtinës, sepse e dini, me mijëra maturantë me vite të tëra ia mësyjnë Prishtinës – Universitetit të Prishtinës dhe për shkak të lehtësirave të komunikimit tani Universiteti i Prishtinës ia mësyjnë edhe studentë apo maturantë edhe nga viset veriore të Shqipërisë dhe për çdo vit Universiteti i Prishtinës, fillon të mbingarkohet, prandaj hapja e këtyre universiteteve publike edhe në Prizren, edhe në Gjakovë edhe në Gjilan do të ndikojë në zhvillimin e popullsisë dhe do të ndikojë që edhe studentët matanë kufirit, maturantë matanë kufirit, edhe të Luginës, po edhe të Shqipërisë Veriore të kenë qasje më të lehtë në arsimin universitar.

Konkurrenca është fakt që e rrit cilësinë dhe Ligji për arsimin e lartë e ka përcaktuar edhe arsimin e lartë privat dhe atë publik.

Mua më befason vetëm një fakt. Është atakuar shumë edhe arsimi privat, është fakt se cilësia në arsimin privat është e dobët, por cilët janë përgjegjësit, kush mban mësim në arsimin privat, kush mban mësim në universitetet private, nga vijnë ata profesorë? Po a janë të njëjtit profesorë të cilët punojnë edhe në universitete publike, po ata të cilët mbajnë ligjërata edhe ushtrime dhe provime në universitetet private.

Si mund sot një profesor universiteti ta kritikojë cilësinë në arsimin e lartë kur po i njëjti profesor jep mësim në arsimin privat, në universitete private, i njëjti profesor jep mësim edhe në universitete private edhe në Universitetin publik dhe tani e kritikon cilësinë në universitete private.

Cila është arsyeja? A do të thotë se këta profesorë të cilët sot kritikojnë cilësinë në universitete private edhe vetë japin mësim në universitete private, janë shitur për lekë tek privatët? Dhe po të njëjtit tani dëshirojnë të na shiten këtu për engjëj se këta qenkan të mirë, ndërsa ata në universitete private qenkan dikush tjetër. Mos na kanë ardhur profesorët në universitete private nga ndonjë shtet tjetër, mos kanë shpikur nga Marsi. A janë po të njëjtit profesorë, të cilët e kanë kriterin e dyfishtë, apo të paktën, të shprehen kushtimisht ato se edhe në universitete publike e kanë një kriter tjetër për arsye se këtu paguhen nga shteti, ndërsa në universitete private e kanë një kriter tjetër dhe aty paguhen nga privati dhe nuk ka lidhje niveli i cilësisë dhe tolerimet, të cilat i bëjnë në universitete private?

Prandaj, përpara se të vihen në çdo kritikë universitetet private gjithsesi kritikën do të fillojnë të vihen përpara atyre të cilët fillojnë në mënyrë joparimore të atakojnë ligjin dhe të atakojnë edhe cilësinë në universitete private. Faleminderit!

KRYETARI: U kryen. Kryeministër mund ta marrësh fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI

Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti ministër,

Siç edhe e dini Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendimet përkatëse të përgatitura mirë duke u nisur nga baza kushtetuese dhe ligjore e Republikës së Kosovës, pra vendimi për hapjen e universiteteve tjera publike në Kosovë, duke u nisur nga parimi i ekonomisë së tregut e gjithmonë decentralizimi në çdo segment sjell cilësi nëse menaxhohet mirë.

Në anën tjetër, që nga viti 2010, studimi i fizibilitetit për të gjitha këto çështje është i përmbyllur. Bazën financiare dhe mbështetjen financiare këto universitete do ta kenë. Nevojat e të gjitha këtyre qyteteve dhe rajoneve, sepse mos mendoni vetëm për një qytet, kur flasim ta zëmë vetëm për Pejën, por mendoni për rajonin me Dukagjin dhe komunat tjera për rreth.

Gjithashtu dua të ju theksoj se edhe kërkesat e qytetarëve janë unanime për nevoja që të kenë universitete publike në qytetet përkatëse që janë përmendur në Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë.

Deri më tani funksionojnë dy universitete publike, Universiteti i Prishtinës Hasan Prishtina dhe Universiteti Publik në Prizren, Ukshin Hoti.

Tanimë Universiteti publik Ukshin Hotin në Prizren, funksionon tash e tri vjet, ka rreth 6 000 studentë dhe diskutohet këtu tash a ka qenë vendim i drejtë apo jo, mendoj se po ata ligjërues që janë kryesisht në Universitetin e Prishtinës, janë ligjërues edhe në Universitetin e Prizrenit, ka ligjërues edhe nga Universiteti i Tiranës. Pra këta pedagogë i kemi ne dhe nuk është mirë të kontestohet aftësia, cilësia e tyre. Ajo cilësi që ofrohet për studentët për të rinjtë tanë në Universitetin e Prishtinës, ofrohet edhe në Universitetin e Prizrenit.

Ne kemi marrë vendim si Qeveri e Kosovës për themelimin edhe të universitetit në Gjakovë. E kam propozuar emrin e intelektualit të nderuar profesor Fehmi Agani, gjithashtu kemi marrë edhe vendim për themelimin e universitetit në Gjiilan. Është propozuar emri i intelektualit dhe patriotit Kadri Zeka. Kemi marrë vendim edhe për themelimin e universitetit në Mitrovicë. Kemi ndarë mjete dhe kemi filluar rreth 15 milionë euro të ndërtojmë objektin më bashkëkohor në rajon sa i përket një universiteti. Unë do ta marr seriozisht propozimin e ministrit Ferati, deputetit aktual, për emrin e të nderuarit profesor Berisha, ndërsa në të njëjtën kohë ju e dini se në Kosovë funksionojnë edhe Universiteti tjetër i Mitrovicës dhe Universiteti tjetër publik evropian që është Universiteti i OKB-së, ndërsa unë ju ftoj të gjithëve dhe dua t'ju them me përgjegjësinë më të lartë edhe kushtetuese edhe ligjore edhe si kryeministër i vendit, natyrisht se këto janë vendime pikësëpari të nevojës së qytetarëve, të ekonomisë së tregut. Natyrisht se universitetet e ndryshme do të sjellin edhe konkurrencë të ndryshme, konkurrencë në dije. Tha Ardiani, dija është ekonomi – Universiteti. Sa më shumë ekonomi aq më tepër konkurrencë dhe cilësi do të kemi. Vendimet kanë qenë politike, se vendimet e Qeverisë janë ato vendime që merren, tashmë ju interpretoni si doni, por janë politike. Edhe deklarimi juaj do të jetë politik, por është një dallim se këto nuk janë vendime njëpartiake. Unë ju them me përgjegjësinë më të lartë, nuk ka parti politike në Prizren që deklarohet kundër funksionimit të Universitetit publik në Prizren, qofshin shqiptare, qofshin jo shqiptare.

Më autoritetet komunale në Pejë që nuk janë të Partisë Demokratike të Kosovës, kemi një bashkëpunim të shkëlqyeshëm edhe për themelimin, edhe për vazhdimin e funksionimit të Universitetit të Pejës” Haxhi Zeka” dhe falënderoj edhe kryetarin Berisha dhe gjithë autoritetet komunale, gjithë spektrin politik, shoqërinë civile, botën akademike të Pejës, për mbështetjen e plotë që i ka dhënë këtij projekti.

Mos mendoni që edhe Universiteti në Prizren do të mund të fillonte dhe funksiononte pa mbështetjen e të gjitha atyre kuadrove të Prizrenit.

Në anën tjetër, në Gjakovë, ne jemi në konsultim të ngushtë, bashkëpunim shumë të ngushtë me autoritetet komunale të Gjakovës. Edhe ata, edhe ajo qeveri komunale, edhe kryetari i kuvendit komunal apo kryetari i Gjakovës nuk është i PDK-së, nuk janë vendime politike për favore partiake. Përsëri edhe për kryetarin e Gjakovës, shpreh mirënjohje për mbështetjen, natyrisht mbështetje i ka dhënë këtij projekti fuqishëm edhe zëvendëskryeministrja Mimoza Kusari-Lila.

Por dua të potencoj se këto vendime nuk janë me karakter në kuptimin elektoral partiak, por janë në interesin e qytetarëve, nevojave të qytetarëve dhe ekonomisë së tregut.

Ndërsa, edhe sa i përket Universitetit në Gjilan, të gjithë janë deklaruar në favor. Nëse dikush ka dilema, le të organizojë një sondazh apo një referendum me qytetarët e Gjilanit dhe të vihet në pikëpyetje ky vendim mendoj se është në kundërshtim me kohën, në kundërshtim me proceset e ardhshëm dhe ky vendim është i pakthyeshëm.

Imagjinoni ju tash rajonin e Anamoravës, Karadakut, të jetë pa universitet, kur aty mund të përfshihet edhe Presheva edhe Medvegja edhe Bujanovci, edhe Kumanova. Pse ata të rinj të shpërndahen anekënd, në Tiranë, në Prishtinë e tutje, kur mund të kenë shumë afër. Ne e dimë gjendjen e familjeve tona dhe nevojat e njerëzve.

Ndërsa, po them në Mitrovicë, përsëri edhe sa i përket infrastrukturës, edhe kuadrove, unë dua të besoj se do të jetë një prej universiteteve më të fuqishme, më kredibile dhe më të avancuara, prandaj pa humbur kohë, unë e mbroj fuqishëm vendimin që e kam marrë në Qeveri. Falënderoj ministrin për punën e tij të shkëlqyeshme që e ka bërë. Ju ftoj që pa dallime partiake të votoni në favor të ratifikimit të vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e universiteteve publike në Gjakovë, në Gjilan dhe në Mitrovicë, institucione publike të arsimit të lartë.

Gjithashtu, ju ftoj që të aprovohet edhe miratimi i statutit të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren dhe miratimi i statutit të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë.

Po, është e vërtetë, ne të gjithë si parti politike kemi premtuar themelimin e këtyre universiteteve, mirëpo të gjithë nuk jemi në pushtet. Tash këtu jemi të gjithë në pushtet, sot e marrim vendimin për themelimin ose jo, definitiv, të këtyre universiteteve. Prandaj, pa dallim partiak, ju ftoj të gjithëve, me përgjegjësinë më të lartë që e kemi si përfaqësues legjitim të qytetarëve të Kosovës, të votojmë në favor të ratifikimit të vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ndërsa, sa i përket nxjerrjes së kuadrove të paktë apo të shumtë, të dobët apo cilësor, kjo çështje gjithmonë është e diskutueshme e në veçanti dua t’ju them në mënyrën më të hapur dhe të sqartë, është e diskutueshme që nga viti 1991 edhe gradimet shkencore edhe çështjet tjera, por nuk është çështje sot këtu. Nëse dëshirojmë të diskutojmë për cilësinë në arsim, ftojmë një debat dhe diskutojmë, por diskutojmë që nga viti 1991, me kritika dhe autokritika, të gjitha diplomimet, gradimet shkencore, prej vitit 1991 deri 1998, ka qenë një pauzë e t’i hyjmë menjëherë prej qershorit 1999, një nga një, prej personaliteteve më të fuqishme politike, shkencore.

Unë fort nuk përzihem në atë drejtim, por ju keni kërkuar gjithmonë dhe ju mbështes për atë debat. Faleminderit dhe ju ftoj për votim.

KRYETARI: Debati ka përfunduar. Tash fjala është e Qeverisë. Ministër e ke fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: Mbase, fjala pas kryeministrit edhe nuk ka shumë peshë, unë vetëm desha t'i saktësoj disa gjëra dhe të përgjigjem në disa pyetje që u bënë.

Unë dua të besoj se këto vendime, po shoh që më parë janë ratifikuar, sepse në fakt ka disponim të mirë, nuk dua të besoj, pavarësisht diskutimeve që kanë qenë me thumb nganjëherë që dikush është kundër themelimit të universiteteve, dua të besoj se të gjithë jemi pro, dhe nuk ka logjikë tjetër dhe sigurisht se edhe këto do të bëhen.

Unë po ju them se ato universitete janë duke punuar, ato njësi akademike janë duke punuar. Ne po i emërtojmë sot dhe po e shtojmë, mbase ndonjë administrator aty, sepse ata janë duke punuar veç në këto tri qytete, po i rrisim kapacitetet dhe po i ofrojmë qytetarit më afër atë shërbim që është i domosdoshëm për ta ofruar.

Dhe çështja e fizibilitetit që u përmend, ju lutem, çështja për llogaritje të fizibilitetit është që nga 2010, i përkthyer edhe në anglisht edhe në serbisht për këto institucione dhe mund ta shohë kushdo që të dojë, kurdo që të dojë. Diçka desha të them. Unë e di që ju shumica e keni lexuar edhe historikun e Kembrixhit, edhe të Oxfordit, edhe të Universitetit të Vjenës, edhe të Kremsit, edhe të tjera dhe të Prishtinës patjetër se po. Cili universitet ka nisur me të gjitha kapacitetet e realizuara, hajde, më thoni cili?

Andaj, ju lus dhe unë e kuptoj dëshirën tuaj që është edhe dëshirë e imja, por megjithatë duhet të fillojmë për të ndërtuar diçka dhe po besoj se kemi me ndërtuar mirë.

Çështja e kuadrove: 4 128 njerëz janë duke bërë masterin nëpër botë. 4 128, mos harroni! 618 doktorantë i kemi aktualisht në universitetet më prestigjioze të botës. Dhe këto gjëra, ju lutem, janë kapacitete që do na shtohen dhe do na rriten për çdo ditë.

Unë po ju them që edhe në Universitetin Publik të Prishtinës kemi pasur rezistencë të çuditshme në hapjen e shkollës së doktoratës, nga njerëz që janë akademikë, mirëpo i kemi hapur, do të vazhdojmë t'i hapim.

Unë ju falënderoj shumë për debatin se sinqerisht ka qenë një debat shumë përmbajtjesor, po them nganjëherë me thumb, por edhe kjo është e kuptueshme. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri e ka kërkuar fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Jo, jo, në asnjë rrethanë replikë, por unë vetëm e falënderoj ministrin për punën e tij të shkëlqyeshme që e ka bërë. Ne vendimet i kemi marrë, shpresoj sot në vendimmarrje, por dëshiroj të theksoj se nganjëherë në diskutime të mos krijohet konfuzion siç u krijua nga zoti Hamiti, sidomos sa i përket cilësisë dhe disa segmenteve tjera në arsim, por edhe diplomaci. Dhe në këto dy segmente zoti

Hamiti, sinqerisht në veçanti është vetë punëtor i Agjencisë të Akreditimit të arsimit kosovar dhe e di se si kanë shkuar, shumë mirë.

Sa i përket cilësisë së arsimit në Kosovë, edhe një herë ju ftoj, le të caktojmë sot të gjithë, pa dallim partiak, prej vitit 1991 deri sot...

(Ndërhyrje - reagime)

...Më herët, del diçka tjetër. Por që nga viti 1991, i nderuar zoti Hamiti, diskutojmë të gjithë publikisht nëpërmjet televizionit, ballafaqojmë argumentet dhe kundër argumentet, kështu që sidomos sa i përket arsimit dhe diplomacisë, ndonjëherë s'keni edhe të drejtë morale të diskutoni. Faleminderit!

KRYETARI: Sabri Hamiti e ka fjalën, për replikë.

SABRI HAMITI: Kryeministri ka qejf me më nguc, më tha pare kam me të ngucë dhe unë e pranoj, le të më nguc.

(Ndërhyrje)

Problemi është që nuk është mirë t'i ndërrojmë tezat. Kjo vlen për të gjithë, s'ka të bëjë veç me kryeministrin, ka të bëjë me mua dhe me të gjithë.

Ne po bisedojmë për të njëjtën gjë, por në dy mënyra, sikur s'duam ta kuptojmë njëri-tjetrin.

Ato nuk janë vende shkret. Ato janë komuna dhe qendra ku ka pasur shkolla të larta, ka pasur edhe që 30 vjet, që 40, por kur formohet Universiteti, bëhet institucion i veçantë që drejtohet, qeveriset edhe si administratë edhe si profesoriat.

Ky është nivel tjetër. Kurrkush nuk thotë që s'ka pasur në Gjilan të mësohet kjo degë. Kurrkush nuk thotë në Gjakovë, kurrkush nuk thotë në Ferizaj që s'po e hapim, por me kërkesë, po e zëmë, të qytetarëve ti hape edhe në Ferizaj, nuk do të thotë që është e ndalur.

Pra, janë dy situata. Kur e shpall Universitetin, ti e bën institucion që e vetëqeveris veten. Natyrisht, por vjen më vonë, sikur këto dy tjerat që erdhën me statute, se ky është inicim.

Prandaj është me rëndësi çka po vendosim, kjo është esenciale. Iniciativë të formohen, po, kurrkush s'është kundër, por nuk mund t'i quajmë ne, me këto ligje që i kemi në fuqi sot, me atë emër. Kaq.

Ky ka qenë diskutimi im. Ky është dhe ky mbetet, se s'kam unë rezervë në mendim. Kjo është.

KRYETARI: Kundër-replikë, kryeministri.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar zoti Hamiti,
Unë nuk të thashë a po do me të nguc, veç thashë të kurseva, i nderuar zoti Hamiti, sepse as të nguci ty as kurrkënd, se s'kam nevojë ta nguc kurrkënd hiq, as mos më nguc, ne jemi kolegë të mirë, por thashë të kurseva dhe po të kursej edhe tash.

Ajo që ju thoni që të mos themelohen universitetet në Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë dhe në Pejë, se në Prizren tash janë formuar, ato s'mund të ndalen, besoj që nuk do të ndalen as sot këto, mendoj se janë të paqëndrueshme, nuk janë fare argumentuese as në kuptimin shkencor as politik, as intelektual, as akademik, as moral, as financiar, as kurrfarë hiq.

Në anën tjetër, ju thoni se ato qendra: Peja, Mitrovica, Prizreni, Ferizaj, Gjakova, Gjilani kanë shkolla të larta. Pikërisht dallojmë këtu unë dhe ti.

Ju ende kërkoni që të mbetemi në nivelin e shkollave të larta, unë kërkoj dhe punoj dhe kam marrë vendime për hapjen e universiteteve, prandaj vendimi është individual, koha e shkollave të larta ka përfunduar. Ju thashë, sa i përket cilësisë, urdhëro, me propozimin tuaj, Qeveria e Kosovës do të jetë në dispozicion të Parlamentit të Kosovës për të diskutuar gjithë periudhën e arsimit nga viti 1991 deri më tani dhe të gjitha gradimet shkencore. E unë e di që edhe gradimet tuaja shkencore kanë filluar pas vitit 1991, të avancuara.

KRYETARI: Sabri Hamiti e ka fjalën, replikë.

SABRI HAMITI: Shiko, unë edhe një herë po them, se këtu është problem, këtu është problem për t'u marrë vesh.

Shkolla e lartë, unë kam them shkollimi i lartë, edhe universiteti është shkollim i lartë. Ju keni universitet, meqë po më ngucni, që përkah natyra, përkah natyra për ta ruajtur emrin e parë, quhet shkollë e lartë e studimeve sociale është një nga universitetet më të mira në Paris.

Tjetra, Shkolla e Lartë Normale, se kur është formuar e ka pasur emrin, e s'e kanë ata problem për ta ruajtur emrin, është një nga universitetet më të mira.

Pra, nuk e përdor si vlerësim, por si karakterizim. Edhe universiteti është shkollim i lartë dhe ligji ynë, ky që e kemi ne, iu thotë; bartësi publik i arsimit të lartë. Aty pastaj hyjnë universitetet, hyjnë fakultetet, hyjnë kolegjet e tjera.

Dhe është mirë të merremi vesh, nuk është puna këtu të nxjerrim qime. Universitetet hyjnë në nivelin e shkollimit të lartë. Kaq, edhe u krye.

KRYETARI: Urdhëro, kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Edhe një herë po them, i nderuar Hamiti, unë nuk po të nguc, nëse ndihesh i ngucur është çështje e jotja. Por, nga ana ime jo.

Me Kushtetutë lejohet me qenë i vetëngucur prej të tjerëve, po thotë Zemaj. Prandaj, unë ju ftoj të gjithëve, pa dallim partiak, votoni për ratifikimin e vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për hapjen e këtyre universiteteve publike. Ju faleminderit, e në kuadër të kësaj, edhe zotin Hamiti.

KRYETARI: Konsideroj që debati ka përfunduar, edhe replikat kanë përfunduar. Por vërtet është mirë, kur të diskutojmë, ta kuptojmë mirë gjuhën shqipe se po më duket shqip kemi folur dhe nganjëherë s'po kuptohet edhe gjuha shqipe në Kuvendin tonë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatohet se Kuvendi më 78 vota për, asnjë kundër, 3 abstenime ratifikoi vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e universiteteve publike në Gjakovë, Gjilan e Mitrovicë si institucione publike të arsimit të lartë.

Dhe vazhdojmë me pikat tjera. Ju lutem, t'i përfundojmë se janë vetëm për votim.

Mirëpo, e kam një kërkesë. A shkojmë me votim me dy pikat bashkë? Kemi të bëjmë me dy statute të universiteteve të Prizrenit dhe të Pejës.

Pra, a jeni dakord që me një votim formal, për t'i bërë bashkë?

Atëherë kërkohet referimi i kryetarit të Komisionit, deputetit Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Deputeti Ramë Vata, raporton për këtë pikë të rendit të ditës.

KRYETARI: Atëherë, deputeti Ramë Vata e ka fjalën, në emër të Komisionit.

RAMË VATA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryeministër, kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit dhe në pajtim me nenin 17, paragrafi 1 i Ligjit për arsimit të lartë të Republikës së Kosovës numër 04/L-037, në disa mbledhje radhazi i ka shqyrtuar projektstatutet e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren dhe Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka", të propozuar nga Qeveria dhe përfundimisht në mbledhjen e mbajtur, më 15 maj ka vendosur që Kuvendit të Republikës së Kosovës t'i paraqesë rekomandimin që të miratohen statutet e këtyre dy universiteteve.

Është një gabim që është përvjedhur në nenin 18, që kërkoj të miratohet tash, të ndërrohet, kur thuhet – neni 18, pika 3, Senati zgjedh 4 anëtarë të Këshillit Drejtues me të drejtë vote nga personeli akademik i Universitetit, dhe duhet t'i shtohet "me thirrje të profesorit", sepse në bord është shumë e ulët apo konflikt interesi të jetë asistent.

Kjo është përvjedhur gabimisht, kështu që kjo duhet të shtohet në dy statute, neni 18 pika 3 "me thirrje të profesorit".

Pra, senati duhet të zgjedhë anëtarë që duhet të jenë vetëm me thirrje të profesorit e jo asistentë apo lektorë, sepse personeli akademik nënkupton edhe asistentë.

Prandaj, ftoj edhe kolegët tjerë deputetë që të votojnë pro këtyre statuteve. Faleminderit!

KRYETARI: Shkojmë në procedurën e votimit dhe votojmë për statutet e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren dhe të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë, me vërejtjet e raportuesit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatohet se me 65 vota për, 5 kundër dhe 1 abstenim, Kuvendi i miratoi statutin e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, me ndryshimet e propozuara nga Komisioni funksional dhe statutin e Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë me ndryshimet e propozuara nga Komisioni Funksional.

Dhe e vazhdojmë pikën e radhës, të fundit për sot:

10. Miratimi i buxhetit të Komisionit Hetimor Parlamentar

Komisioni për Buxhet e Financa e ka shqyrtuar kërkesën e Komisionit Hetimor Parlamentar për lejimin e mjeteve buxhetore dhe Kuvendi i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Edhe këtu po shkojmë menjëherë në votim. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 65 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, Kuvendi e miratoi buxhetin e Komisionit Hetimor Parlamentar.

Mirupafshim në seancën e radhës!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*